REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

departamenti
dap
Administratës Publike



# RAPORTI VJETOR I MONITORIMIT 2021

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE
E REFORMËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

*Copyright © 2022, Departamenti i Administratës Publike*
*Të gjitha të drejtat e rezervuara*

# TABELA PËRMBLEDHËSE


| | |
|---|---|
| 01 \| LISTA E AKRONIMEVE | 4 |
| 02 \| PREAMBULA | 5 |
| 03 \|PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE | 7 |
| 04 \| PROGRESI I STRATEGJISË | 9 |
| 05 \| SHTYLLA I: POLITIKËBËRJA DHE CILËSIA E LEGJISLACIONIT | 21 |
| 06 \| SHTYLLA II: ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ADMINISTRATËS PUBLIKE | 28 |
| 07 \| SHTYLLA III: SHËRBIMI CIVIL: MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE | 34 |
| 08 \| SHTYLLA IV: PROCEDURAT ADMINISTRATIVE DHE MBIKËQYRJA | 44 |
| 09 \| VLERËSIMI I ARRITJEVE KRYESORE DUKE PËRDORUR TREGUESIT | 52 |
| 10 \| KOMUNIKIMI I AKTIVITETEVE | 53 |
| 11 \| ANEKS I - RISKU DHE MITIGIMI | 57 |
| 12 \| ANEKS II - ECURIA E PLANIT TË AKTIVITETEVE 2018 2022 | 58 |

# LISTA E AKRONIMEVE

| | |
|---|---|
| **AKSHI** | *AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT* |
| **ADISA** | *AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA* |
| **BE** | *BASHKIMI EVROPIAN* |
| **DAP** | *DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE* |
| **DZHM** | *DEPARTAMENTI I ZHVILLIMIT DHE MIRËQEVERISJES* |
| **EAMIS** | *SISTEMI I MENAXHIMIT TË ASISTENCËS SË HUAJ* |
| **HRMIS** | *SISTEMI INFORMATIK I MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE* |
| **IPSIS** | *SISTEMI I PLANIFIKIMIT TË INTEGRUAR TË MENAXHIMIT TË INFORMACIONIT* |
| **IPS** | *SISTEMI I PLANIFIKIMIT TË INTEGRUAR* |
| **KMSHC** | *KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL* |
| **KDIMDP** | *KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE* |
| **KE** | *KOMISIONI EUROPIAN* |
| **KPI** | *INDIKATORËT KYÇ TË PERFORMANCËS* |
| **ML** | *MINISTRI LINJE* |
| **NC** | *NËPUNËS CIVIL* |
| **OECD** | *ORGANIZATA PËR BASHKËPUNIM DHE ZHVILLIM EKONOMIK* |
| **OJF** | *ORGANIZATË JOFITIMPRURËSE* |
| **OSS** | *ONE SINGLE SYSTEM (NJË SISTEM I VETËM)* |
| **OZHQ** | *OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM* |
| **PBA** | *PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM* |
| **PFM** | *MENAXHIMI I FINANCAVE PUBLIKE* |
| **PKIE** | *PLANI KOMBËTAR PËR INTEGRIMIN EUROPIAN* |
| **RENjK** | *REGJISTRI ELEKTRONIK PËR NJOFTIMIN DHE KONSULTIMIN PUBLIK* |
| **ReSPA** | *SHKOLLA RAJONALE E ADMINISTRATËS PUBLIKE* |
| **RIA** | *VLERËSIMI I NDIKIMIT RREGULLATOR* |
| **SIGMA/OECD** | *SUPPORT FOR IMPROVEMENT IN GOVERNANCE AND MANAGEMENT* |
| **SKZHI** | *STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM* |
| **SNRAP** | *STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E REFORMËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE* |
| **TIK** | *TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT* |



# PREAMBULA

Fjala e znj. Albana Koçiu
Drejtor i Departamentit të Administratës Publike

**Të dashur lexues!**

Ju prezantojmë me raportin e monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës së Administratës Publike, për vitin 2021.

Viti që lamë pas ishte një vit sfidues për të gjithë ne, ndërsa vazhduam të përballemi me pasojat e pandemisë Covid dhe pasiguritë e rikthimit të valëve të infektimit. Në mbarë botën, kjo pandemi sfidoi si kurrë më parë kapacitetin e qeverive dhe institucioneve të sektorit publik për të përmbushur qëllimet dhe prioritetet e tyre. Institucionet publike po reflektojnë për çfarë mësuan nga kjo pandemi dhe si të përmirësojnë reagimet në lidhje me situata të ngjashme krizash në të ardhmen.

Për Departamentin e Administratës Publike ky është viti i shtatë i monitorimit të zbatimit të një plani ambicioz masash dhe aktivitetesh që kanë filluar implementimin nga viti 2015 e ku fokus kryesor është përmirësimi dhe reformimi i punës së institucioneve të administratës publike, për t'i shërbyer sa më denjësisht qytetarëve shqiptarë si dhe për të përmbushur aspiratën e kahershme për t'ju bashkuar familjes së madhe evropiane.

Përpos sfidave tona të përditshme dhe atyre që solli pandemia, së bashku, kemi hedhur hapa pozitivë në disa drejtime. Raportet e partnerëve ndërkombëtarë, ku do të veçoja raportin më të fundit të monitorimit të SIGMA/OECD në Nëntor 2021, kanë njohur dhe vlerësuar Shqipërinë si lider në rajon në fusha kryesore si menaxhimi i burimeve njerëzore dhe ofrimi i shërbimeve dixhitale.

Stabiliteti dhe forcimi i sistemit të shërbimit civil, ngritja e kapaciteteve dhe rritja profesionale e nëpunësve civilë në përballimin me sukses të sfidave të integrimit drejt Bashkimit Evropian, janë vlerësuar pozitivisht krahas treguesit "Meritokracia dhe efektiviteti i rekrutimit të nëpunësve civilë" i cili është vlerësuar me pikë maksimale (5 nga 5).

Zhvillimet teknologjike, eksperiencat e vendeve të BE-së sa i takon organizimit të administratës, krizat me të cilat po ndeshet bota si edhe rëndësia e një balance të shëndetshme mes jetës profesionale dhe asaj familjare, po tregojnë gjithnjë e më shumë se duhet të jemi në zhvillim të përhershëm. Është e nevojshme të krijojmë një administratë fleksibël, të aftë për t'ju përgjigjur me profesionalizëm nevojave dhe sfidave të reja. Çdo reformë e ndërmarrë, mbetet për t'u zbatuar fillimisht nga vetë punonjësit, ndaj dhe ne duhet të kemi një ekip këmbëngulës dhe të motivuar për të ndikuar në zhvillimin e vendit.

Do të nisim nga puna për të hartuar një strategji të re të reformës në administratën publike, duke e ndërtuar atë mbi eksperiencat tona dhe mësimet e nxjerra.

Progresi dhe zhvillimi nuk mund të arrihen lehtë. Suksesi ka nevojë për kontributin e të gjithë nëpunësve të administratës publike dhe ne jemi më të përkushtuar se kurrë për të punuar e kontribuar në realizimin e saj.

Ju ftoj të lexoni Raportin e Monitorimit të Strategjisë së Reformës së Administratës Publike për vitin 2021 dhe të na jepni mendimet tuaja sesi të bëjmë më mirë në të ardhmen.

Duke ju falenderuar për kohën Tuaj,

Albana

# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

**125** NËN AKTIVITETE

në zbatim nga 130 nën aktivitete gjithsej.

**96%**

**71%**

**89** NËN AKTIVITETE

të realizuara plotësisht nga 125 që kanë nisur zbatimin

## KONSULTIMI PUBLIK

Kornizë rregullatore e unifikuar

## VLERËSIMI I NDIKIMIT RREGULLATOR

**74%**

*Cilësia e analizës së RIA në rritje*

## TRAJNIME

**6728** nëpunës civilë të trajnuar

## ADMINISTRATA.AL

**1328** *Përshkrime Pune të finalizuara*

**300** *dokumenta dhe template*

## E-ALBANIA

e albania

**1209** *shërbime elektronike*

**55** *regjistra elektronike*

**215M** *transaksione*

## TRANSPARENCA

Regjistri Elektronik i Kërkesave & Përgjigjeve

**95** *autoritete*

## PROGRESI NË REALIZIM SIPAS SHTYLLAVE

**82%** POLITIKËBËRJA DHE CILËSIA E LEGJISLACIONIT

**72%** ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

**65%** SHËRBIMI CIVIL: MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

**62%** PROCEDURAT ADMINISTRATIVE DHE MBIKËQYRJA

# REALIZIMI I INDIKATORËVE

**16**

**TARGET I ARRITUR**





**12***

*6 indikatorë shënojnë vlera në rritje, 5 shënojnë vlerë konstante, 1 shënon trend zbritës*

## NËN-AKTIVITETET NË ZBATIM SIPAS OBJEKTIVAVE




## STRATEGJIA E RE E RAP PËR VITIN 2023

**TM-II 2022**

Vlerësimi i situatës aktuale dhe analiza e masave dhe indikatorëve për të shmangur mbivendosjet me strategjitë e tjera nën ombrellën e RAP

**TM-III 2022**

Përcaktimi i fushave prioritare në të cilat do të bazohet strategjia e re

**TM-IV 2022**

Hartimi i planit të veprimit dhe pasaportës së indikatorëve; kostimi i planit të veprimit

**TM-IV 2022 DHE TM-I 2023**

Konsultimi me institucionet përkatëse dhe me palët e tjera të përfshira

**TM I-II 2023**

Miratimi i strategjisë së re

# PROGRESI I STRATEGJISË



## Reforma të implementuara me sukses në vitin 2021

Reformimi i Administratës Publike është një ndër elementët nën shtyllën "Themelet: Qeverisja e mirë, demokracia dhe shteti i së drejtës" të SKZHI 2015-2020, me vizionin e zhvillimit të një administrate publike në përputhje me standartet e Administratës Evropiane me qëllimin për të ofruar shërbime me cilësi të lartë për qytetarët dhe bizneset, në mënyrë transparente dhe efikase përmes përdorimit të teknologjive moderne dhe shërbimeve novatore, në përputhje me integrimin Evropian, me anë të punonjësve civilë të paanshëm dhe profesionistë si pjesë e strukturave efikase, vizion ky dhe i Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike (SNRAP).

Që në fazat e para të hartimit të SNRAP, është synuar ndërlidhja midis politikave të përcaktuara në SKZHI dhe objektivave afatgjata të cilat kanë për qëllim kryesisht përmirësimin e efektivitetit të administratës publike dhe uljen e korrupsionit; krijimin e një sistemi profesional, të paanshëm dhe të bazuar në merita si dhe përmirësimin e shërbimeve publike dhe të procedurave administrative dhe mbikëqyrëse.

Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike, e miratuar në 15 Prill 2015 nga Qeveria Shqiptare, shërben si një dokument strategjik që orienton reformimin e administratës bazuar në katër shtylla kryesore, 11 objektiva të qarta strategjike, planin e veprimit i cili parashikon zbatimin e 130 nën-aktiviteteve konkrete dhe pasaportës së indikatorëve[1]

Shtylla I: Politikëbërja dhe Cilësia e Legjislacionit (46 nën-aktivitete);

Shtylla II: Organizimi dhe Funksionimi i Administratës Publike (18 nën-aktivitete);

Shtylla III: Shërbimi civil: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore (36 nën-aktivitete);

Shtylla IV: Procedurat Administrative dhe Mbikëqyrja (30 nën-aktivitete).

1 https://www.dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik

**Gjatë këtyre shtatë viteve, SNRAP 2015-2022 ka kaluar në disa faza të rëndësishme si:**

- Miratimi i Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën e Administratës Publike (2015);
- Rishikimi afatmesëm që konfirmoi rëndësinë e shtyllave dhe objektivave strategjike (2017);
- Miratimi i planit të veprimit SNRAP 2018-2020 ku janë marrë në konsideratë arritjet, sfidat dhe rekomandimet e strukturave ndërkombëtare (2018);
- Hartimi dhe miratimi i planit të ri 2018-2022, afati i të cilit u zgjat dhe u shtuan aktivitete për të ofruar mbështetje strategjike për programimin e fondeve IPA (2019);
- Përcaktimi i vlerave të synuara mbi treguesit në nivel rezultati për 2021-2022, pjesë e pasaportës së indikatorëve (gjatë 2021).

Viti 2022 përkon me mbarimin e afatit të kohëzgjatjes së Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike.

Departamenti i Administratës Publike në cilësinë e institucionit përgjegjës për monitorimin e zbatimit të SNRAP vlerëson si prioritar dhe tejet të rëndësishëm inicimin e procesit të shkrimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike për vitin 2023 e në vijim.

## HAPAT DREJT SNRAP 2023 E MË TEJ




Kështu, hartimi dhe miratimi i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE) për periudhën në vijim dhe përcaktimi i vizionit për Reformën në Administratën Publike do të shërbejë si bazë solide për inicimin e përgatitjes dhe shkrimit të SNRAP 2023 e në vijim.

Departamenti i Administratës Publike si institucioni përgjegjës për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të SNRAP, e kryen këtë proces çdo vit, duke synuar përmirësimin e vazhdueshëm të tij. Kështu çdo vit raportimi synon të orientohet drejt prezantimit të rezultateve kryesore dhe të nxjerrë në pah arritjet, sfidat dhe rekomandimet për përmirësim.

Raporti i monitorimit prezanton në mënyrë më të qartë arritjet kryesore të institucioneve publike shqiptare në kuadër të reformimit të administratës publike dhe ç'ka është më e rëndësishme, një paraqitje më të qartë të përfitimeve direkte që administrata dhe qytetarët kanë nga zbatimi i aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë.

Zbatimi dhe monitorimi i Strategjisë diskutohet në takimet e Grupit Tematik "Shërbimi Civil dhe SNRAP", grup i udhëhequr nga DAP i cili takimet për tematika të rëndësishme si raportimi i zbatimit të SNRAP, i zhvillon me pjesëmarrjen e partnerëve ndërkombëtarë dhe shoqërisë civile.

Organizimi i këtyre takimeve me pjesëmarrje të gjerë nga aktorët relevantë në Reformën e Administratës Publike, bëhet me qëllim transparencën, gjithëpërfshirjen dhe reflektimin e kontributeve të tyre në dokumentat strategjikë të vendit.

Procesi i përvitshëm i përgatitjes së raportit të monitorimit të strategjisë fillon në fund të muajit Dhjetor për t'i paraprirë komponentit të rëndësishëm të analizimit dhe vlerësimit të informacionit dhe kontributeve të përcjella nga ana e institucioneve pjesë e zbatimit të SNRAP.

Vlerësimi i nivelit dhe statusit të zbatimit të aktiviteteve të SNRAP në mënyrë progresive bazohet mbi informacionin e dhënë nga çdo njësi përgjegjëse, duke mbajtur në konsideratë Metodologjinë e SIGMA për hartimin e raporteve të monitorimit dhe guidës metodologjike mbi monitorimin bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.290, datë 11.4.2020, "Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPS/IPSIS)".

Për të siguruar një proces monitorimi bazuar në arritjet konkrete, DAP realizon komunikime intensive me përfaqësuesit e strukturave të përfshira në SNRAP, me qëllim prezantimin e drejtë dhe të qartë të arritjeve dhe problematikave të hasura gjatë periudhës së raportimit.

Kështu gjatë dy-mujorit të parë të vitit 2022, është mbajtur një komunikim i vazhdueshëm (verbal dhe zyrtar) në varësi të specifikave për plotësimin e dokumentave raportues me disa prej institucioneve të përfshira në strategji, me qëllim evidentimin e rasteve të suksesit të cilat kanë sjellë rezultate të dukshme në punën e administratës dhe në jetën e qytetarëve e gjithashtu identifikimin e sfidave, problematikave dhe komponentëve të cilat kanë ndikuar apo penguar progresin apo zbatimin e aktiviteteve të parashikuara.

Gjithashtu DAP, në përfundim të të gjithë procesit të monitorimit ka identifikuar dhe çështjet kryesore dhe prioritare të cilat duhet të jenë në vëmendje të vazhdueshme të institucioneve për t'u adresuar me prioritet gjatë vitit 2022. Përvec identifikimit janë lënë rekomandime dhe masa konkrete të cilat duhet të ndiqen me përparësi për të mundësuar realizimin në kohë të tyre.

Në përfundim, çdo koment apo sugjerim i palëve diskutohet dhe reflektohet në raport, varianti përfundimtar i të cilit së bashku me paketën e plotë të dokumenteve, i dërgohet Departamentit të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes si Sekretariati Teknik i Grupit të Integruar të Menaxhimit të Politikave "Mirëqeverisja dhe Administrimi Publik".

Në përfundim të një procesi intensiv, DAP ka hartuar raportin e monitorimit për vitin 2021.

Në kuadër të transparencës dhe komunikimit me publikun, DAP publikon në faqen e tij zyrtare çdo raport monitorimi në Shqip dhe Anglisht[23].

2 Konsultimi i këtij dokumenti është kryer gjatë periudhës Mars -Prill 2022.

3 http://dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/-204raportet-e-monitorimit-te-strategjise

Arritjet në drejtim të ecurisë së zbatimit të SNRAP në terma progresivë janë inkurajuese pavarësisht vështirësive të dy viteve sa i përket kufizimeve të pandemisë.

Plani i Veprimit 2018-2022 parashikon zbatimin e 35 aktiviteteve bazë dhe 130 nën-aktiviteteve në total. Nga 125 nën-aktivitete të cilat kanë filluar zbatimin, 89 prej tyre (71%) vlerësohen si të realizuara plotësisht duke shënuar një rritje prej 21 nën-aktivitetesh të realizuara plotësisht krahasimisht me vitin 2020, ku numri i nën-aktiviteteve të finalizuara shënonte 68.

**Grafiku 1 Statusi i përgjithshëm i realizimit të nënaktiviteteve (që kanë filluar zbatimin) gjatë vitit 2021**




**Grafiku 2 Numri i nën-aktiviteteve të realizuara plotësisht gjatë vitit 2021**




**Grafiku 3 Numri i nën-aktiviteteve të realizuara plotësisht sipas shtyllave**




Nga totali i 94 nën-aktiviteteve të cilat duhet të ishin zbatuar deri në fund të 2021, janë zbatuar plotësisht 68 nën-aktivitete ose 72%.

Nga totali i 36 nën-aktivititeve të cilat priten të përfundojnë në vitin 2022 janë realizuar plotësisht 21 nën-aktivitete ose 58%.

Kjo rritje e numrit të aktiviteteve të finalizuara, përpos situatës, është tregues i soliditetit të punës së bërë vitet e fundit në drejtim të realizimit të produkteve.

Progresi në zbatimin e strategjisë është i dukshëm ku evidentohen arritjet si në nivel zbatimi mase por dhe në nivel treguesi.

Këto arritje janë pozitive dhe inkurajuese dhe janë përkthyer në përfitime konkrete të cilat kanë pasur impakt dhe rezultate në disa drejtime kryesore.

**Grafiku 4 Statusi i zbatimit të nën-aktiviteteve sipas shtyllave në %**




Ecuri ka patur në drejtim të përmirësimit të procesit të politikëbërjes dhe cilësisë së legjislacionit; funksionimit dhe organizimit të administratës publike me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve ndaj publikut; unifikimit të praktikave në mirëmenaxhimin e shërbimit civil, zhvillimit të procedurave të rekrutimit bazuar në meritë, rritjes së kapaciteteve në fushën e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil; zhvillimit të infrastrukturës TIK në ofrimin e shërbimeve publike online; si dhe forcimit të procedurave administrative dhe rolit të mbikëqyrjes në drejtim të zbatimit të akteve ligjore.

*Në një vështrim më të plotë, përkthyer në shifra, niveli i realizimit plotësisht të 71 % të nën-aktiviteteve të Planit të Veprimit 2018-2022 (të cilat kanë filluar implementimin) dhe arritjet tregojnë progresin drejt vizionit strategjik.*

**Në mënyrë të përmbledhur viti 2021 ka shënuar disa arritje të rëndësishme në fushat kryesore të Reformës në Administratën Publike, konkretisht:**

## Shtylla I: Politikëbërja dhe Cilësia e Legjislacionit

**Në kuadër të përmirësimit të sistemit të politikëbërjes dhe cilësisë së legjislacionit**, është iniciuar hartimi i SKZHIE 2030 përmes urdhërit të Kryeministrit në dhjetor të 2021 dhe pritet miratimi i këtij dokumenti gjatë gjashtë-mujorit të I-rë të 2022.

**Tashmë po zbatohen standartet për menaxhimin e informacionit të planifikimit strategjik** dhe po krijohet kulturë pune përgatitja e dokumentave në fushën e planifikimit strategjik në mënyrë që të zbatohet e njëjta metodologji në fushën e politikëbërjes. Ky proces është shoqëruar edhe me ngritjen e kapaciteteve të përdoruesve të sistemit, duke mundësuar trajnimin e përdoruesve të sistemit IPSIS edhe gjatë vitit 2021.

**Përsa i përket funksionimit të mekanizmit të integruar të qasjes së gjerë sektoriale/ ndërsektoriale,** grupet e krijuara janë aktive dhe funksionale. Mekanizmi është konsoliduar dhe është mbështetur secili sekretariat për përmirësimin e performancës së takimeve të zhvilluara në kuadër të mekanizmit. Për vitin 2021, indeksi i rezultatit të performancës së mekanizmit është 52%.

Një komponent i rëndësishëm i mirëqeverisjes që lidhet me rritjen e cilësisë së llogaridhënies dhe transparancës së institucioneve publike si dhe forcimin e demokracisë është edhe **procesi i konsultimit publik.** Tashmë korniza rregullatore për konsultimin publik është unifikuar dhe ka ndikuar në përmirësimin e transparencës dhe cilësisë së politikave. Prioritare mbetet përfshirja aktive e publikut dhe shoqërisë civile në proceset e politikëbërjes. Ky komponent ka ndjekur një trend pozitiv të ecurisë që prej vitit 2019 duke shënuar rritje në treguesit e cilësisë lidhur me realizimin e procesit[4].

**Përsa i takon procesit të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA)**, proces i cili po zbatohet prej vitit 2018, tashmë aktet ligjore përpara miratimit të tyre shoqërohen me raportin RIA përkatës. Falë masave të marra mund të evidentohet rritje në cilësinë e analizës së vlerësimit të ndikimit dhe vlerësimi i zbatimit për aktet ligjore të rëndësishme të hartuara dhe të publikuara, gjatë vitit 2021 është në masën 74%[5].

**Programi "Administrata që duam"** ka vijuar të zbatohet edhe gjatë vitit 2021. Fokusi kryesor i aktiviteteve të parashikuara nën këtë program ka qenë orientimi, rritja e kapaciteteve, motivimit dhe bashkëveprimit të administratës. Vëmendje kryesore i është kushtuar rritjes së ndërveprimit duke vënë në dispozicion të nëpunësve civilë të gjithë kuadrin ligjor, manualet dhe udhëzuesit për zbatimin e Legjislacionit të Shërbimit Civil.

## Shtylla II: Organizimi dhe Funksionimi i Administratës Publike

**Me qëllim krijimin e strukturave efiçente për të përmirësuar organizimin dhe funksionimin e institucioneve të administratës publike**, ka përfunduar tashmë procesi i ristrukturimit të institucioneve të varësisë në 4 sisteme ministrore (sistemet e shëndetësisë, arsimit, turizmit dhe bujqësisë). I gjithë procesi ka ecur paralelisht me rishikimin dhe standardizimin e përgjithshëm të përshkrimeve të punës për ministritë e linjës dhe përcaktimin e 20 proceseve horizontale dhe 40 proceseve vertikale të përshtatura në përputhje me fushën e përgjegjësisë për ministritë e linjës. Kjo u ka ofruar institucioneve mjetet e nevojshme për të siguruar që të ketë një kuptueshmëri standarde dhe të unifikuar të proceseve të punës.

**Shërbimet publike kanë vijuar të shënojnë progres** të mëtejshëm me hapjen e 3 qendrave të integruara të ofrimit të shërbimeve, duke e çuar në 23 numrin total të Qendrave të Integruara. Në këto qendra janë asistuar qytetarët në aplikimin nëpërmjet portalit e-Albania për shërbimet publike të institucioneve qendrore dhe vendore. Me synim monitorimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve, ADISA ka përfunduar procesin e çertifikimit në drejtim të menaxhimit të cilësisë dhe antikorrupsionit si një mjet për të siguruar një kornizë gjithëpërfshirëse të përsosmërisë për ofrimin e shërbimeve publike.

Arritjet në drejtim të ofrimit të shërbimeve publike janë referuar dhe në raportin e monitorimit të SIGMA ku Shqipëria kryeson në vlerësimin në rajon në fushën e ofrimit të shërbimeve publike. Kështu, në këtë fushë evidentohet se "vendi ka një kuadër të fortë dhe të qëndrueshëm të politikave dhe në mbështetjen e strukturës institucionale dhe se Shqipëria vazhdon të shënojë progres në fushën e ofrimit të shërbimeve me në qendër qytetarët"[6] .

4 Kështu mesatarja e tre viteve të fundit e realizimit të indeksit të konsultimit publik është në nivelin 72,25 % dhe cilësia e konsultimit të akteve është vlerësuar me 5,36 pikë.

5 Të cilat janë pikët mesatare për cilësinë e raporteve të vlerësimit të ndikimit për projektligjet që janë përcjellë për miratim në KM gjatë periudhës janar - dhjetor 2021.

6 www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Albania.pdf (faqe 119)

**Sa i përket ofrimit të shërbimeve në zyrat me një ndalesë,** përgjatë vitit 2021 me mbështetje të projektit STAR3 të financuar nga UNDP është instaluar sistemi i operimit të Zyrave me një Ndalesë **në të gjithë (61) njësitë e vetëqeverisjes vendore** duke mundësuar kështu ofrimin e shërbimeve në një zyrë të vetme.

## Shtylla III: Shërbimi civil: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Në fushën e Burimeve Njerëzore Shqipëria është vlerësuar me pikët më të larta në rajonin e Ballkanit Perëndimor duke tejkaluar mesataren rajonale bazuar në Raportin e Monitorimit të SIGMA (2021). Raporti e vlerësoi Shqipërinë përsa i takon stabilitetit dhe forcimit të sistemit të shërbimit civil, ngritjes së kapaciteteve dhe rritjes profesionale të nëpunësve civilë në përballimin me sukses të sfidave të integrimit drejt Bashkimit Evropian[7].

Për më tepër në vlerësimin e bërë nga SIGMA të publikuar në nëntor të vitit 2021, treguesi "Meritokracia dhe efektiviteti i rekrutimit të nëpunësve civilë" është vlerësuar me pikë maksimale (5 nga 5), krahasuar me 4 në vitin 2017.

Raporti vjetor i monitorimit të SNRAP nënvizon progresin e bërë në:

- unifikimin e praktikave në menaxhimin e shërbimit civil në nivel qendror dhe vendor;
- zhvillimin e procedurave të rekrutimit të bazuar në meritë;
- ngritjen e kapaciteteve në fushën e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil;
- ndërveprimin dhe standartizimin e proceseve në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore përmes përdorimit të platformës "administrata.al";
- përdorimin e Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) dhe shtrirjes së tij në institucionet e administratës publike.

Si rezultat i praktikave pozitive dhe këtyre zhvillimeve është rritur numri i pjesëmarrësve në procedurat e rekrutimit duke treguar rritjen e besueshmërisë së publikut për pjesëmarrje në procedurat e rekrutimit të bazuar në meritë, e cila ka ardhur si pasojë e punës së DAP në drejtim të respektimit rigoroz të legjislacionit, transparencës me publikun, aktiviteteve në funksion të rritjes së vizibilitetit etj.

Gjithashtu është ulur numri i ankesave të pranuara nga gjykata që kanë të bëjnë me procedurat e rekrutimit. Numri i ulët (pothuajse 0) i ankesave të pranuara nga Gjykata Administrative e Apelit tregon për një zbatim rigoroz të legjislacionit përkatës për rekrutimin e nëpunësve civilë duke përfshirë këtu Ligjin nr.152 "për Nëpunësin Civil" dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij, për organizimin e procedurave transparente në mënyrë profesionale dhe bazuar në meritë si dhe e mbrojtjes profesionale që kanë ofruar strukturat e përfaqësimit gjyqësor pranë Departamentit të Administratës Publike.

**Në drejtim të unifikimit të zbatimit të ligjit në shërbimin civil**, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vijuar me nxjerrjen e udhëzimeve kryesisht në respektimin e të drejtave politike të nëpunësve dhe riklasifikimin e pozicioneve të punës në njësitë e qeverisjes vendore. Gjithashtu kanë vijuar hetimet administrative në përfundim të të cilave janë lënë rekomandime për rregullimin e situatave të paligjshme. Vëmendje e veçantë i është kushtuar dhe organizimit të trajnimeve mbi "Zbatimin e ligjit për shërbimin civil në nivel vendor".

7 www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Albania.pdf (faqe 23 dhe 68)

**Në lidhje me trajnimet e ofruara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike,** gjatë vitit 2021 janë organizuar 475 webinar-e dhe janë trajnuar 6728 individë (numër unik), numër ky që shënon rritje krahasimisht me 2020[8].

## Shtylla IV: Procedurat Administrative dhe Mbikëqyrja

**Në drejtim të dixhitalizimit të shërbimeve publike**, Shqipëria, referuar raportit të monitorimit të SIGMA ka mbajtur një **trend kryesues dhe pozitiv** në rajon duke përmirësuar cilësinë e ofrimit të shërbimeve me fokus kryesor në ofrimin e shërbimeve dixhitale.

Kështu, përgjatë vitit 2021 portali e-Albania ka vepruar si një pikë e vetme për ofrimin e shërbimeve publike online, duke ofruar **mbi 1209 shërbime elektronike** ose 95% të të gjitha shërbimeve publike, duke shënuar kështu një rritje prej 188 shërbimesh për këtë periudhë. Portali numëron mbi **215 milionë transaksione** ndërmjet sistemeve të ndërlidhura, ku **55 sisteme elektronike** janë të lidhura me **Platformën e Ndërveprimit Qeveritar** duke shkëmbyer të dhëna në kohë reale dhe duke mundësuar shërbime të mëtejshme elektronike për qytetarët.

**Hapa të rëndësishëm institucionalë janë ndërmarrë në drejtim të përmirësimit të aksesit në informacionin publik.** Komisioneri për të Drejtën e Informimit ka evidentuar një sërë problematikash në Ligjin ekzistues nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Në funksion të përmirësimit të bazës ligjore e gjithë paketa legjislative është përcjellë pranë Ministrisë së Drejtësisë për të vijuar me hapat përkatës të miratimit. Gjithashtu, shërbimet **"Kërkesë për informacion publik"** dhe **"Ankesë për mosdhënie informacioni"** ofrohen **nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania**. Në këtë kuadër, këto shërbime elektronike janë funksionale për **61 Autoritete Publike** ndërsa puna është në proces zgjerimi edhe në autoritetet e tjera.

**Në lidhje me nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga Institucioni i Avokatit të Popullit,** janë adresuar 267 rekomandime drejtuar organeve të administratës publike nga të cilat janë pranuar nga institucionet në total 121 rekomandime, 46 nga të cilat (ose 38 % e rekomandimeve) janë zbatuar plotësisht.

## Impakti i zhvillimit të sektorit në rajonin e Ballkanit Perëndimor ose më gjerë

Reforma në Administratën Publike në vitet e fundit ka dhënë rezultate të dukshme duke u referuar nga partnerët ndërkombëtarë për progresin e bërë dhe për arritjet në disa prej komponentëve të reformës. Praktikat pozitive të cilat janë tashmë të konsoliduara falë zbatimit të Reformës në Administratën Publike janë referuar në raporte monitorimi, konferencat rajonale dhe takimet e përbashkëta të zhvilluara për ndarjen e eksperiencave në fushat e politikëbërjes, menaxhimit të burimeve njerëzore, dixhitalizimit të ofrimit të shërbimeve publike dhe llogaridhënies.

Kështu, gjatë vitit 2021 u publikua raporti i monitorimit të SIGMA/OECD për Shqipërinë mbi "Parimet e Administratës Publike"[9]. Raporti nënvizon rëndësinë e zgjatjes së kuadrit strategjik të Reformës në Administratën Publike dhe zgjatjen e afateve kohore të pesë strategjive duke mundësuar kështu qartësi dhe vazhdimësi të reformave kryesore deri në 2022. Në këtë raport

8 Në trajnimet e organizuara në 2021 kanë marrë pjesë 36825 pjesëmarrës.

9 www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Albania.pdf

citohet rëndësia për të forcuar mekanizmat koordinues të RAP dhe vihet në dukje dhe progresi i bërë në fushën e zhvillimit të politikave dhe koordinimit duke theksuar rolin e vlerësimit të impaktit rregullator RIA dhe shtrirjen e tij jo vetëm në aktet primare legjislative. Gjithashtu raporti nxjerr në pah rëndësinë e hartimit të politikave të bazuara në evidenca dhe dixhitalizimit të proceseve manaxheriale (IPSIS) duke evidentuar se sistemi tashmë është lançuar dhe thekson rëndësinë e vënies në funksion të plotë të tij.

**Shërbimi civil** në këtë raport monitorimi është vlerësuar *matúr* dhe me **stabilitet**. Raporti thekson se rekrutimi online ka demonstruar pjekuri dhe qëndrueshmëri. Gjithashtu evidentohet se është **forcuar procesi i koordinimit** mbi menaxhimin e burimeve njerëzore (MBNJ) dhe rritja e bashkëpunimit mes institucioneve kryesore ka çuar **në zgjidhje inovative si krijimi i platformës qëndrore online (administrata.al)**[10].

**Shqipëria kryeson në ofrimin e shërbimeve (dixhitale)** në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe ka arritur të ruajë pozicionin e saj lider në rajon në fushën e ofrimit të shërbimeve dhe transformimit dixhital. Nivelet e përgjithshme të kënaqësisë mes qytetarëve dhe bizneseve kanë ardhur duke u rritur duke konfirmuar efektivitetin e politikave dhe reformave të viteve të fundit.

Gjithashtu, raporti ka vlerësuar dhe zbatimin në praktikë të së drejtës për informacion publik duke theksuar se qytetarët dhe bizneset kanë një **opinion pozitiv për aksesin në informacionin publik** dhe duke nxjerrë në pah rëndësinë e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në forcimin e të drejtës së informimit.

Në shkurt të vitit 2022 është publikuar një përmbledhje rajonale mbi raportet e monitorimit të SIGMA[11] ku Shqipëria shënon progres krahasimisht me vlerësimin e 2017 në fushat e (i) koordinimit dhe zhvillimit të politikave; (ii) shërbime publike dhe menaxhimi i burimeve njerëzore; (iii) llogaridhënies; (iv) dhënia e shërbimeve dhe menaxhimi i financave publike.

Përgjatë vitit 2021 është publikuar dhe raporti i monitorimit të Reformës në Administratën Publike për Shqipërinë nga projekti WeBER 2.0 "Fuqizimi i Shoqërisë Civile të Ballkanit Perëndimor për një Administratë Publike të Reformuar"[12]. Raporti paraqet rezultatet e punës së monitorimit të kryer nga shkurti deri në dhjetor të vitit 2020. Në këtë raport në fushën e shërbimit publik dhe mirëadministrimit të burimeve njerëzore është evidentuar rëndësia e rritjes së përdorimit të SIMBNJ dhe reformës së pagave në shërbimin civil.

Ndër të tjera, Shqipëria gjatë vitit 2021 ka marrë kryesimin e Bordit Drejtues të Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA) për vitin 2022. Duhet theksuar se një ndër prioritetet kryesore të ReSPA është dhe mbështetja e vendeve anëtare të saj në drejtim të koordinimit të politikave në fushën e RAP dhe mbështetje në koordinimin, zbatimin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të kësaj reforme. Në këtë vit kryesimi, qeveria shqiptare do të angazhohet maksimalisht në rritjen e dialogut, bashkëpunimit rajonal dhe vëmendjes politike në fushat kyçe të administratës publike dhe integrimit evropian.

## Impakti i implementimit të strategjisë në përputhje me axhendën e Integrimit Evropian

*"Shqipëria është mesatarisht e përgatitur për Reformën në Administratën Publike. Është bërë progres në ngritjen e kapaciteteve në ministritë e linjës për zbatimin e vlerësimeve të ndikimit rregullator, miratimin e udhëzimeve për konsultimet publike, ngritjen e sistemeve të teknologjisë së informacionit për planifikimin e integruar, rritjen e shkallës së zbatimit të Planit Kombëtar të Integrimit Evropian, rritjen e numrit të shërbimeve elektronike dhe përmbushja e fazës së testimit për të automatizuar sistemin e listëpagesave.*

10 www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Albania.pdf (faqe 9)

11 www.sigmaweb.org/publications/Regional-Overview-Western-Balkans-Monitoring-February2022-.pdf, faqe 6, tabela 1

12 https://weber-new.s3.us-west2-.amazonaws.com/wp-content/uploads/09162240/11/2018/WeBER-National-Monitoring-PAR-ALBANIA-AL.pdf

*Zbatimi i strategjive të reformës në administratën publike (RAP) 2015-2022 dhe të reformës të menaxhimit të financave publike (MFP) 2014-2022 ka vazhduar pavarësisht ndikimit të pandemisë Covid 19.*

*Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti të:*

- *përmirësojë kuadrin rregullator për planifikimin e integruar të politikave dhe të rrisë kapacitetet për planifikimin dhe monitorimin e politikave, duke shtrirë sistemin e integruar të politikëbërjes;*
- *aktivizojë mekanizmin e parashikuar në ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore duke përgatitur raportin e monitorimit mbi statusin e institucioneve të varësisë;*
- *inkurajojë zbatimin e ligjit të shërbimit civil në të gjitha kategoritë, të bazuar në merita, sidomos në nivelin vendor ku nevojitet depolitizimi i shërbimit civil dhe gjithashtu trajnim më i mirë, dhe miratojë dokumentin e politikës së pagave për nëpunësit civilë dhe zgjerojë automatizimin e sistemit të listëpagesave përmes Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ).”*

**Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë më 19 Tetor 2021**

Duke konsideruar rëndësinë e kësaj reforme dhe prioritetin e saj në kuadër të integrimit evropian, me qëllim sigurimin e një kornize afatmesme për një dialog më të strukturuar mbi administratën publike duke përfshirë qeverisjen lokale, në kuadër të monitorimit të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), është krijuar Grupi i Posaçëm për Reformën e Administratës Publike BE- Shqipëri (PAR SG)[13]. Diskutimet në këtë platformë kryesore shërbejnë për të çuar përpara punën në kuadër të Reformës në Administratën Publike. Në kuadër të transparencës të reformës në administratën publike dhe vlerësimeve të strukturave të Bashkimit Evropian, me zyrtarizimin e tyre, konkluzionet operacionale të Grupit të Posaçëm publikohen në faqen zyrtare të DAP.

Zhvillimet në fushën e mirëqeverisjes dhe administrimit publik janë diskutuar dhe në takimin e 12-të të Komitetit të Stabilizim Asociimit. Ky takim ka shërbyer për të diskutuar mbi hapat, vizionin, strategjinë, prioritetet dhe sistemin e politikave me efektivitet, duke përfshirë përmirësimin e kuadrit rregullator mbi planifikimin e politikave të integruara. Gjithashtu u referua progresi në drejtim të zbatimit të parimeve të meritës në rekrutimin në shërbimin civil në nivel qëndror dhe vendor dhe përdorimit të SIMBNJ dhe automatizimit të listëpagesës. Për shkak të natyrës së saj gjithëpërfshirëse, vlen të përmendet se Reforma në Administratën Publike është një ndër më sfidueset, megjithatë në krahasim me prioritetet e tjera është ajo që vazhdimisht ka marrë vlerësimin më të lartë për progresin e bërë.

## Komponentët që kanë nevojë për adresim me qëllim përmirësimin e implementimit të SNRAP dhe rekomandimet mbi zbatimin e tyre

Duhet theksuar se gjatë vitit 2021 janë realizuar një sërë masash të parashikuara në plan veprimin 2018-2022. Edhe pse dy vitet e fundit kanë përkuar me kufizimet dhe vështirësitë e imponuara nga situata pandemike, përshtatja e mjeteve dhe përdorimi i teknologjisë së informacionit kanë ndihmuar në realizimin në kohë dhe me efiçensë të shumë produkteve.

Kështu afati kohor i përfundimit të zbatimit të projektit IPA “Zbatimi i reformës së shërbimit civil në administratën publike” u shty nga muaji prill deri në muajin Tetor 2021, pikërisht për të mundësuar finalizimin e një sërë masash me përfitues kryesor DAP, Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe Shkollën e Administratës Publike.

13 Gjatë vitit 2021 janë ndjekur rekomandimet e lëna në vijim të takimit të-9 të të grupit të posaçëm dhe mbi zbatimin e tyre është raportuar në takimin e -10të të zhvilluar në datë 28.01.2022.

Procesi i monitorimit të vazhdueshëm të SNRAP që kryhet nga DAP ka ndihmuar në identifikimin e problematikave dhe sjelljen e tyre në vëmendje të institucioneve me qëllim marrjen e masave për adresimin e tyre në mënyrën dhe kohën e duhur.

Diskutimi dhe përfshirja e këtyre problematikave në raportet e monitorimit duke propozuar dhe masa konkrete për t'u adresuar, ka shtuar vëmendjen e institucioneve ndaj komponentëve që kanë nevojë për përpjekje të shtuara për të përmirësuar implementimin e më tej realizimin final të planit të veprimit dhe treguesve të rezultatit të SNRAP.

Kështu, bazuar në analizimin e kontributeve dhe raportimeve të institucioneve të përfshira në zbatimin e SNRAP, elementët të cilët kanë nevojë për adresim dhe vëmendje të shtuar **janë paraqitur nën cdo shtyllë së bashku me propozimet për adresim**. Kryesisht, puna e institucioneve të përfshira në zbatimin e strategjisë duhet të fokusohet në zbatimin e masave sipas **afateve të përcaktuara** dhe në funksion të realizimit të produkteve dhe rezultateve të parashikuara.

Sa i takon numrit të nën-aktiviteteve të parealizuara dhe afateve të tyre për t'u finalizuar, 5 nën-aktivitetet për të cilat nuk ka filluar implementimi, janë jashtë afateve të parashikuara për të filluar zbatimin.

Këto nën-aktivitete janë:

- Dizenjimi dhe përshtatja e platformës IPSIS për përdorim nga Njësitë e Qeverisjes Vendore, pilotimi i implementimit të sistemit në **5 bashki**;
- Rishikimi i rregullave të zbatimit të vlerësimit të ndikimit, me qëllim përmirësimin e procesit të Vlerësimit të ndikimit;
- Zhvillimi i sistemeve që sigurojnë menaxhimin efektiv dhe efiçent të burimeve nëpërmjet mirëpërdorimit të burimeve njerëzore të brendshme të ASPA-s dhe ofrimit të shërbimeve për të tretët; ASPA ka hartuar dokumentin e tarifimit dhe ka vijuar me përgatitjet për miratimin e këtij dokumenti nga Bordi;
- Miratimi i vendimeve të reja për pagat dhe zbatimi i strukturës së re;
- Zbatimi i programit "Young Civil Servant Scholarship Scheme" dhe qëndrueshmëria e kësaj praktike; Departamenti i Administratës Publike ka përgatitur Guideline për programin "Ngritja e kapaciteteve për nëpunësit civilë të Administratës Publike, përfshirë trajnimet / praktikat në administratat e Shteteve Anëtare të BE-së dhe skemën e bursave ("qelizat e reja")" financuar nga programi kombëtar IPA 2020. Granti është në fazë vlerësimi.

Gjithashtu nga totali i 36 nën-aktiviteteve të cilët janë aktualisht në zbatim e sipër, 13 prej tyre janë përtej afatit të parashikuar në Planin e Veprimit për t'u realizuar plotësisht. Këto aktivitete duhet të jenë në vëmendje të institucioneve dhe të merren masa për realizimin gjatë gjashtë mujorit të parë të 2022.

# Ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit të strategjisë

Plani i Veprimit të SNRAP 2018-2022 i kostuar parashikon që kosto totale e zbatimit të aktiviteteve është 1,972,158 mijë ALL, nga të cilat 944,391 mijë ALL mbulohen nga buxheti i shtetit, 875,535 mijë ALL nga donatorët dhe 152,232 mijë ALL (8%) është hendeku financiar.

Gjatë vitit 2021 ka përfunduar projekti "Zbatimi i reformës së shërbimit civil në administratën publike". Përfituesit e projektit ishin Departamenti i Administratës Publike, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike dhe Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Disa prej produkteve të këtij projekti kanë kontribuar në realizimin e masave të parashikuara në planin e veprimit të SNRAP.

Grafiku 5 Burimet e financimit




Ky projekt mbështeti Departamentin e Administratës Publike dhe organet e tjera mbikëqyrëse në standardizimin dhe unifikimin e menaxhimit të shërbimit civil, me qëllim krijimin e një shërbimi civil të pavarur, transparent dhe profesional në nivel qendror, lokal dhe në institucionet dhe agjencitë e varësisë. Projekti ka filluar më 8.10.2018 dhe është zbatuar në një periudhë kohore prej 36 muajsh.

Gjithashtu një informacion mbi shpenzimet buxhetore është referuar dhe për masat nën objektivin 5 dhe 8, ku është shpenzuar për: 1. Ngritjen e Qendrave të Integruara për ofrimin e shërbimeve publike 36.54 %; 2. Ndarjen e Administrimit të Sporteleve të Shërbimit (front-office) për publikun nga zyrat përgjegjëse (back office) të shërbimit në institucionet qendrore 15.87%; 3. Zhvillimin e kuadrit për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike 15.87%; 4. Zhvillimin e kapaciteteve institucionale të ADISA-s dhe institucioneve qendrore për rritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve 15.87%; 5. Ri-inxhinierimin e shërbimeve publike, si një masë e nevojshme për thjeshtimin e procedurave administrative dhe uljen e numrit të hapave që duhet të ndërmarrin qytetarët dhe personeli mbështetës 15.87%.

Sa i përket objektivit 11: Rritja e kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike për garantimin e të drejtave të qytetarëve dhe aksesi në informacion në lidhje me zbatimin e aktivitetit 11.1.1 "plotësimi me programet e transparencës për të gjitha institucionet e administratës qendrore" janë shpenzuar 25% e fondeve të planifikuara gjatë 2021. Aktivitetet e tjera të planifikuara për vënien në zbatim të programit institucional të transparencës nga autoritetet publike janë mbuluar me kosto administrative.

Nga analiza që DAP ka bërë bazuar në Planin e Aktiviteteve 2018-2022 të kostuar, vëmendja duhet të përqendrohet në drejtim të objektivave me hendek financiar. Në vlerë totale hendeku financiar është 152,232 mijë ALL ose 8% e kostos totale të parashikuar të zbatimit të aktiviteteve të SNRAP. Megjithatë vlen të përmendet që disa prej nën-aktiviteteve të parashikuara janë realizuar dhe do të realizohen nëpërmjet punës së institucioneve të përfshira në zbatimin e strategjisë si detyra shtesë funksionale të nëpunësve publikë ç'ka nuk përkthehet në kosto shtesë faktike apo nevojë të mëtejshme për mbulim apo financim.

Shtylla I

# POLITIKËBËRJA DHE CILËSIA E LEGJISLACIONIT

Politikat nën këtë shtyllë synojnë forcimin e sistemit të planifikimit strategjik, monitorimit të politikave dhe legjislacionit, raportimit dhe vlerësimit, që i shndërron prioritetet e qeverisë në veprime konkrete. Përmes ngritjes së sistemeve të informacionit për planifikimin e politikave dhe financave publike synohet përmirësimi i koordinimit dhe bashkëpunimit midis ministrive, rritja e transparencës për dokumentet strategjike të qeverisë dhe monitorimi në kohë reale.

Objektivat e planifikuara në kuadër të Shtyllës I synojnë:



Politikat planifikuese dhe koordinuese të përmirësuara për të hartuar dokumenta strategjikë të qeverisë që i shndërrojnë prioritetet në veprime konkrete



Sistem transparent i hartimit të ligjeve, gjithëpërfshirës, i bazuar në politika dhe që siguron përafrimin me acquis



Ndërtimi i një sistemi monitorimi dhe vlerësimi efikas të strategjive, programeve dhe kuadrit ligjor në fuqi, të mbështetur në: 1) mbledhjen e të dhënave, nëpërmjet një procesi asnjanës dhe transparent, për hartimin dhe zbatimin e strategjive, programeve dhe legjislacionit, si dhe 2) në hartimin e analizave për vlerësimin e efekteve të krijuara nga zbatimi

**Shtylla 1 “Politikëbërja dhe Cilësia e Legjislacionit”** parashikon realizimin e 46 nën-aktiviteteve nga të cilat kanë filluar të zbatohen 44 nën-aktivitete si dhe janë realizuar plotësisht 36 nën-aktivitete.

**Grafiku 6 Statusi i realizimit të qëllimit politik: Politikëbërja dhe Cilësia e Legjislacionit**




**Grafiku 7 Statusi i realizimit të produkteve sipas Objektivave**




## Lista e të gjithë indikatorëve me vlerën bazë, vlerën e matur dhe vlerën e synuar në 2021

| Indikatorët | Vlera Bazë | Vlera e matur në 2021 | Vlera e synuar për 2021 | Trendi (tendencë në ulje/tendencë në rritje/ arritur) |
|---|---|---|---|---|
| 1a. 100% e kuadrit strategjik rregullator i hartuar dhe i zbatuar | 0.83 | 70% | 100% | Vlera në rritje nga viti 2020 |
| 1b. “100% e strategjive dhe e cilësisë sektoriale e përfunduar” (me llogaritjen e kostos së planit të veprimit dhe grupin e indikatorëve me objektivat përkatës) | 0.7 | 85.30% | 100% | Vlera afërsisht e njejtë nga viti 2020 |
| 1c. 70% e stafit të politikëbërjes të ML-së i trajnuar të paktën një herë për çështjet e planifikimit strategjik | 0.2 | 52% | Tendencë në rritje | Arritur gjatë 2020 mbi 86 % e stafit të politikëbërjes të ML-së i trajnuar, të paktën, një herë për çështjet e planifikimit strategjik |
| 2a. Cilësia e analizës së vlerësimit të ndikimit dhe vlerësimi i zbatimit të akteve ligjore të rëndësishme të hartuara dhe të publikuara | Tendencë në rritje | 74% | Tendencë në rritje | Arritur |
| 2b. Përqindja e akteve ligjore të cilat kanë kaluar përmes një procesi të gjerë konsultimesh publike dhe provat e përfshirjes së publikut dhe palëve të interesuara në proces | 0.1 | 65.78% | Tendencë në rritje | Mesatarja e tre viteve të fundit 72,25% |
| 2c. Numri i akteve ligjore të ndryshuara brenda vitit të parë të miratimit | 10 në 2015 | 1 | Tendencë në ulje | Arritur |
| 3a Përqindja e raporteve të monitorimit dhe vlerësimit për strategjitë e rëndësishme të hartuara dhe të publikuara në baza vjetore. | 0.1 | 34% | Tendencë në rritje | Arritur |
| 3b Shkalla në të cilën raportimi jep informacion mbi rezultatet e arritura (indikatori i SIGMA-s) | 3/2014 baseline | 1 | Tendencë në rritje | Tendencë në ulje |
| 3c. Numri i konsultimeve publike/prezantimeve të organizuara për të diskutuar raportet e monitorimit dhe vlerësimit. | 4 | 21 | Tendencë në rritje | Arritur |

**Përafrimi i kuadrit strategjik të vendit me Axhendën e 2030 është iniciuar dhe ka nisur procesi i hartimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030 (SKZHIE)**. Ky proces ka kaluar në disa hapa parapërgatitorë dhe është iniciuar procesi i hartimit të SKZHIE 2030 përmes Urdhërit të Kryeministrit nr. 157, datë 30.12.2021.

Me ndryshimet e fundit në kuadër të krijimit, organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, në varësi të Kryeministrit (SASPAC)[14], do të jetë kjo Agjenci e cila do të sigurojë hartimin, zbatimin dhe harmonizimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, strategjive sektoriale, bashkërendimin e ndihmës së huaj dhe bashkërendimin e procesit të administrimit të projekteve me interes kombëtar.

**Në drejtim të funksionimit të mekanizmit të qasjes së integruar sektoriale** kanë vijuar të diskutohen në forumet e nivelit të lartë të dialogut dhe politikëbërjes (GMIP/KDS) çështjet që lidhen me planifikimin e politikave të kuadrit strategjik, planifikimin financiar, proceset e integrimit në BE dhe nismave të zhvillimit kombëtar në sektorët me përparësi. Ky mekanizëm ka siguruar dhe garantuar qëndrueshmëri në arritjen e zbatimit të reformave, përmbushjes së prioriteteve dhe adresimin e çështjeve të integrimit evropian. Kështu indeksi i performancës për mekanizmin për vitin 2021 rezulton mbi mesataren (52%).

- Aftësia planifikuese e dokumentave strategjikë bazuar në Programin Analitik Vjetor të Projekt-akteve rezulton të jetë në nivelin 70 %[15][16].
- Për kuadrin strategjik janë hartuar **21 raporte performance.** Megjithatë mbetet prioritar përmirësimi i mëtejshëm i kapaciteteve nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit lidhur me rëndësinë e procesit apo dhe trajnimeve të dedikuara për këtë qëllim.
- Nga lista e 20 dokumentave strategjikë të aprovuara për vitin 2021, rezultati mesatar i cilësisë së kuadrit strategjik të shqyrtuar rezulton 85.3%, rezultat që shënon një trend afërsisht të njëjtë me vitin 2020 (88.57%), me trend rritje prej 9% krahasuar me vitin 2019.

Përmirësimi dhe mbajtja në të njëjtat nivele e rezultatit mesatar të cilësisë së kuadrit strategjik lidhet me masat e ndërmarra nga Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes dhe ministritë e linjës lidhur me zbatueshmërinë e standarteve të sistemit dhe ndjekjes së procedurave të vlerësimit bazuar në metodologjinë e kritereve që parashikojnë standartet e sistemit IPSIS.

**Në drejtim të plotësimit të kritereve të cilësisë për kuadrin strategjik,** për vitin 2021 rezulton 55% me një trend të qëndrueshëm me vitin 2020 (60%). Me synim zbatimin e parimeve "Principles of Public Administration" të BE-së[17], është hartuar dhe konsoliduar sistemi i vlerësimit të kuadrit strategjik lidhur me përputhshmërinë e parimeve të mirëqeverisjes. Korniza e monitorimit për zbatimin e Parimeve shtrihet në fushat e: (i) Kuadrit strategjik të reformës në Administratën Publike; (ii) Zhvillimit dhe koordinimit të politikave; (iii) Shërbimit publik dhe menaxhimit të burimeve njerëzore; (iv) Llogaridhënies; (v) Ofrimit të shërbimeve dhe (vi) Menaxhimit të Financave Publike.

14 VKM Nr.642, datë 29.10.2021 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës".

15 Ndërkohë 80 % e dokumentave strategjikë të mirëqeverisjes janë planifikuar dhe hartuar për vitin 2021, prej të cilave 90 % e dokumentave strategjikë të planifikuara në PPAP janë miratuar në përputhje me procedurat e parashikuara për vitin 2021.

16 62.7 % e kuadrit strategjik rregullator është zbatuar për vitin 2021, me një trend 8 herë më të lartë krahasuar me vitin 2020 dhe 16 % më shumë se viti 2019 duke treguar angazhim të lartë institucional në përgatitjen e raporteve të monitorimit.

17 Bruksel 2020 .10. 6 , COM 660 ,2020 final

Sistemi i vlerësimit për përputhshmërinë e kuadrit strategjik bazuar në parimet e administrimit publik po pilotohet në disa sektorë (si psh Axhenda Dixhitale, etj.) dhe më pas do të shtrihet në të gjithë sektorët.

**Në drejtim të përmirësimit, forcimit dhe shkëmbimit të njohurive në kuadër të përdorimit të sistemit IPSIS** të krijuar për menaxhimin dhe planifikimin e integruar, janë marrë masat në drejtim të zhvillimit të trajnimeve mbi përdorimin e sistemit. Për këtë qëllim, gjatë vitit 2021 janë trajnuar përdoruesit e strukturave të politikave përmes Rrjeteve IPSIS, të cilët kanë përforcuar dhe thelluar njohuritë e tyre lidhur me standartet e sistemit.

Një event i rëndësishëm në këtë drejtim ishte dhe mbajtja e workshop-it rajonal në Tiranë në kuadër të forcimit dhe shkëmbimit të njohurive mbi "Sistemin e Planifikimit të Integruar dhe roli i sistemit IPSIS dhe AFMIS në inkorporimin e çështjeve gjinore/gender në politikëbërje".




Workshop-i rajonal i organizuar nga UN Women shërbeu për të prezantuar sistemin IPSIS dhe ndarë eksperiencën me të gjithë vendet e rajonit në kuadër të funksionimit të sistemeve menaxheriale për një harmonizim të politikave, buxheteve dhe performancës në zbatim të reformave dhe integrimit në BE.

**Sa i takon zbatimit të procesit të vlerësimit të ndikimit** është shënuar progres në rritjen e cilësisë dhe efektivitetit në hartimin e politikave/legjislacionit në Shqipëri në këto drejtime:

- Për 2021 **cilësia e analizës së vlerësimit të ndikimit** dhe vlerësimi i zbatimit të akteve ligjore të rëndësishme të hartuara dhe të publikuara shënon vlerën **74%,** një rritje krahasimisht me nivelin 72% në vitin 2020 dhe 64% në vitin 2019[18];

- Raportet e Vlerësimit të Ndikimit për projektligjet që plotësojnë kriteret për t'iu nënshtruar RIA-s, **janë të publikuara në faqen zyrtare të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.** Me synim zbatimin e këtij procesi gjatë vitit 2021 u hartuan si dhe u rishikuan nga Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA në Kryeministri 42 raporte RIA ndërsa 17 prej të tyre janë miratuar po nga kjo njësi;

- **Në lidhje me monitorimin sistematik të zbatimit të Programit të Përgjithshëm Analitik të Projekt-akteve** për vitin 2021, Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA ka vijuar me monitorimin e zbatimit të PPAP për vitin 2021. Në kuadër të këtyre monitorimeve është konstatuar se përqindja totale e realizimit të Planit Analitik 2021 është 70%. Ndërkohë Qendra e Botimeve Zyrtare (QBZ), gjatë vitit 2021 **ka publikuar të gjitha versionet e konsoliduara të akteve ligjore të botuara përgjatë këtij viti**;

- Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë **ka monitoruar ndryshimet e legjislacionit brenda harkut kohor të 12 muajve** nga miratimi i projektligjit bazë apo i ndryshimit më të fundit të tij. Të dhënat e procesit të monitorimit tregojnë se në 100 projektligje/akte normative, të cilat janë miratuar në vitin 2021, vetëm një prej tyre ka bërë ndryshime brenda harkut kohor të 12 muajve nga miratimi i vetë ligjit apo i ndryshimit më të fundit të tij[19];

18 Target: tendencë në rritje. Indikatori është arritur.

19 Fakti që ky indikator vijon të jetë në nivele të ulta tregon qëndrueshmëri, cilësi dhe planifikim më të mirë të legjislacionit të hartuar brenda një viti.

- Zhvillime ka patur në drejtim të **forcimit të kapaciteteve** brenda ministrive ku përgjatë vitit 2021 janë trajnuar **68 anëtarë të rrjetit RIA** me qëllim përvetësimin sa më mirë të këtij procesi dhe përmirësimin e cilësisë së tij.

  Një aktivitet i rëndësishëm në këtë drejtim ishte dhe zhvillimi i trajnimit për trajnerët (ToT) i mbajtur në muajin shtator 2021, me mbështetjen e ReSPA-s përmes aplikimit të këtij institucioni për *"In-country support mechanism"*, ku u zhvillua trajnimi për trajnues (ToT) për pjesëtarët e Njësisë së Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA në Kryeministri.

  Forcimi i kapaciteteve të nëpunësve që janë pjesë e rrjetit të përhershëm të RIA ka ndikuar në përvetësimin më të mirë nga ana e tyre të procesit të vlerësimit në ndikim të akteve dhe gjithashtu ka përmirësuar cilësinë në përgatitjen e akteve ligjore.

  **Një nga objektivat kryesorë të sistemit të mirëqeverisjes lidhet me rritjen e cilësisë së llogaridhënies dhe transparancës duke patur si komponent kryesor procesin e konsultimit publik.** Në këtë drejtim për të mundësuar krijimin e një sistemi eficent të politikave dhe hartimit të ligjeve sa më gjithëpërfshirës dhe transparentë janë krijuar mekanizmat

  

  e nevojshëm ligjorë që synojnë unifikimin e procedurave të konsultimit publik dhe metodologjisë përkatëse. Përmirësimi i vazhdueshëm i këtij procesi ka ardhur falë standardizimit të metodave të planifikimit, organizimit dhe realizimit të konsultimit publik bazuar mbi principe themelore siç janë transparenca, gjithëpërfshirja dhe dhënia e feedback-ut.

- Përgjatë vitit 2021është **miratuar**[20] **korniza rregullatore** dhe konkretisht udhëzuesi për procesin e konsultimit publik. Ky mekanizëm mundësoi  hartimin dhe zbatimin e Planit Vjetor për Konsultimin Publik 2021.

- Vëmendje i është kushtuar dhe procesit të ngritjes së kapaciteteve të nëpunësve ku përgjatë vitit 2021 janë **trajnuar 75% (305) e nëpunësve civilë** të administratës publike për kuadrin metodologjik dhe procesin e konsultimit publik[21].

  Gjithashtu, janë zhvilluar **11 webinar-e** të dedikuara me ministritë e linjës për inicimin e procesit të përgatitjes së Raporteve Vjetore për konsultimin publik lidhur me matjen e rezultateve dhe Indeksit të Performancës në zbatim të kuadrit metodologjik të aprovuar. Në këtë periudhë u finalizuan **11 Raporte vjetore** institucionale të konsultimit, të cilat u publikuan konform udhëzuesit në Regjistrin Elektronik.

  Përqindja e akteve ligjore të cilat kanë kaluar përmes një procesi të gjerë konsultimesh publike, shënon vlerën 65.78% krahasimisht me vitin 2020 ku shënohet vlera 79.56%, vitin 2019 ku shënonte vlerën 71.4% (vlera për vitin 2018 ishte 47.22%). Indikatori i cilësisë së konsultimit publik vlerësohet në nivelin 4.86 pikë për vitin 2021, krahasimisht me vitin 2020 ku shënonte vlerën 5.66 pikë.

  Nga analiza e treguesve evidentohet se nevojiten përpjekje të shtuara në realizimin e këtij procesi në mënyrë sa më transparente dhe efektive dhe përfshirjen e publikut dhe aktorëve të tjerë në procesin e konsultimit publik.

20 Urdhëri nr. 3 datë 29.1.202.

21 Janë organizuar 25 workshope/webinare trajnimi OJT me fokus rritjen  e kapaciteteve dhe ekspertizës së njohurive të Koordinatorëve të Konsultimit Publik.

**Në lidhje me këtë indikator dhe impaktin që ka, në raportin e monitorimit të SIGMA është nënvizuar se:** "në përgjithësi, cilësia dhe stabiliteti i legjislacionit në Shqipëri është i lartë. Përqindja e ligjeve të amenduara brenda një viti nga miratimi i tyre është e ulët, fakt ky që tregon se mjedisi ligjor është i parashikueshëm dhe se hartimi ligjor është efektiv"[22]. Në shumicën e rasteve, Qeveria miraton aktet nënligjore të detyrueshme në kohën e duhur, gjë që mundëson zbatimin e plotë të ligjeve të reja. Në lidhje me përputhshmërinë e raporteve të hartuara në vitin 2021 me standartet IPSIS; janë marrë të gjitha masat që raportet e monitorimit për kuadrin strategjik të mirëqeverisjes të jenë sipas procedurave tashmë të miratuara në vitin 2020[23].

- Për të monitoruar zbatimin e kërkesave dhe standarteve IPSIS janë hartuar 15 Paketa Vlerësimesh për Raportet e Performancës në fushat e mirëqeverisjes, me qëllim garantimin e zbatueshmërisë të objektivave të reformave, të indikatorëve, identifikimin e risqeve dhe përdorimin efikas të burimeve financiare. Nga raportet e performancës të aprovuara në mekanizmin GMIP/KDS, raporti i hartuar në kuadër të monitorimit të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike është vlerësuar si një ndër tre raportet e hartuara me standarte të larta.

Për vitin 2021 shënohen 21 konsultime publike ku janë diskutuar raportet e monitorimit të strategjisë, vlera e shënuar në vitin 2020 është 21, për vitin 2019: 10, ndërsa për vitin 2018: 11.

**Programi "Administrata që duam"** ka vijuar të zbatohet edhe përgjatë vitit 2021 me qëllim rritjen e efiçencës së administratës publike. Në kuadër të përmirësimit të performancës së nëpunësve civilë për të ofruar shërbime më të mira për qytetarët, ky program fokusohet tek katër komponentët kryesorë në drejtim të orientimit, aftësimit, motivimit dhe ndërveprimit.




- Orientimi i administratës publike: janë finalizuar manualet dhe udhëzuesit për Zbatimin e Legjislacionit të Shërbimit Civil dhe Menaxhimin e Burimeve Njerëzore. Të gjitha materialet e finalizuara shërbejnë për të përmirësuar proceset e përditshme të punës për menaxhimin e burimeve njerëzore si dhe për zbatimin e duhur të kuadrit ligjor të shërbimit civil.

- Aftësimi i administratës publike: janë zhvilluar një sërë trajnimesh për nëpunësit civilë në kuadër të zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil dhe manualeve të hartuara mbi unifikimin e praktikave të menaxhimit të burimeve njerëzore, mbi përdorimin e Sistemit Informatik për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) dhe platformës "administrata.al".

Gjatë këtij viti, risi ka rezultuar aplikimi i instrumenteve të rinj ku janë zhvilluar sesione të ndryshme *coaching* nëpërmjet metodave inovative për zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, Kodit të Procedurave Administrative, Manualit të Vlerësimit të Performancës etj.

22 www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Albania.pdf (faqe 30).

23 Në zbatim të VKM Nr. 290, datë 11.4.2020 "Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS)».

Këto trajnime kanë ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e aftësimit dhe të efiçensës së nëpunësve civilë në kryerjen e proceseve të përditshme të punës si dhe për rrjedhojë rritjen e cilësisë së shërbimeve publike.

- Sa i takon komponentit të motivimit: tashmë sistemi i vlerësimit të rezultateve në punë është rishikuar dhe qasja e re ndaj vlerësimit të performancës do të zbatohet në praktikë pas miratimit të ndryshimeve të nevojshme ligjore për përmirësimin e procesit.

  Një risi në drejtim të unifikimit të procesit të vlerësimit dhe bërjes së tij sa më transparent është dhe krijimi i modulit elektronik për kryerjen e vlerësimit të performancës. Tashmë moduli është pjesë e platformës së integruar "administrata.al" dhe mbi përdorimin e tij janë organizuar trajnime të dedikuara për zhvillimin e procesit të vlerësimit të performancës për nëpunësit civilë.

- Në drejtim të ndërveprimit të administratës: janë funksionale 7 rrjete profesionale në fushat kryesore si: Rrjeti i Sekretarëve të Përgjithshëm, Rrjeti i Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA), Rrjeti i Politikave dhe Programeve të Zhvillimit, Rrjeti i Programit Buxhetor Afatmesëm, Rrjeti i Prokurimeve, Rrjeti i Integrimit dhe Rrjeti i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

  Platforma "administrata.al" ka luajtur një rol kyç në ndërveprimin dhe komunikimin në nivel ndërinstitucional për të lehtësuar punën e nëpunësve që menaxhojnë proceset e burimeve njerëzore. Në këtë kuadër është finalizuar seti i indikatorëve për menaxhimin e burimeve njerëzore, i integruar në platformën "administrata.al", i cili do të shërbejë si një mekanizëm monitorues dhe vlerësues për zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil dhe zbatimin e standardeve të unifikuara të praktikave të punës në të gjithë administratën publike.

## Sfidat dhe rekomandimet:

- Funksionimi i plotë dhe i vazhdueshëm i IPSIS, duke siguruar monitorimin në mënyrë më efikase dhe të koordinuar të dokumenteve kryesore strategjike të vendit; përmes **ndërgjegjësimit dhe trajnimit të vazhdueshëm të nëpunësve civilë të përfshirë në proces; si dhe kalimi nga "raportimi" në "sistem të integruar monitorimi dhe analize të performancës"**;

- Rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e procesit të konsultimit me publikun dhe përfshirjes së shoqërisë civile; **evidentimi i mekanizmave për të inkurajuar dhënien e kontributeve/mendimeve në lidhje me politikat e zhvilluara nga institucionet publike; përmes forcimit të mekanizmit të feedback dhe monitorimit-raportimit;**

- Monitorim periodik lidhur me zbatueshmërinë e Planit Vjetor të Konsultimit Publik nga institucionet; **monitorimi i procesit dhe hartimi i raporteve të performancës;**

- Vënia në funksion të plotë e platformës elektronike për konsultimin publik; përmes ofrimit të mundësive për t'u përdorur dhe aksesuar sa më thjeshtë nga të gjithë aktorët/individët; **përmirësimi (upgrade) i Regjistrit Elektronik për Konsultimet Publike për të mundësuar gjenerim më efektiv të statistikave në konsultimet e kryera publike;**

- Forcimi i mekanizmit të menaxhimit të integruar të politikave për Mirëqeverisjen dhe Administrimin Publik të ndërlidhura me proceset e integrimit evropian dhe monitorimin e financimeve të BE; **përmes matjes së vazhdueshme të performancës së mekanizmit të këtij grupi;**

- Në lidhje me vlerësimin e ndikimit rregullator (RIA) duhet të vijojë rritja e trendit mbi cilësinë e akteve që kalojnë përmes RIA dhe të zgjerohet fusha e veprimit dhe në përgatitjen e akteve të tjera; **kryerja e trajnimeve nga ana e trajnerëve (ToT) për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të vazhdueshme ndaj zbatimit të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA).**

Shtylla II

# ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ADMINISTRATËS PUBLIKE

Politikat nën këtë shtyllë synojnë rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj publikut dhe përafrimin më të shpejtë me standardet dhe kërkesat e BE-së nëpërmjet përdorimit të mjeteve inovative dhe sporteleve unike. Gjithashtu synohet përmirësimi i mënyrës së funksionimit dhe organizimit të administratës publike nëpërmjet fuqizimit të strukturave institucionale.

Objektivat e planifikuara në kuadër të Shtyllës II synojnë:



Fuqizimin e strukturave të administratës publike me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve ndaj publikut.



Shërbime publike të përmirësuara, të aksesueshme, dhe të integruara duke reduktuar mundësitë për korrupsion dhe forcimin e etikës në ofrimin e shërbimeve publike

Shtylla II “Organizimi dhe Funksionimi i Administratës Publike” parashikon realizimin e 18 nën-aktiviteteve të cilat kanë filluar të zbatohen, prej këtyre janë realizuar plotësisht 13 nën-aktivitete ose 72%.







## Lista e të gjithë indikatorëve me vlerën bazë, vlerën e matur dhe vlerën e synuar në 2021

| Indikatorët | Vlera Bazë | Vlera e matur në 2021 | Vlera e synuar për 2021 | Trendi (tendencë në ulje/tendencë në rritje/ arritur) |
|---|---|---|---|---|
| 4 a. Shkalla në të cilën strukturat e ministrive dhe institucionet e tjera janë racionale dhe koherente (indikatori i SIGMA-s) | 2/2014 baseline | 2 | Tendencë në rritje | Vlerë e njejtë |
| 5a. Numri i shërbimeve të qeverisë qendrore me ndërveprim të përmirësuar në zyrat e pritjes | 300 | 1209 | Tendencë në rritje | Arritur |
| 5b. Numri i zyrave me një ndalesë, të ngritura në njësitë e qeverisjes vendore | 1 pilot | Në 100% të bashkive | 100% | Arritur |

Në drejtim të fuqizimit të strukturave të administratës publike dhe në zbatim të programit të qeverisë për katërvjeçarin 2021-2025, u rishikuan fushat e përgjegjësisë së ministrive të linjës dhe u bë riorganizimi i portofoleve të tyre për t'iu përgjigjur një qasjeje të re dhe sistemike si dhe për të siguruar një ndërveprim efikas të sistemit të qeverisjes me realitetin shqiptar dhe nevojat e qytetarëve të saj. Për të siguruar përputhje me politikën e qeverisë dhe mbështetjen me bazë ligjore janë analizuar, vlerësuar dhe reflektuar risitë dhe ndryshimet në sistemet ministrore si vijon:

Për sistemin e Kryeministrisë

- Krijimi i **Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët**[24] për t'i dhënë peshën e duhur funksioneve që lidhen me trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me rininë dhe fëmijët, si prioritet i dedikuar i qeverisë, programimin dhe aftësinë për të thithur investime dhe projekte;
- Kalimi i Agjencisë Kombëtare të Rinisë nga institucion në varësi të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në varësi të Ministrit të Shtetit;
- Përfshirja në portofolin ministror të **Ministrit të Shtetit për Standardet e Shërbimeve** me qëllim hartimin, bashkërendimin dhe zbatimin e politikave shtetërore që synojnë standarde të larta të shërbimeve publike, lehtësimin e ofrimit të shërbimeve publike, sigurimin e cilësisë dhe përballueshmërisë së tyre;
- Krijimi i **Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës**[25] me synim krijimin e një institucioni të centralizuar me qëllim përmirësimin e procesit të programimit strategjik dhe të monitorimit të zbatimit të strategjive të ndryshme;
- Krijimi i **qëndrave të ekselencës** si një iniciativë e ndërmarrë në kuadër të platformës së re **"Gati për Shqipërinë"** me qëllim punësimin dhe përfshirjen e individëve që duan të kontribuojnë me ide, projekte dhe iniciativa të ndryshme zhvillimore[26];
- Krijimi i **Agjencisë për Media dhe Informim**[27] me synim sigurimin e transparencës në lidhje me politikat, aktivitetet, projektet, eventet si dhe risitë dhe problematikat në fushën e medias.

Për sistemin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

- Miratimi i bazës së nevojshme ligjore për implementimin e modelit lidhur me përcaktimin e statusit të institucioneve në agjenci, autoritete, inspektoriate, drejtori apo struktura të tjera organizative[28].

24 Miratuar me VKM nr.650, datë 3.11.2021 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për rininë dhe fëmijët".

25 Miratuar me VKM nr.642, datë 29.10.2021 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës".

26 Miratuar me VKM nr.666 datë 10.11.2021 Për disa shtesa në vendimin nr. 893, datë 17.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm".

27 Miratuar me VKM nr. 512, datë 18.9.2021 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Media dhe Informim".

28 Për këtë qëllim është miratuar: Ligji nr. 2021/88, "Për krijimin e Autoritetit Rregullator Hekurudhor" Ligji nr. 2021/89, "Për krijimin e Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore"; dhe Ligji nr. 2021/91, "Për krijimin e Autoritetit Kombëtar të Investigimit të aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore dhe Detare".

Për sistemin e Ministrisë së Drejtësisë

- Krijimi i **rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit**[29] me qëllim parandalimin dhe goditjen e korrupsionit në institucionet e administratës shtetërore. Kjo strukturë së bashku me koordinatorët e Rrjetit kundër Korrupsionit do të mbledhë, analizojë, verifikojë dhe kryejë hetim administrativ të të gjithë informacionit për rastet korruptive dhe praktikat abuzive dhe arbitrare.

Për sistemin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme

- Kalimi dhe përfshirja në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të çështjeve si: mbrojtja e të drejtave të shtetasve shqiptarë dhe komuniteteve shqiptare jashtë vendit. Kështu shkrihet struktura përkatëse në Ministrinë e Shtetit për Diasporën dhe institucionet përgjegjëse në varësi të ministrit të Shtetit kalojnë si pjesë përbërëse e sistemit të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.




**Në kuadër të reformës funksionale strukturore të sistemit të qeverisjes**, tashmë ka përfunduar procesi i ristrukturimit të institucioneve të varësisë në 4 sisteme ministrore: në sistemet e shëndetësisë, arsimit, turizmit dhe bujqësisë. Në total gjatë vitit 2021 janë kryer ristrukturimet e 28 institucioneve dhe janë krijuar 4 institucione të reja.

Procesi i ristrukturimit ka ecur paralelisht me rishikimin dhe standardizimin e përgjithshëm të përshkrimeve të punës për ministritë e linjës, në përputhje me qëllimin dhe skemën organizative dhe përcaktimin e proceseve të punës si horizontale dhe vertikale.

Në këtë drejtim tashmë:

- janë analizuar dhe përgatitur 20 procese horizontale dhe pothuaj 40 procese vertikale të përshtatura në përputhje me fushën e përgjegjësisë për ministritë e linjës. Kjo u ka ofruar institucioneve mjetet e nevojshme për të siguruar që të ketë një kuptueshmëri standarde dhe të unifikuar të proceseve të punës;

- është hartuar modeli i monitorimit për institucionet zbatuese të ligjit 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe raporti i parë i monitorimit pritet të hartohet në fund të vitit 2022[30];

- dhe është hartuar udhëzuesi mbi rishikimin funksional të sistemeve dhe ndërtimit të strukturave e organikave të institucioneve.

Udhëzuesi iu është prezantuar përfaqësuesve të burimeve njerëzore të ministrive të linjës gjatë muajit shtator dhe ofron shembuj të praktikave më të mira duke pasqyruar dhe rastet konkrete të metodologjisë së zhvillimit të analizës funksionale të institucioneve të sektorit publik, përgatitjes së strukturës së një njësie të caktuar.

29 Miratuar me VKM nr. 618, datë 20.10.2021 «Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit».

30 Reforma e institucioneve të varësisë është mbështetur nga projekti “Mbështetje për reformën e institucioneve dhe agjencive të varësisë në Shqipëri”.

**Në kuadër të ngritjes së Qendrave të Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara dhe ndarjes së zyrave pritëse nga zyrat përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve publike, gjatë vitit 2021,** janë hapur zyrat e përbashkëta ADISA me bashkinë Tepelenë dhe Himarë dhe Qendra e Integruar në bashkinë Kamëz duke e çuar kështu në **23 numrin e qendrave në total**.

Në të gjitha qendrat e integruara ADISA asistohen qytetarët për të gjitha **shërbimet publike të cilat ofrohen online përmes portalit qeveritar e-Albania** si dhe në procesin e përcjelljes së ankesave nëpërmjet portalit "ShqipëriaQëDuam.al". Gjithashtu qytetarët mund të marrin shërbime postare dhe financiare në sportelet fizike të Postës Shqiptare.








Paralelisht ka vijuar puna për ngritjen e qendrave të reja të Integruara në bashkitë Vlorë, Durrës dhe Përmet me të njëjtat standarde të ofrimit të shërbimeve publike.

Në Qendrat e Integruara ADISA, janë asistuar qytetarët në aplikimin për shërbimet publike të institucioneve qendrore nëpermjet portalit e-Albania si dhe 70 shërbime të institucioneve vendore.

Gjatë kësaj periudhe janë kryer **936,587** aplikime, janë paraqitur në sportelin e informacionit 324,558 persona, **janë asistuar 126,853 persona për hapjen e llogarive e-Albania** dhe janë përcjellë 3,118 ankesa nëpërmjet **portalit "ShqipëriaQeDuam.al"** për një total prej **1,391,116** qytetarë dhe biznese të shërbyer[31].




Me synimin për të siguruar një kornizë gjithëpërfshirëse të përsosmërisë për të mbështetur kontributin e vazhdueshëm për ofrimin e shërbimeve, ka përfunduar me sukses procesi i çertifikimit në drejtim të menaxhimit të cilësisë ISO 9001 dhe antikorrupsionit ISO 37001. Për këtë çështje, ADISA është mbështetur nga Shkolla Rajonale për Administratën Publike (ReSPA) në ngritjen e kapaciteteve mbi vlerësimin e cilësisë në këto fusha.

Tashmë të gjithë bashkitë aplikojnë programin e shërbimeve online të ofruar nga sportelet unike. Me mbështetjen e Projektit STAR 3 tashmë dhe bashkitë Pustec dhe Has kanë implementuar

31 Indikatori 5.a Numri i shërbimeve të qeverisë qendrore me ndërveprim të përmirësuar në zyrat e pritjes, target i arritur gjatë 2020 në nivel 820 shërbime.

sistemet One Stop Shop.

Deri më sot, të gjitha bashkitë kanë në përdorim Sistemin e Informacionit **One Stop Shop** për të ofruar shërbime publike. Për më tepër, gjatë vitit 2021, zgjerimi i sistemit është testuar në disa bashki me mbështetjen e STAR3, me synim zgjerimin e përdorimit në rreth 250 njësi administrative në 2022.

## Sfidat dhe rekomandimet:

- Aplikimi i sistemit të matjes së performacës mbi përfshirjen dhe konsultimin e publikut në vendimarrjen e qeverisjes vendore;
- Zhvillimi i kapaciteteve institucionale në rritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve;
- Rritja e kapaciteteve institucionale për përfshirjen dhe konsultimin e publikut dhe në nivel vendor.

## Shtylla III

# SHËRBIMI CIVIL: MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Politikat nën këtë shtyllë synojnë rritjen e kapaciteteve, transparencës dhe përgjegjshmërisë për zbatimin në mënyrë të unifikuar të legjislacionit të shërbimit civil në të gjitha nivelet si dhe rishikimin dhe përmirësimin e sistemit të pagave në shërbimin civil.



Rritjen e kapaciteteve në fushën e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil si dhe lehtësimin e procedurave në zbatim të tij



Organizimi i sistemit të pagave në shërbimin civil duke u bazuar në vlerësimin e vendit të punës, të arritjeve vjetore të nëpunësve civilë dhe rezultateve në trajnimet e detyrueshme

Shtylla III “Shërbimi Civil: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore” parashikon realizimin e 36 nën-aktiviteteve nga të cilat 34 nën-aktivitete kanë filluar të zbatohen (ose 94%) e prej këtyre të fundit janë realizuar plotësisht 22 nën-aktivitete ose 65%.

**Grafiku 10 Statusi i realizimit të qëllimit politik: Shërbimi Civil: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore**




**Grafiku 11 Statusi i realizimit të produkteve sipas objektivave**




## Lista e të gjithë indikatorëve me vlerën bazë, vlerën e matur dhe vlerën e synuar në 2021

| Indikatorët | Vlera Bazë | Vlera e matur në 2021 | Vlera e synuar për 2021 | Trendi (tendencë në ulje/tendencë në rritje/ arritur) |
|---|---|---|---|---|
| 6a. Qarkullimi vjetor (lëvizja paralele) e stafit të nivelit drejtues në të gjitha nivelet e shërbimit civil në institucionet e administratës qendrore | 0.08 | 5% | Tendencë në rënie | Arritur |
| 6b. Numri mesatar i pjesmarrësve në një procedurë rekrutimi për rekrutim nga jashtë dhe nga brenda (transferimi) në shërbimin civil | 6.b.1 13.1 për 2015 dhe 6.b2 1.3 2015 | 6.b1 28.8/6.b2 5.5% | Tendencë në rritje | Arritur |
| 6c. Numri i ankesave që kanë të bëjnë me rekrutimin në shërbimin civil të pranuar nga gjykata (duke filluar nga gjysma e dytë e vitit 2014) ka shënuar rënie | 3 | 0% | Tendencë në rënie | Arritur |
| 6d. Shkalla në të cilën sistemi i trajnimit të nëpunësve civil është funksional dhe zbatohet në praktikë (Indikatori i SIGMA-s) | 3 | 4 | Tendencë në rritje | Arritur tendencë në rritje |
| 7a. Tarimi i sistemit të pagave dhe arritja e raportit 22.1 në vitin 2020 ndërmjet pagës maksimale dhe minimale | 11.7 | 8.6 | 22.1 | Vlerë e njejtë me 2020 |
| 7b. Rritja e variacionit/ numrit të pozicioneve në skemën e pagave bazuar në përshkrimin e punës | Rritje, me të paktën 3 nivele | Do të matet pas miratimit të dokumentit të pagave | Rritje, me të paktën 3 nivele | Do të matet pas miratimit të dokumentit të pagave |
| 7c. Shkalla në të cilën sistemi i shpërblimit të nëpunësve civilë është i drejtë dhe transparent dhe zbatohet në praktikë (Indikatori i SIGMA-s) | 3/2017 | 2 | Tendencë në rritje | Vlerësuar me 2 krahasuar me 3 në 2017 |

Shqipëria është vlerësuar me pikët më të larta në rajonin e Ballkanit Perëndimor në fushën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, duke tejkaluar mesataren e rajonit, bazuar në raportin e fundit të publikuar nga SIGMA në nëntor 2021[32].

Raporti i Monitorimit të SIGMA e vlerësoi Shqipërinë për stabilitetin dhe forcimin e sistemit të shërbimit civil, ngritjen e kapaciteteve dhe rritjen profesionale të nëpunësve civilë në përballimin me sukses të sfidave të integrimit drejt Bashkimit Evropian.

Departamenti i Administratës Publike (DAP) i ka kushtuar vëmendje të veçantë ngritjes së kapaciteteve të stafit të DAP që merren me rekrutimin e nëpunësve civilë si dhe të anëtarëve të Komisioneve të Vlerësimit me fokus të veçantë në përmirësimin e intervistës, si një nga fazat më të rëndësishme të rekrutimit.




Për këtë qëllim DAP, i **mbështetur nga ReSPA, ka hartuar një udhëzues për kryerjen e intervistave të bazuara në kompetenca për kandidatët që aplikojnë për të qenë pjesë e shërbimit civil.** Udhëzuesi ofron në një mënyrë të strukturuar mbledhjen e informacionit për secilin kandidat ku do të bazohet vlerësimi i tyre gjatë intervistës së strukturuar dhe **përfshin shtatë kompetenca** (menaxhimi i informacionit; menaxhimi i detyrave dhe arritja e rezultateve; orientimi drejt të mësuarit; orientimi drejt ndryshimit; ndërtimi dhe ruajtja e marrëdhënieve profesionale; integriteti dhe komunikimi).

Intervista synon të vlerësojë ***soft skills*** të kandidatëve. Ndaj, gjatë Dhjetorit 2021 u zhvilluan trajnime me anëtarët e Komisioneve të Vlerësimit mbi **“Forcimin e procesit të intervistimit bazuar në kompetenca”**. Janë trajnuar gjithsej **78 individë** (numër unik) duke përfshirë, stafin e DAP në fushën e rekrutimit, anëtarë të Komisioneve të Vlerësimit nga Ministritë e Linjës; dhe ekspertë sipas fushave specifike.



**Ngritja e kapaciteteve në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore** ka vijuar me hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit për kuadrin ligjor të nëpunësit civil përmes metodave novatore të të mësuarit. Për këtë qëllim, më shumë se **103 nëpunës të burimeve njerëzore** janë trajnuar gjatë periudhës 3 Shkurt-31 Mars 2021. Fokusi kryesor i këtyre trajnimeve ishin **procesi/procedurat e rekrutimit në shërbimin civil**, ku përfshihen **fazat e pranimit**, **lëvizja paralele** dhe **ngritja në detyrë në shërbimin civil.**

32 http://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Albania.pdf (faqe 68)

Bashkëpunimi i DAP me institucionet e arsimit të lartë për të **tërhequr studentët më të mirë** në administratën publike (qendrore dhe vendore) ka vijuar dhe gjatë 2021 ku përfaqësues të DAP zhvilluan në muajin Dhjetor 2021, një sesion informues me studentët e nivelit *Bachelor* edhe Master në degën e Administrimit Publik në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës për t'i njohur studentët  mbi mundësitë e punësimit që ofron DAP dhe procedurat e rekrutimit në shërbimin civil.

Një kontribut të rëndësishëm në zbatimin e masave në fushën e shërbimit civil ka dhënë dhe **zbatimi i projekti IPA "Zbatimi i Reformës së Shërbimit Civil në Administratën Publike"**, në përfundim të të cilit janë finalizuar disa produkte të rëndësishme:

- **Harmonizimi i përshkrimeve të punës:** janë rishikuar dhe miratuar gjithsej **1328** përshkrime pune të finalizuara në ministritë e linjës. Ky proces u mundëson punonjësve të kryejnë më mirë detyrat e tyre funksionale dhe të kenë një performancë më të mirë në ofrimin e shërbimeve me në qendër qytetarin.

- **Manuali i rishikimit të përshkrimeve të punës në ministritë e linjës,** i cili është në funksion të nëpunësve civilë me synim vlerësimin dhe përcaktimin e proceseve të punës dhe mundësimin e delegimit të përgjegjësive;

- **Manuali për një Sistem të ri të Vlerësimit të Performancës** është finalizuar. Manuali paraqet një qasje të re ndaj vlerësimit të performancës dhe rekomandime për ndryshimet e nevojshme ligjore për përmirësimin e procesit. Në këtë kuadër, për të vënë në zbatim sa më sipër, u propozua të ndryshohet: (i) ligji nr. 152/2013, për efekt të ndryshimit të shkallëve të vlerësimit; (ii) VKM nr. 109/2014, e ndryshuar; si dhe të hartohet një udhëzim shpjegues i DAP për procesin e vlerësimit të rezultateve në punë. Duhet të nënvizohet se për këto akte ligjore e nënligjore DAP ka filluar punën për hartimin e tyre duke synuar hartimin dhe fillimin e konsultimit për këto drafte gjatë katër mujorit të fundit të vitit 2022.

**Shembull praktik:** **Moduli elektronik** për kryerjen e vlerësimit të rezultateve në punë është prezantuar gjatë muajit shtator 2021. Tashmë moduli është **pjesë e platformës së integruar "administrata.al"**. Mbi përdorimin e këtij moduli u zhvillua **trajnimi për trajnerët** mbi vlerësimin e performancës. Ky modul elektronik **unifikon, thjeshton dhe lehtëson procesin e vlerësimit të performancës** për nëpunësit civilë. Kjo risi u prezantua dhe në *workshop*-in e organizuar nga ReSPA në Tiranë mbi shkëmbimin e eksperiencave të vendeve të Ballkanit Perëndimor për procedurën e vlerësimit të performancës së nëpunësve civilë.







- **Manuali për Kodin e ri të Procedurave Administrative** i cili ka si qëllim zbatimin në mënyrë të unifikuar të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative gjatë ushtrimit të kompetencave dhe funksioneve nga nëpunësit e institucioneve të administratës publike.

- **Trajnime të dedikuara dhe sesione coaching specifike** janë mbajtur me qëllim që manualet e përgatitura t´iu prezantoheshin nëpunësve civilë si dhe të ofrohej ekspertizë në trajtimin e rasteve specifike përmes sesioneve të trajnimit.



225 të trajnuar mbi Legjislacionin e Shërbimit Civil

291 të trajnuar mbi Kodin e Procedurave Administrative

- **Mbi përdorimin e modelit të kostos** janë zhvilluar 3 sesione trajnimi ku janë trajnuar 60 nëpunës civilë nga ministritë dhe institucionet e tjera të qeverisjes qendrore (10 ministri të linjës dhe 13 institucione) gjatë muajit Qershor 2021. Në këto takime u prezantua modeli i llogaritjes së kostos së procedurave administrative si dhe u ilustrua për pjesëmarrësit moduli i vlerësimit të kostos duke analizuar edhe shembuj konkretë të procedurave të disa ministrive.

Ecuri pozitive ka patur sa i përket **plotësimit dhe pasurimit të platformës së integruar "administrata.al" me procese të dedikuara për menaxhimin e burimeve njerëzore.** Platforma e dedikuar administratës publike, ka përmirësuar kështu ndjeshëm ndërveprimin dhe komunikimin duke shënuar një hap më tej drejt unifikimit dhe standardizimit të procedurave dhe praktikave në fushën e burimeve njerëzore.

Platforma përmban module të integruara mbi rekrutimin, përshkrimet e punës, vlerësimin e performancës, ligjin e integritetit, çështjet ligjore, nevojat për trajnim dhe vlerësimin e kostos. Në platformë administrohet një inventar i plotë i akteve dhe praktikave administrative në lidhje me Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe janë zhvilluar pothuaj 300 modele/template për procedurat si: Rekrutim, Lirim, Pezullim, Dekriminalizim, SIMBNJ, Ristrukturim, Ekzekutim i Vendimeve Gjyqësore, Masa Disiplinore, Çështje Ligjore dhe template për Trupën e Nivelit të Lartë Drejtues.



Nëpërmjet kësaj hapësire pune online, nëpunësit mund të organizojnë, kryejnë dhe raportojnë për një sërë procesesh pune të burimeve njerëzore. Për më tepër, DAP zhvilloi në datat 1 dhe 2 Korrik, 5 seanca trajnimi posaçërisht për dy platformat: Regjistri Qendror i Personelit (SIMBNJ) dhe "administrata.al". Mbi 175 pjesëmarrës nga administrata publike morën pjesë në trajnim, ku diskutuan rreth funksionalitetit të sistemit të SIMBNJ, përgjegjësive të punonjësve që punojnë me këtë sistem, platformën LMS, e-learning software për menaxhimin e kurseve online.

Tashmë duke fillur nga muaji shtator 2021 e në vijim **të gjitha institucionet e administratës publike do të përdorin të njëjtën metodologji për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave** të nevojshme në kuadër të reformës së administratës publike. DAP në bashkëpunim me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC) ka finalizuar setin e konsoliduar të indikatorëve të performancës të cilët janë hartuar dhe inkorporuar në platformë

për të mundësuar gjenerimin automatik të të dhënave. Seti i përgatitur i indikatorëve mbi bazën e të cilëve DAP do të monitorojë zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil u diskutua me Komisionerin dhe u ra dakord për një Memorandum Mirëkuptimi, duke detajuar qasjen monitoruese nga të dy institucionet. Seti i të dhënave/treguesve të performancës u prezantua në Shtator të 2021 në një takim të përbashkët me pjesëmarrjen e nëpunësve nga institucionet qëndrore.




Gjithashtu janë **finalizuar disa produkte kryesore** të cilat kanë patur **në fokus unifikimin e praktikave për një zbatim të duhur dhe rigoroz të Ligjit "për Nëpunësin Civil"** në **nivel vendor** mbi proceset kryesore në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Kështu janë finalizuar këto produkte:

- Manuali për vlerësimin e pozicioneve të punës dhe përshkrimet e përgjithshme të pozicioneve të punës të përshtatura për NJesitë e Qeverisjes Vendore.
- Manual për vlerësimin e rezultateve në punë të përshtatur për NJQV. Ky manual shërben si udhëzues për kryerjen e vlerësimit të rezultateve në punë për NJQV.
- Udhëzues mbi organizimin e brendshëm dhe strukturën në institucionet e pushtetit vendor. Ky udhëzues shërben për t'i ndihmuar NJQV të kuptojnë më mirë organizimin e brendshëm të institucioneve të qeverisjes vendore, dallimet midis strukturave organizative si dhe përmban një shtojcë[33] për procedurën e miratimit të strukturës organike të bashkisë.
- Udhëzues mbi standartizimin e procedurave të rekrutimit dhe administrimin e burimeve njerëzore në institucionet e pushtetit vendor.

Në drejtim të avancimit në shtrirjen dhe përdorimin e **Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore**, miratimi i VKM nr. 833 në Tetor 2020[34], i cili përcakton detyrimin e institucioneve, përfshirë institucionet në nivel vendor, për të hedhur dhe përditësuar të dhënat në regjistrin qendror të personelit, i hapi rrugën **automatizimit të pagave përmes sistemit SIMBNJ.**




Në Maj 2021, DAP dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë **kanë nënshkruar Udhëzimin e Përbashkët Nr. 1, datë 21.05.2021** "Për formën, elementët dhe plotësimin e listëpagesës mujore të pagave dhe të urdhër shpenzimit për pagat në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

33 Pjesë e procedurave standarte të veprimit (PSV) të bashkive (përgatitur nga projekti STAR II)

34 "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit dhe regjistrin qendror të personelit"

Për periudhën Janar - Dhjetor 2021 për sistemin SIMBNJ **janë trajnuar**: **194 nëpunës** të institucioneve pjesë e ligjit "Për Nëpunësin Civil" dhe institucioneve me "Kod Pune" (116 specialistë të njësive të Burimeve Njerëzore dhe 78 specialistë të Njësive të Menaxhimit Financiar).

**Në lidhje me iniciativat për reformën e skemës së pagave,** në vitin 2021, u përgatit dhe u finalizua dokumenti për politikën e pagave, në kuadër të Projektit IPA "Zbatimi i reformës së shërbimit civil në administratën publike".

Dokumenti i politikës mbi skemën e re të pagave ofron analiza analitike të sistemit aktual të pagave, opsionet e shkallëve të reja të pagave si dhe mënyrën se si mund të zbatohet kjo skemë.

Ky dokument është përgatitur në përputhje me parimin "pagë e njëjtë për punë të njëjtë".

Për të kuptuar më mirë zbatimin e skemës së re të pagave, janë bërë simulime për zbatimin e këtij propozimi të ri **për katër institucione**. Megjithatë, ka nevojë që simulimet të zgjerohen më tej për të kuptuar më mirë kostot e përgjithshme konkrete.

Aktualisht DAP po mban diskutime mbi dokumentin e politikës së pagave, me partnerët ndërkombëtarë SIGMA/OECD për të mundësuar mbështetjen dhe ekspertizën e tyre për zbatimin e duhur të kësaj reforme. Ky proces do të ndiqet përmes hartimit të një plani të detajuar mbi hapat dhe zbatimin e kësaj reforme.

**DAP ka vazhduar të monitorojë procesin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë** përmes administrimit të këtij procesi dhe përdorimit të modulit online (bazën e të dhënave) **në platformën "administrata.al"** për ekzekutimin e Vendimeve Gjyqësore. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2021 janë ekzekutuar **86 vendime gjyqësore** duke shënuar kështu një trend shumë pozitiv në rritje sa i takon zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë[35].

Përpjekjet e vazhdueshme të DAP për të vënë në lëvizje institucionet e administratës shtetërore kanë bërë që viti 2021 të ketë nivelin më të lartë të zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë në favor të nëpunësve civilë gjyqfitues, duke rritur në këtë mënyrë përqindjen e zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë në nivelin **79.3%**.

**Treguesit në lidhje me fushën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore:**

- Numri i stafit drejtues të larguar gjatë vitit 2021 është 47, nga totali prej 1040 i stafit drejtues dhe shënon një vlerë më të ulët nga një vit më parë 4.5 % (vlera e këtij indikatori për vitin 2020, 2019 dhe 2018 është 8%)[36]. Ulja e numrit të të larguarve tregon për një qëndrueshmëri të nëpunësve pjesë e shërbimit civil;
- Në total, 12045 pjesëmarrës nga jashtë shërbimit civil kanë marrë pjesë në procedurat e rekrutimit në 418 pozicione të shpallura në kategorinë ekzekutive, duke rezultuar në një numër mesatar pjesëmarrësish prej 28.8. (Vlera e këtij indikatori ndër vite shënon tendencë pozitive në rritje);
- Në total, 2311 pjesëmarrës nga brenda shërbimit civil kanë marrë pjesë në proceset e rekrutimit[37] për 418 aplikime, duke rezultuar në një numër mesatar pjesëmarrësish prej 5.5, një vlerë më e lartë se një vit më parë ku shënohej vlera 3.7 (vlera e indikatorit për 2019 ishte 2.5 dhe 2018 ishte 1.5). Trendi në rritje i këtij indikatori tregon se mobiliteti, një ndër risitë e legjislacionit të shërbimit civil është gjithnjë e më shumë në zbatim, duke i dhënë shërbimit civil dinamizëm dhe energji të reja;

35 33 vendime gjyqësore të ekzekutuara në 2020

36 Target: Tendencë në rënie. Indikatori është arritur

37 Target: Tendencë në rritje. Indikatori është arritur

- Sa i takon numrit të ankesave që kanë të bëjnë me rekrutimin në shërbimin civil, të pranuara nga gjykata (duke filluar nga gjysma e dytë e vitit 2014), për vitin 2021 **nuk ka pasur asnjë ankesë të pranuar nga Gjykata Administrative e Apelit në lidhje me procedurat e rekrutimit**[38].

  Numri i ulët (pothuajse 0) i ankesave të pranuara nga Gjykata Administrative e Apelit tregon për një zbatim rigoroz të legjislacionit përkatës për rekrutimin e nëpunësve civilë duke përfshirë këtu Ligjin nr.152 "për Nëpunësin Civil" dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij, për organizimin e procedurave transparente në mënyrë profesionale dhe bazuar në meritë si dhe e mbrojtjes profesionale që kanë ofruar strukturat e përfaqësimit gjyqësor pranë Departamentit të Administratës Publike.

- Shkalla në të cilën kuadri ligjor dhe organizimi i sistemit të pagave të shërbimit civil mbështesin shpërblimin e drejtë dhe transparent të nëpunësve civilë, si për parakushtet legjislative dhe organizative ashtu edhe për performancën dhe drejtësinë e sistemit në praktikë është vlerësuar 2[39], krahasuar me 3 në 2017. Raporti i SIGMA nënvizon rëndësinë në avancimin drejt reformës së pagave duke evidentuar se tashmë është përgatitur dokumenti i politikës së pagave.

Në lidhje me procedurat administrative dhe mbikëqyrjen në institucionet e pushtetit qendror, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka nxjerrë udhëzime dhe rekomandime në lidhje me unifikimin e zbatimit të ligjit në shërbimin civil bazuar në problematikat e evidentuara në administratën publike.

Në këto udhëzime përfshihen:

- Udhëzim në drejtim të **respektimit të të drejtave politike të nëpunësve civilë** gjatë procesit zgjedhor;
- Udhëzim për evitimin e pengesave të krijuara nga institucionet për pjesëmarrjen e kategorisë së nëpunësit civil në administratën zgjedhore të emëruar nga KQZ;
- Udhëzim në drejtim të vlerësimit të veprimtarisë së nëpunësit civil në rrjetet sociale;
- Udhëzim në lidhje me riklasifikimin e pozicioneve të punës për të gjithë sistemin e shërbimit civil në njësitë e qeverisjes vendore (bashki).

**Komisioneri ka kryer:**

- procesin e mbikëqyrjes së përgjithshme në **11** institucione pjesë e shërbimit civil (4 institucione të pavarura, **4** njësi të qeverisjes vendore (bashki) dhe 3 institucione varësie të administratës shtetërore);
- procesin e verifikimit të zbatimit të vendimeve paralajmëruese për **28** subjekte për të cilat ka përfunduar afati për zbatimin e tyre. Në të gjitha rastet, procesi i mbikëqyrjes është përmbyllur me konstatimin se këto institucione i kanë zbatuar plotësisht rekomandimet apo detyrat e lëna;
- 18 inspektime tematike (rastet individuale) ku është konstatuar se detyrat e lëna nga Komisioneri janë zbatuar plotësisht nga ana e institucioneve;
- trajtuar 110 kërkesa/ankesa nga nëpunës civilë, nga të cilat:
  1. janë nxjerrë 58 vendime paralajmërimi në rastet kur janë konstatuar shkelje apo arkivimi pasi gjatë hetimit nuk janë konstatuar parregullsi;
  2. në 12 raste, procesi i hetimit administrativ është mbyllur duke i kthyer përgjigje kërkuesit/ankuesit (nga të cilat 1 rast i përket kërkesave/ankesave të depozituara gjatë vitit 2020);

38 Target: Tendencë në rënie. Indikatori është arritur.

39 http://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Albania.pdf (faqe 86)

3. 1 rast është bashkuar me procesin e mbikëqyrjes;

4. për 39 raste është duke vijuar procesi i hetimit administrativ.

**Aktiviteti i Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA)** gjatë vitit 2021 ka patur synim kryesor ngritjen e kapaciteteve dhe përgatitjen e administratës publike shqiptare në drejtim të integrimit evropian dhe zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil.

Raporti i SIGMA nxjerr në pah se vlerësimi i performancës, promovimi, trajnimi dhe mobiliteti janë në funksion dhe ASPA ka menaxhuar të zhvillojë trajnimet pavarësisht tërmetit në 2019 dhe kufizimeve nga pandemia në 2020. Raporti nënvizon se politikat në fushën e trajnimit të nëpunësve civilë duhet të bazohen në qëllime strategjike dhe duhet të monitorohen nga afër dhe rregullisht bazuar në një set të plotë të indikatorëve[40].

ASPA ka vijuar me ofrimin e trajnimeve online. Përveç ofrimit të trajnimeve online nëpërmjet programit të webinare-ve dhe të kurseve online me certifikim, gjatë vitit 2021 është konsoliduar platforma online dhe janë mundësuar mjete didaktike online të ndryshme duke siguruar interaktivitet dhe duke rritur cilësinë e shërbimit të ofruar.

## Treguesit e ASPA për vitin 2021[41]:

| Indikatori | Vlera 2021 |
|---|---|
| Nëpunës civilë pjesëmarrës në trajnime | 6728 |
| Kurse trajnimi | 457 |
| Nëpunës civilë për ditë trajnimi | 36825 |




ASPA ka qenë gjithashtu një nga institucionet përfituese gjatë zbatimit të projektit IPA "Zbatimi i reformës së shërbimit civil në administratën publike".

Përfitimet në këtë drejtim janë të shumta ku disa prej rezultateve të arritura janë:

- Forcimi i kapaciteteve të stafit të ASPA në menaxhimin dhe ofrimin e trajnimeve me cilësi;
- Mbështetje për zbatimin e Planit të Zhvillimit të Kapaciteteve të Stafit;
- Mbështetje në ofrimin e kurrikulave të trajnimit për programin e Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues (TND);
- Zhvillimi i një modeli për akreditimin e kurrikulave ose programeve të trajnimit dhe menaxhimin cilësor të kurrikulave të trajnimit;

40 https://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Albania.pdf (faqe 90).

41 Indikatori 6 d "Shkalla në të cilën sistemi i trajnimit të nëpunësve civilë është funksional dhe zbatohet në praktikë (Indikatori i SIGMA-s)", Vlera më e fundit e indikatorit 6d të mëposhtëm ka shënuar rritje dhe është vlerësuar me 4 pikë, krahasimisht me nivelin 3 nga vlerësimi i vitit 2017 i SIGMA.

- Zhvillimi i një metodologjie dhe mbështetja e përgatitjes së e-kurrikulave;
- Mbështetja në ngritjen e e-bibliotekës dhe zhvillimi i qendrës së menaxhimit të burimeve për të siguruar që shërbimet e saj pasqyrojnë nevojat e grupeve të përdoruesve;
- Hartimi i strategjisë për transformimin e ASPA-s në një Qendër Ekselence për trajnimin dhe zhvillimin e administratës publike në Shqipëri.

| Trajnime të zhvilluara sipas tematikave/kategorive | Pjesëmarrës të trajnuar sipas tematikave/kategorive | |
|---|---|---|
| | 2020 | 2021 |
| Të trajnuar nga pushteti qendror | 11491 | 21121 |
| Të trajnuar nga pushteti vendor | 6130 | 9811 |
| Të trajnuar nga institucionet e pavarura | 2077 | 5686 |
| Trajnime në fushën e integrimit evropian | 1534 | 3597 |
| Kategori të tjera | 408 | 207 |

## Sfidat dhe rekomandimet:

- Zbatimi i mbështetur në meritë i Legjislacionit për Shërbimin Civil përmes përmirësimit të mëtejshëm të procesit të përzgjedhjes dhe vlerësimit të kandidatëve për t'u bërë pjesë e administratës shtetërore;
- Përmirësimi i ligjit për nëpunësin civil (ligji nr. 152/2013 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij); **zhvillimi i takimeve dhe diskutime mbi problematikat e hasura për zgjidhje të mundshme ligjore (ndryshimet ligjore të cilat janë parashikuar të miratohen gjatë 2022)**;
- Përdorimi dhe raportimi i vazhdueshëm nga institucionet në Regjistrin Qendror të Personelit (SIMBNJ) dhe platforma e bashkëpunimit "administrata.al" sipas përcaktimeve të aktit nënligjor që rregullon përdorimin e tyre; ngritja e kapaciteteve të nëpunësve në përdorimin e sistemeve që përmirësojnë, standardizojnë dhe unifikojnë proceset kyçe të menaxhimit të burimeve njerëzore; përfshirja e 50% të institucioneve të administratës shtetërore në Regjistrin Qendror të Personelit (SIMBNJ) dhe gjenerimi i pagave të nëpunësve publikë nëpërmjet këtij sistemi;
- Miratimi i dokumentit të politikës së pagave dhe zbatimi i reformës së pagave; **zhvillimi i diskutimeve mbi dokumentin e politikës së pagave me partnerët ndërkombëtarë SIGMA/OECD për të mundësuar mbështetjen dhe ekspertizën e tyre për zbatimin e duhur të kësaj reforme dhe hartimi dhe zbatimi i planit të punës për fazat konkrete dhe hapat drejt finalizimit dhe miratimit të dokumentit të politikës së pagave**;
- Konsolidimi i programit të trajnimit të Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues; **ASPA duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për të reflektuar mbi propozimet/rekomandimet në këtë program, në vijim të fazës pilot dhe të vazhdojë konsolidimin e ti;**
- Vijimi i ngritjes së kapaciteteve institucionale në fushën e integrimit evropian; **planifikimi i sesioneve të trajnimit në fushën e integrimit europian nga ASPA dhe për vitin 2022.**

Shtylla IV

# PROCEDURAT ADMINISTRATIVE DHE MBIKËQYRJA

Politikat nën këtë shtyllë synojnë rishikimin e procedurave për ofrimin e shërbimeve ndaj publikut dhe thjeshtimin e tyre duke përfshirë zgjidhje të Teknologjisë së Informacionit si dhe duke marrë në konsideratë zbatimin e Kodit të ri të Procedurave Administrative, në drejtim të rritjes së përgjegjshmërisë së nëpunësve publikë në kryerjen e funksioneve të tyre.

Objektivat e planifikuara në kuadër të Shtyllës IV synojnë:

Procedura të thjeshtuara për ofrimin e shërbimeve, duke lehtësuar komunikimin me publikun dhe shmangur korrupsionin

Zhvillimin e një infrastrukture TIK të aftë për të mbështetur veprimtaritë e përditshme të administratës publike dhe rritjen e efiçencës duke ulur kohën për të aksesuar, përpunuar dhe transmetuar informacionin ndërsa përmirësohet rrjedha e informacionit;

Rritjen e efiçencës dhe përgjegjshmërisë së nëpunësve publikë;

Rritjen e kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike për garantimin e të drejtave të qytetarëve dhe aksesi në informacion

Shtylla IV "Procedurat Administrative dhe Mbikëqyrja" parashikon realizimin e 30 nën-aktiviteteve, nga të cilat kanë filluar të zbatohen 29 nën-aktivitete (ose 96.6%), e prej këtyre të fundit janë realizuar plotësisht 18 ose 62%.

Grafiku 12 Statusi i realizimit të qëllimit politik: "Procedurat Administrative dhe Mbikëqyrja"




Grafiku 13 Statusi i realizimit të produkteve sipas objektivave




## Lista e të gjithë indikatorëve me vlerën bazë, vlerën e matur dhe vlerën e synuar në 2021

| Indikatorët | Vlera Bazë | Vlera e matur në 2021 | Vlera e synuar | Trendi (tendencë në ulje/tendencë në rritje/ arritur) |
|---|---|---|---|---|
| 8b. Niveli (%) i kënaqshmërisë publike kundrejt cilësisë së ofrimit të shërbimeve ka shënuar tendencë në rritje. | 51% 2016 (fq 39) | Tendencë në rritje | Tendencë në rritje | Arritur |
| 8c. Shkalla në të cilën politikat për ofrimin e shërbimeve të fokusuara tek qytetari janë miratuar dhe zbatuar në praktikë (indikatori i SIGMA-s) | 2 | 4 | Tendencë në rritje | Arritur, shënon tendencë në rritje nga vlera bazë 2 |
| 9a. Sisteme të përmirësuara të IT-së për ofrimin e shërbimeve | 0 | 8 sisteme të përmirësuara | 8 agjenci | Arritur |
| 9b. Shkalla në të cilën janë të zbatueshme parakushtet politike dhe administrative për ofrimin e shërbimeve elektronike (Indikatori i SIGMA-s) | 4 | 4 | Tendencë në rritje | Vlerë e njejtë |
| 10a. Shkalla në të cilën kuadri ligjor për administrimin e mirë është miratuar dhe zbatuar në praktikë (Indikatori i SIGMA-s.) | 2/per 2014 | 4 | Tendencë në rritje | Arritur tendencë në rritje nga 2 në 4 |
| 11a. Numri i ankesave të paraqitura çdo vit pranë Komisionerit përgjegjës për lirinë e informimit | 58 | 992 | Tendencë në rënie | Tendencë në rritje |
| 11b Përqindja e rekomandimeve të zbatuara nga institucionet mbikëqyrëse të institucioneve të pushtetit qendror në dy vitet e kaluara. | RNoA=20% | R NoA = 22% Tendencë në rritje/nuk është arritur R Acc = 38 % Tendencë në rënie/nuk është arritur R RfC = 6.7% Tendencë në ulje/arritur | R NoA = 17% Tendencë në rënie | R NoA - tendencë në rënie |
| | RAcc=6% | | R Acc = 48 % Tendencë në rritje | R Acc - tendencë në rritje |
| | RRFC=43% | | R RfC = 9.6% Tendencë në ulje | R RfC është arritur |

Prej vitesh Shqipëria ka filluar procesin e transformimit dhe digjitalizimit të shërbimeve publike dhe beson në ndryshimin e perceptimit të qytetarëve në lidhje me këtë formë të re të pashmangshme të komunikimit me institucionet shtetërore. Përsa i përket ndikimit, kjo reformë përkthehet në një ulje të kostove të marrjes së shërbimeve, lehtësim të procedurave burokratike, shkurtim të kohës për të marrë shërbimet por edhe përmirësim të transparencës dhe të cilësisë së ofrimit të shërbimeve.

**Revolucioni digjital i shërbimeve publike** në Shqipëri ka ndryshuar prej kohësh perceptimin e qytetarëve, në lidhje me komunikimin elektronik me institucionet shtetërore, duke bërë që sot të ofrohen 1,209 shërbime online ose rreth 95% të të gjitha shërbimeve publike.




Qeveria shqiptare, si promovuese e shndërrimit të shërbimeve offline në shërbime online, e shndërroi platformën e-Albania, e cila në vitin 2013 kishte vetëm 14 shërbime elektronike, në një histori suksesi dhe arriti të ndërtojë një imazh serioz të shtetit dhe të rivendosë besimin e qytetarëve në institucionet publike.

Gjatë vitit 2021 është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 458, datë 30.7.2021 "Për miratimin e rregullores së liçensimit për subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre si Ofrues të Shërbimeve Inovative, mënyrën e vlerësimit të kritereve të veçanta për Sipërmarrjet e Automatizuara të Investimeve Kolektive si dhe Certifikimin e Marrëveshjes së Teknologjisë Inovative". Qëllimi i këtij vendimi është përmbushja e detyrimeve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 66/2020, "Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë", duke përcaktuar:

- Rregullat dhe procedurat për aplikimet e subjekteve për liçensim si ofrues të shërbimeve inovative, si dhe llojet e programeve të trajnimit të detyrueshëm, periodicitetin e trajnimit dhe mënyrën e vlerësimit të aftësive të përfituara gjatë trajnimit për këto subjekte;
- Rregullat mbi hartimin dhe përmbajtjen e raportit të marrëveshjes së teknologjisë inovative, kërkesës për çertifikimin dhe refuzimin e marrëveshjes së teknologjisë inovative, si dhe rregullat për mënyrën e vlerësimit të kritereve të veçanta për sipërmarrjet e automatizuara të investimeve kolektive.

**Krahasimi 2013 me 2021:**

Në 2013 ka pasur 1% shërbime online, ndërkohë që në 2021 **95% e shërbimeve publike janë online**;

Në 2013 kanë qenë 50 mijë të regjistruar në portal, ndërkohë që në 2021 janë mbi **2.3 milionë të regjistruar**;

Në 2013 ka pasur 6 regjistra elektronikë që ndërvepronin në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit, ndërkohë që në 2021 kemi 55 regjistra elektronike që ndërveprojnë në kohë reale;

Në 2013 numëroheshin 680 mijë transaksione në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit, ndërsa gjatë vitit 2021 ka pasur mbi **215 milionë transaksione**.

Gjatë vitit 2021 janë shtuar në portal 188 shërbime të reja duke e rritur totalin e tyre me **86 herë krahasuar me vitin 2013**.

**Shërbimet elektronike të cilat ofrohen online janë:**

- **Nënshkrimi elektronik:** digjitalizimi i proceseve: lejet e ndërtimit, prokurimet elektronike, tashmë edhe sistemi i të dhënave të automatizuara për doganat, etj;

- **Biznesi:** kryen të gjithë ciklin që i duhet në raport me shtetin, ku ulja e kostove për të, nuk është vetëm në marrëdhënie me shtetin por edhe në marrëdhënien biznes-biznes duke shkëmbyer dokumente të nënshkruara elektronikisht me vlerë të plotë ligjore në distancë;

- **Vula elektronike:** duke eliminuar tërësisht printimin e 55 dokumenteve;

- **Certifikatat e gjendjes civile:** digjitalizimi në vazhdim i arkivave të gjendjes civile do të sjellë lëshimin online të këtyre certifikatave dhe për periudhën 1974-2010;

- **Drejtësia:** dëshmia e penalitetit tashmë ofrohet online, pa kosto dhe maksimalisht brenda 5 ditësh i interesuari pajiset me dëshminë me vulë elektronike; Implementimi i regjistrit të ekspertëve për sistemin gjyqësor dhe çdo gjykatë mund të kryejë përzgjedhjen online;

- Përmirësimi i platformës së qendrës së botimeve zyrtare (qbz.gov.al) duke mundësuar kërkim të lehtë dhe me historik të ndryshimeve të një akti ligjor;

- **Digjitalizimi i regjistrave themeltare** të periudhës së dënimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve: nëpërmjet e-Albania mund të merren vërtetimet përkatëse me nënshkrim elektronik të periudhës së dënimit;

- **Arsimi:** aplikimi për fondin e ekselencës; regjistrimi në shkollat profesionale; marrja e vërtetimit dhe njësimin e diplomave, etj. Provimet e shtetit tashmë administrohen në e-Albania, ku kandidatët njihen me rezultatin e provimit po online dhe mund të printojnë vërtetimin e rezultateve të tyre me vulë elektronike. Pritshmëria është që së shpejti edhe dëftesat e nxënësve do të printohen me vule elektronike duke mundësuar digjitalizimin e të gjithë sistemit arsimor parauniversitar, i cili ka filluar të përdoret për këtë viti shkollor;

- **Rendi Publik:** sistemi i gjobave elektronike;

- **Transporti:** përmirësimi i sistemeve të lejeve të drejtimit dhe targave. Po punohet edhe me digjitalizimin e transportit ndërqytetas, duke i siguruar qytetarëve informacion për vendndodhjen e stacioneve, orarin e nisjes dhe mbërritjes, si dhe për të pasur mundësi të presin biletat online përmes telefonit;

- **Punësimi:** me përmirësimin e sistemit të punësimit, punëdhënësi kryen të gjithë ciklin e punës që nga shpallja e vendeve të lira të punës, marrja e informacionit për kandidatët e përshtatshëm për këto vende pune, deri në mbylljen e procesit të punësimit;

- **Shqiptarët jashtë vendit:** marrja e shërbimeve konsullore nga emigrantët shqiptarë jashtë vendit ku në total janë 38 shërbime online të dedikuara dhe janë regjistruar mbi 1.3 milionë aplikime lidhur me këto shërbime deri më tani;

- **e-Visa:** shtetasit e huaj mund të aplikojnë online duke kryer edhe pagesën e aplikimit;

- **Bujqësia:** skema kombëtare në mbështetje për fermerët. Falë digjitalizimit, fermerët, përfitojnë subvencione pa asnjë dokument shoqërues;

- **Shëndetësia:** përmirësimet e sistemeve të ndihmës ekonomike dhe asistencës sociale sollën përfitime për mbi 22 mijë aplikantë të këtyre kategorive të cilët morën vërtetimet përkatëse pa mbajtur radhën. Gjithashtu, është ofruar Certifikata e Vaksinimit, duke sjellë kështu një tjetër arritje në fushën e digjitalizimit. Në portalin e-Albania, qytetarët mund të pajisen elektronikisht me pasaportën e vaksinës kundër COVID-19, pas kryerjes së dozave të vaksinës;

- **Prona:** 74 shërbime të Kadastrës Shqiptare merren lehtësisht në e-Albania, ndërkohë, certifikatat e pronësisë, vërtetimet, kartelat e pasurisë jepen me vulë elektronike falë digjitalizimit të 1.7 milionë pronave të shqiptarëve.

Gjatë vitit 2021 janë përmirësuar 8 sisteme për ofrimin e shërbimeve. Vlera e synuar për këtë indikator për vitin 2021 është 8. Kështu indikatori është arritur.

**Monitorimi i cilësisë së shërbimit të ofruar për qytetarët në Qëndrat e Integruara ADISA**[42] ka vijuar përmes kryerjes së sondazheve të drejtpërdrejta dhe matjen e kohës së pritjes dhe kohës së marjes të shërbimit. Më poshtë paraqitja grafike e nivelit të kënaqësisë qytetare në sportelet pritëse ADISA sipas sondazheve të drejtpërdrejta:

Niveli i kënaqshmërisë mbi cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët në qëndrat e integruara ADISA




42 Indikatori 8b: Niveli (%) i kënaqshmërisë publike kundrejt cilësisë së ofrimit të shërbimeve ka shënuar tendencë në rritje.

Raportet mbi monitorimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara dokumentojnë vlerësimin e publikut për ofrimet e shërbimeve në nivele të larta. Përqindja e kënaqshmërisë së qytetarit është rritur në mënyrë progresive nga viti 2016 deri në vitin 2021. Arritjet kundrejt nivelit të synuar për vitin 2021 janë realizuar falë masave të marra në përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimit dhe reduktimin e kohës së pritjes në sportele.

Arritjet kryesore të vlerësimit mbi ofrimin e shërbimeve publike, ku ADISA ka rolin kryesor në mbledhjen e informacionit, në bashkërendim me institucionet përgjegjëse, janë:

- Shqipëria ka shënuar tendenca pozitive në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike, me një vlerësim mesatar prej 3.8 në 2021 krahasuar me 3.3 në 2017. Së bashku me Serbinë është një nga vendet lider në rajon (me mesataren rajonale 3.1) në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve, me fokus të veçantë në shërbimet dixhitale[43].
- Monitorimi i ofrimit të shërbimeve po funksionon mirë dhe rezulton i dobishëm për t'u informuar lidhur me nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të institucioneve publike.

Përmirësimi i aksesit në shërbimet publike ka qenë një objektiv kryesor i politikës së Qeverisë në vitet e fundit. Kjo është arritur përmes rrjetit të 22 Qendrave të Integruara të ADISA-s. Rritja e kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike, garantimi i të drejtave të qytetarëve dhe aksesi në informacion është gjithashtu një objektiv i rëndësishëm nën këtë shtyllë. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka vijuar punën lidhur me monitorimin e zbatimit të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

**Zyra e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale** edhe gjatë vitit 2021 hartoi dy instrumente për matjen e transparencës proaktive.

- **Indeksi i Transparencës Proaktive të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore,** u zhvillua gjatë muajve Shtator-Dhjetor 2021;
- **Indeksi i Transparencës Proaktive i Institucioneve Qëndrore dhe të Varësisë,** u zhvillua gjatë muajve Shtator - Dhjetor 2021.

Në këtë monitorim u përzgjodhën 100 autoritete publike, duke përfshirë të gjithë ministritë, disa institucione në varësi të tyre, institucione të pavarura, gjykata, prokurori, universitete, shoqëri anonime ku shteti zotëron pjesën më të madhe të kapitalit si dhe disa autoritete të tjera publike.







Zyra e Komisionerit ka kërkuar bashkëpunimin e AKSHI-t për ofrimin e shërbimeve të "Kërkesës për informacion publik" dhe "Ankesës për mosdhënie informacioni", shërbime që do të ofrohen nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania.

43 https://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2021-Albania.pdf (faqe 117-116)

Ky bashkëpunim u finalizua me publikimin në portalin e-Albania të shërbimeve "Kërkesë për informacion publik" dhe "Ankesa për refuzim dhënie informacioni publik" dhe aktualisht, këto shërbime janë funksionale për 61 Autoritete Publike, ndërkohë që është në proces për t'u zgjeruar me autoritetet e tjera.

Shërbimet kërkesë për informacion publik" dhe "Ankesa për refuzim dhënie informacioni publik" tashmë të digjitalizuara dhe ofruar përmes portalit e-Albania.

Në lidhje me ndryshimet e ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" gjatë muajit Nëntor 2021, është përcjellë projektligji "Për ndryshimin e ligjit për të drejtën e informimit", së bashku me relacionin shoqërues dhe Raportin e Vlerësimit të Ndikimit (RIA) pranë Ministrisë së Drejtësisë për të vijuar me procedurat e mëtejshme ligjore deri në miratimin e tij.

**Zhvillim pozitiv është evidentuar në lidhje me masat e marra për vënien në funksion të plotë të regjistrit qendror të kërkesave dhe përgjigjeve.**

Zyra e Komisionerit gjatë vitit 2021 ka monitoruar online të gjitha autoritetet publike në lidhje me publikimin e programit të transparencës, kontakteve të koordinatorit dhe regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve.

Nga monitorimi i fundit online i 374 autoriteteve publike rezultoi se:

- 300 autoritete kanë publikuar në faqet e tyre zyrtare programin e transparencës;
- 286 kanë publikuar kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- 217 kanë publikuar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Gjatë kësaj periudhe, Zyra e Komisionerit ka miratuar 36 rekomandime për ato autoritete publike të cilat pas monitorimit online[44], kanë rezultuar se kanë pasur mangësi në publikimin e informacionit të detyrueshëm[45].

Për vitin 2021, numri i ankesave, ka pasur tendencë në rritje 992. Shkaqet e tendencës në rritje të indikatorit të parë mund të vijnë nga besimi i rritur i qytetarëve ndaj rezultateve të punës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe situatës së krijuar që prej përhapjes së pandemisë Covid-19, duke paraqitur më shumë ankesa se në vitin e kaluar.




44 Në zbatim të Urdhrit nr. 187, datë 18.12.2020 «Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar», të ndryshuar dhe Urdhrit nr. 211 datë 10.09.2018 "Programi model i Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore".

45 Ndaj këtyre të fundit janë zhvilluar 25 hetime administrative për zbatimin e programit të transparencës, në përfundim të së cilave, Zyra e Komisionerit ka dhënë 5 vendime administrative me sanksion gjobë.

Në lidhje me veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit, gjatë 2021 janë adresuar në total 267 rekomandime drejtuar organeve të Administratës Publike duke përfshirë atë qendrore dhe vendore.

Siç rezulton nga të dhënat e mësipërme, numri i rekomandimeve të regjistruara për vitin 2021 është 267. Në këtë raportim nuk është përfshirë zëri "në proces" pasi për të gjithë rekomandimet e adresuara deri në datën 31.12.2021 kanë kaluar afatet proceduriale për kthimin e një përgjigjeje nga institucionet. Megjithatë, pavarësisht kalimit të këtyre afateve, siç do të shohim më poshtë, për një pjesë të madhe të rekomandimeve të adresuara në muajin Dhjetor 2021, ende nuk ka një përgjigje.

Në total nga 267 rekomandime të adresuara, numri total i rekomandimeve të pranuara plotësisht është 121 (ose 46%) ndërsa numri i rekomandimeve të pranuara pjesërisht është 64 (ose 24%). Numri total i rekomandimeve të zbatuara plotësisht është 46 ndërsa numri total i rekomandimeve të zbatuara pjesërisht është 89[46].

Grafiku 14 Statusi i zbatimit të rekomandimeve




## Sfidat dhe rekomandimet:

- Ofrimi i shërbimeve elektronike të përmirësuara përmes platformës e-Albania; **në këtë drejtim, AKSHI duhet të sigurojë infrastrukturën e nevojshme teknologjike për zhvendosjen e të gjitha shërbimeve online;**

- Shtimi i më shumë institucioneve të përfshira në Regjistrin Elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve; **monitorimi periodik i autoriteteve publike dhe monitorimi nëpërmjet instrumenteve të rinj të krijuara për matjen e Indeksit të Transparencës Proaktive në nivel lokal dhe qendror.**

46 Pra, referuar indikatorit 11b: raportit të rekomandimeve të zbatuara plotësisht me rekomandimet e pranuara, ai është në nivelin 38 % (RACC). Ndërkohë, lidhur me rekomandimet pa përgjigje rezulton se për vitin 2021 janë 57 rekomandime ose 2 %2 (RNOA) pa përgjigje. Pra, referuar raportit midis rekomandimeve pa përgjigje dhe rekomandimeve të adresuara në total nga Avokati i Popullit, rezulton se 6.7 % (RRFC) e tyre nuk kanë përgjigje.

# Vlerësimi i arritjeve kryesore duke përdorur indikatorët

Pasaporta e indikatorëve është dokumenti bazë i cili është hartuar me mbështetje të SIGMA dhe në bashkëpunim të plotë me institucionet përgjegjëse dhe shërben për matjen e treguesve të nivelit të rezultatit të SNRAP, monitorimi i të cilit bazohet në përshkrimin metodologjik të matjes të të gjithë treguesve.

**16**

**TARGET I ARRITUR**

**12***

*6 indikatorë shënojnë vlera në rritje nga viti 2020, 5 shënojnë vlerë konstante me 2020/ose nga baseline,1 prej tyre shënon trend zbritës*

Nga totali i 28 indikatorëve, pjesë e pasaportës së treguesve në nivel rezultati, 16 indikatorë janë arritur plotësisht. Indikatorët e arritur janë:

1. 70% e stafit të politikëbërjes të ML-së i trajnuar, të paktën, një herë për çështjet e planifikimit strategjik. Gjatë 2020 janë trajnuar të paktën 86 % e stafit të politikëbërjes. Trajnimet kanë vijuar dhe gjatë 2021 janë trajnuar 52% e stafit që merret me politikëbërjen;
2. Cilësia e analizës së vlerësimit të ndikimit dhe vlerësimi i zbatimit për aktet ligjore të rëndësishme të hartuara dhe të publikuara ka vijuar të shënojë tendencë në rritje ku 74% e akteve ligjore përmbushin kriteret e cilësisë së RIA;
3. Numri i akteve ligjore të ndryshuara brenda vitit të parë të miratimit ka vijuar të shënojë tendencë në ulje;
4. Përqindja e raporteve të monitorimit dhe vlerësimit për strategji të rëndësishme të hartuara dhe të publikuara në baza vjetore ka shënuar tendencë në rritje nga baseline;
5. Numri i konsultimeve publike/prezantimeve të organizuara për të diskutuar raportet e monitorimit dhe vlerësimit ka shënuar tendencë në rritje (nga baseline 16);
6. Numri i shërbimeve të qeverisë qendrore me ndërveprim të përmirësuar në zyrat e pritjes (arritur në 2020);
7. Numri i zyrave me një ndalesë të ngritura në njësitë e qeverisjes vendore. Në të gjitha bashkitë janë në funksion sistemet e operimit të zyrave me një ndalesë (OSSIS);
8. Qarkullimi vjetor (lëvizja paralele) e stafit të nivelit drejtues në të gjitha nivelet e shërbimit civil në institucionet e administratës qendrore ka shënuar tendencë në rënie;
9. Numri mesatar i pjesëmarrësve në një procedurë rekrutimi nga jashtë dhe nga brenda (transferimi) në shërbimin civil ka shënuar tendencë në rritje;
10. Numri i ankesave që kanë të bëjnë me rekrutimin në shërbimin civil të pranuara nga gjykata (duke filluar nga gjysma e dytë e vitit 2014) ka shënuar rënie;

11. Shkalla në të cilën sistemi i trajnimit të nëpunësve civilë është funksional dhe zbatohet në praktikë (Indikatori i SIGMA-s) ka shënuar rritje;

12. Numri i shërbimeve me procedura të thjeshtuara për ofrimin e tyre (arritur në 2020);

13. Niveli (%) i kënaqshmërisë publike kundrejt cilësisë së ofrimit të shërbimeve ka shënuar rritje;

14. Shkalla në të cilën politikat për ofrimin e shërbimeve të fokusuara tek qytetari janë miratuar dhe zbatuar në praktikë (Indikatori i SIGMA-s), shënon tendencë në rritje nga vlera bazë 2;

15. 8 sisteme të përmirësuara të IT-së për ofrimin e shërbimeve;

16. Shkalla në të cilën kuadri ligjor për administrimin e mirë është miratuar dhe zbatuar në praktikë (Indikatori i SIGMA-s) arritur tendencë në rritje nga 2 në 4.

SIGMA asiston në matjen e 7 prej indikatorëve pjesë e pasaportës së indikatorëve. Gjatë vitit 2021 siç edhe është referuar gjatë raportimit, është publikuar vlerësimi i fundit i SIGMA dhe të dhënat e referuara në këtë raport janë evidentuar në çdo indikator specifik.

*

Nga ana tjetër, gjatë procesit të monitorimit janë evidentuar 12 indikatorë të cilët nuk janë arritur plotësisht: nga këto 6 indikatorë **shënojnë vlera në rritje nga viti 2020** por duhen akoma përpjekje për të arritur targetin e synuar, **5 shënojnë vlerë konstante me 2020/ose nga** *baseline,* 1 prej tyre shënon trend zbritës.

Disa nga problematikat kryesore të cilat lidhen me mosarritjen e indikatorëve janë evidentuar më në detaje gjatë analizës së kryer për secilin indikator.

## Komunikimi i aktiviteteve

Një element shumë i rëndësishëm i cili ndikon në progresin e mëtejshëm të strategjisë është gjithashtu komunikimi dhe ndërgjegjësimi i publikut mbi masat që ndërmerren si dhe rezultatet e arritura për të qenë sa më të prekshme dhe transparente për të gjithë.

Kështu duke publikuar progresin e reformave të ndërmarra synohet për të patur një impakt më të konsoliduar ku DAP bashkërendon me institucionet gjithnjë e më shumë për organizimin e eventeve të ndryshme me qëllim prezantimin e arritjeve në fushën e Reformës në Administratën Publike.

Publikimi i aktiviteteve kryesore të Departamentit të Administratës Publike në formën e postimeve në rrjetet sociale të institucionit (facebook dhe twitter), në faqen zyrtare të DAP, **www.dap.gov.al**, si dhe në buletinin mujor të Departamentit është ndër elementet kryesorë të komunikimit me qytetarin.

Ndërgjegjësimi i publikut/qytetarit nëpërmjet këtyre aktiviteteve informuese dhe përshkruese e bën Departamentin e Administratës Publike të jetë një institucion i hapur me një qasje të re më të strukturuar në rritjen e transparencës së institucionit ndaj publikut, duke e njohur me punën, arritjet por dhe me sfidat e reformës së administratës publike.

**Aktivitetet kryesore në drejtim të promovimit të rezultateve dhe impaktin e reformës gjatë vitit 2021 kanë qenë:**

Për të rritur më shumë vizibilitetin dhe përdorimin e platformës "administrata.al" nga të gjithë nëpunësit civilë në nivel qendror dhe vendor, janë krijuar dhe shpërndarë në rrjetet sociale dhe kanalin youtube të Departamentit të Administratës Publike, video përshkruese mbi përmbajtjen dhe funksionimin e platformës "administrata al", moduleve të platformës dhe Sistemin Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Videot përshkruese janë krijuar me qëllimin për të rritur përdorimin periodik të platformës nga ana e nëpunësve civilë të institucioneve, përfshirë Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe të udhëzojnë përdoruesit mbi mënyrën e përdorimit të platformës "administrata.al"; Sistemin Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ); "Vlerësimi i Performancës"; Seti i indikatorëve dhe rubrikës Raporte.




Disa nga përfitimet kryesore të kësaj fushate sensibilizuese të mbështetur nga ReSPA për rritjen e përdorimit dhe ndërgjegjësimit mbi rëndësinë dhe përfitimet e Sistemeve të Informacionit të BNJ në Administratën Publike Shqiptare, me fokus të veçantë në nivel lokal janë:

- Shpjegimi i të gjitha përfitimeve dhe përdorimi i platformave në mënyrë vizuale dhe miqësore për punonjësit e administratës publike me fokus të veçantë në Njesitë e Qeverisjes Vendore;
- Përmirësimi i komunikimit me përdoruesit aktualë dhe të rinj, rritja e publicitetit të platformës;
- Rritja e ndërgjegjësimit të përdoruesve potencialë për procedurën e platformës online;
- Përmirësimi i cilësisë së punës në administratën publike;
- Sigurimi i një qasjeje të kuptueshme/*user-friendly* në drejtim të shpjegimit të mënyrës se si funksionon platforma "administrata.al".

Përfaqësuesit e projektit WeBER2 prezantuan rezultatet e hulumtimit krahasues për monitorimin e Reformës së Administratës Publike në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, ku veçuan Shqipërinë për rezultatet më të larta në rajon sa i takon Shërbimit Publik dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore nëpërmjet një konferencë dyditore të zhvilluar online në datat 25 – 26 shkurt 2021.






**Në datën 7 Tetor 2021, në një konferencë përmbyllëse** si dhe në një diskutim të nivelit të lartë me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve kyçe të përfshira, u përmbyll me sukses projekti i financuar nga BE me fondet IPA 2014 **"Zbatimi i Reformës së Shërbimit Civil në Administratën Publike".** Projekti mbështeti për 3 vjet qeverinë shqiptare në mirëmenaxhimin e burimeve njerëzore dhe fuqizimin e institucioneve publike, mbështetur në këto komponentë kryesorë: reformën në strukturën e pagave, përcaktimin e kritereve të performancës së punonjësve dhe institucioneve, krijimin e një sistemi të unifikuar të burimeve njerëzore për administratën publike qendrore dhe lokale, përforcimin e rolit monitorues të DAP, hartimin e përmirësimin e kurrikulave të trajnimit të ASPA etj.





Në praninë e përfaqësuesve të nivelit të lartë të qeverisë shqiptare, të Komisionit Evropian, SIGMA, zyrës së delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, në 10 dhjetor u prezantua raporti i vlerësimit të indikatorëve sipas fushave të reformës së administratës publike. Në raportin e SIGMA vlerësohet ndër të tjera stabiliteti dhe përforcimi i sistemit të shërbimit civil, forcimi i kapaciteteve dhe rritjes profesionale të nëpunësve publikë në përballimin me sukses të sfidave të integrimit drejt Bashkimit Evropian pavarësisht sfidave që solli pandemia.







ReSPA gjatë vitit 2021 ka zhvilluar disa evente në fushën e koordinimit të politikave.

ReSPA organizoi në muajin Korrik 2021 në Vlorë, seminarin mbi proceset e koordinimit të politikave.

Ky takim u mbajt në vijim të dokumentit analitik "Koordinimi i politikave në Ballkanin Perëndimor" dokument i cili merr në shqyrtim proceset dhe sistemet e koordinimit të politikave në Shqipëri.

Gjetjet nga analiza e hartuar kontribuojnë në një zbatim më efikas të reformës së administratës publike në rajon duke forcuar bashkërendimin e politikave, veçanërisht ato ndërmjet strategjive të RAP dhe Menaxhimit të Financave Publike.

Një nga konkluzionet që doli gjatë diskutimeve lidhej me nevojën për të përmirësuar strukturat koordinuese të ngarkuara me qeverisjen e mirë dhe Reformën e Administratës Publike (PAR). Pjesëmarrësit gjithashtu mbështetën idenë e një Koordinatori/Njësie të RAP-së, e cila do të bashkonte në një strukturë shtresat politike dhe teknike të ngarkuara për zbatimin e RAP-së.




Një event tjetër i rëndësishëm në këtë fushë ishte dhe zhvillimi i Konferencës Rajonale për Koordinimin e Politikave me Inaugurimin e Rrjetit të Koordinatorëve të Politikave në Ballkanin Perëndimor, i mbajtur më 18-19 tetor 2021, në Tivat, Mali i Zi.

Objektivi kryesor i Konferencës ishte krijimi i Rrjetit të Koordinatorëve të Politikave në Ballkanin Perëndimor. Ky rrjet do të lidhë nëpunësit dhe zyrtarët e lartë për zbatimin e rolit të qeverisë në koordinimin e politikave dhe aspektet e ndryshme të tij - koordinimi i RAP dhe MFP, koordinimi i detyrave të integrimit evropian, përafrimi me acquis të BE-së, asistenca IPA III etj.

ANEKS I - Risku dhe mitigimi

| RISKU | NDIKIMI I MUNDSHËM | MUNDËSIA QË TË NDODHË | REAGIMI NDAJ RISKUT |
|---|---|---|---|
| • Zbatimi i masave të parashikuara për t'u përmbyllur brenda 2022;<br>• Evidentimi i problematikave dhe adresimi i tyre gjatë periudhës së vlerësimit të SNRAP për të përcaktuar nëse këto masa vazhdojnë të jenë relevante për t'u përfshirë në planin e masave të Strategjisë së RE; | I MESËM | I MESËM | • Ndjekje e realizimit të tyre brenda afateve të përcaktuara në plan veprimin e SNRAP -2018 2022;<br>• Referim i problematikave në nivel të lartë drejtues sipas përgjegjësive institucionale dhe marrja e masave për të evidentuar prioritetet për periudhën -2023 e vijim në përputhje me programin e qeverisë, SKZHIE, dokumentet e politikave prioritare dhe rekomandimet e lëna në kuadër të integrimit të vendit në BE; |
| • Mungesë ekspertize e nevojshme për të zbatuar masat kryesisht ato të cilat janë me hendek financiar;<br>• Pamjaftueshmëri e burimeve njerëzore të nevojshme për të zbatuar aktivitete të cilat janë jashtë afateve të përcaktuara;<br>• Burime të pamjaftueshme financiare për zbatimin e masave me hendek financiar. | I MESËM | I MESËM | • Pasqyrimi i nën-aktiviteteve me hendek financiar në procesin e hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm të institucioneve të përfshira në zbatimin e SNRAP. |
| • Mosevidentimi i duhur i risqeve nga ana e institucioneve; Mungesë kapacitetesh institucionale në adresimin dhe zgjidhjen e problematikave;<br>• Mungesë kapacitetesh institucionale në adresimin dhe zgjidhjen e problematikave. | I MESËM | I ULËT | • Marrja e masave për të nxitur institucionet në identifikimin dhe plotësimin e risqeve sipas metodologjisë së sistemit IPSIS, kjo përmes organizimit të takimeve të përbashkëta dhe trajnimeve në fushën e identifikimit dhe menaxhimit të risqeve;<br>• Ndjekje dhe raportim periodik i ecurisë së masave nga ana e institucioneve mbi mënyrën e adresimit dhe zgjidhjen e problematikave. |
| • Mungesë bashkëpunimi në shkëmbimin e informacionit gjatë procesit të monitorimit. | I ULËT | I ULËT | • Rritja e ndërveprimit dhe bashkëpunimit midis institucioneve dhe rritja e përdorimit të sistemit IPSIS nga ana e institucioneve gjatë inicimit të procesit të monitorimit gjashtë mujor. |

## Plani i Aktiviteteve 2018-2022

| Nr. Aktivitetit | Detajimi i aktivitetit | Nr. i nën-aktivitetit | Detajimi i nën-aktivitetit | Institucioni raportues/përgjegjës | | Data e fillimit | Data e mbarimit | Mënyra e matjes së realizimit | Ecuria e zbatimit të aktiviteteve Janar-Dhjetor 2021 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Nën-aktiviteti 1.2.6 | Finalizimi i Raport Progresit (6 mujor dhe vjetor) të veprimtarisë së GMIP/KDS si dhe Grupeve Tematike në përbërje. | Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes | | TM II 2019 | TM IV 2022 | Raport Progreset gjashtë-mujore dhe vjetore. | Gjatë periudhës së gjashtë-mujorit të parë 2021, Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes hartoi Raportin Vjetor të Performancës (RP2020) në kuadër të funksionimit të mekanizmit të qasjes së integruar sektoriale, i cili rezulton në terma të përgjithshëm se mekanizmi ka trend progresiv për vitin 2020 në mobilizimin e GMIP/KDS-ve si forume të nivelit të lartë të dialogut dhe politikëbërjes për çështje që lidhen me planifikimin dhe menaxhimin e politikave të kuadrit strategjik, planifikimin financiar, proceset e integrimit në BE dhe nismave të zhvillimit kombëtar në sektorët me përparësi, duke mundësuar kështu një tablo të rëndësishme makro të ecurisë së vendit në drejtim të zbatimit të reformave, përmbushjeve të prioriteteve të vendosura dhe duke krijuar bazën e nevojshme të përcaktimit të drejtimit për periudhën në vijim.<br>Në nivel të ndërmjetëm raporti prezanton ecurinë e çdo GMIP/KDS dhe GT përkundrejt arritjes së objektivave të vendosura, përmbushjes së programit të punës dhe realizimit të aktiviteteve të parashikuara. Në nivel të dytë raporti përmban informacione të detajuara dhe të bazuara në evidenca mbi takimet e zhvilluara, tematikat e trajtuara si dhe indikatorëve të vendosur.<br>Produktet gjatë kësaj periudhe në këtë komponent parashtrohen si më poshtë:<br>(i) 1 Raport Performance për mekanizmin për vitin 2020;<br>(ii) 12 databaza sektoriale me të dhëna analitike;<br>(iii) 12 pasaporta indikatorësh sektoriale të validuara me Sekretariatet Teknike në kuadër të veprimtarisë të të gjithë GMIP/KDS dhe GT-ve për periudhën vjetore 2020;<br>(iv) 12 Katalog Indeksesh të performancës në kuadër të zbatueshmërisë së veprimtarisë vjetore të mekanizmit. |
| | | Nën-aktiviteti 1.2.7 | Finalizimi i Raport Progresit të dedikuar (6 mujor dhe vjetor) për rolin e GMIP/KDS si Komitete Sektoriale të Monitorimit të IPA-s. | Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes | | TM II 2019 | TM IV 2022 | Raport Progreset gjashtë-mujore dhe vjetore. | Raporti Vjetor i Implementimit të IPA II (IPA AIR II), sipas termave dhe afateve të parashikuara në Marrëveshjen Kuadër me BE, në kuadër të GMIP-ve në rolin e Komiteteve Sektoriale të monitorimit IPA iu dërgua Komisionit Europian në 15 Shkurt 2021. Raporti përmbledh zhvillimet dhe analizën lidhur me aktivitetet IPA II gjatë vitit 2020, bazuar në informacionet e dërguara nga institucionet përfituese dhe institucionet lider sipas sektorëve. Raporti u përgatit me kontributin e të gjithë institucioneve përfituese dhe institucioneve kyçe.<br><br>Raporti përshkruan zhvillimet në nivel sektori (strategjik dhe progresin e projekteve), për fushat e mëposhtme: Demokracia dhe Mirëqeverisja; Zbatimi i ligjit dhe të drejtat themelore; Transporti; Mjedisi, Klima dhe Energjia; Bujqësia, Konkurrueshmëria e Inovacioni; Arsimi, Punësimi dhe Politikat sociale; Bashkëpunimi territorial (programet ndërkufitare) lidhur me proceset e menaxhimit të fondeve IPA gjatë vitit 2020, programimi-zbatimi-monitorimi-auditimi, zhvillimet, sfidat/problematikat dhe rekomandimet për përmirësime të mëtejshme.<br>Gjatë vitit 2021 (për shkak të rënies së intensitetit të aktiviteteve dhe zhvillimeve edhe lidhur me projektet IPA), u ra dakord me DBE që raundi i parë i GMIP-ve ne rolin e Komiteteve Sektoriale të Monitorimit të mbahet në gjashte-mujorin e dyte 2021, edhe pas formimit të kabinetit të ri qeveritar dhe mundësisë për njohjen me angazhimet IPA dhe përcaktimin e mundshëm të drejtimit të ri strategjik. Në këtë kuadër, njësoj raportimi i institucioneve për konkluzionet operacionale të KSM-ve do të kryhet në të njëjtën periudhë. |
| | | Nën-aktiviteti 1.2.8 | Finalizimi i Paketës së udhëzimeve, guidave dhe notave të pozicionit për funksionimin e GMIP/KDS. | Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes | | TM I 2019 | TM IV 2022 | Paketa e finalizuar. | Gjatë vitit 2021, Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes së bashku me Asistencën Teknike, inicioi bashkërendimin e procesit të gjithë Sekretariatet Teknike të mekanizmit me qëllim garantimin e një kuadri metodologjik të konsoliduar/përmirësuar të orientuar drejt performancës, duke krijuar në këtë mënyrë gjithë infrastrukturën e duhur për standardizimin e procedurave për funksionimin e GMIP/KDS/GT në zbatim të urdhrit nr.157, datë 22.10.2018, të Kryeministrit, "Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen e funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar". Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar 22 takime të dedikuara dhe po hartohen pasaportat e Indikatorëve të Performancës në kuadër të konsolidimit të procedurave standarde |
| | | Nën-aktiviteti 1.2.9 | Finalizimi i programit ndër-sektorial për Mirëqeverisjen. | Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes | | TM IV 2020 | TM IV 2022 e vijim | Programi sektorial për Mirëqeverisjen. | Dokumenti i Veprimit për Mirëqeverisjen dhe Administrimin Publik u hartua ne bashkërendim me të gjithë aktorët dhe sekretariatet teknike të GMIP-së në zbatim të urdhrit nr.157, datë 22.10.2018, të Kryeministrit, "Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen e funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar". Dokumenti i Veprimit/Action Document për Mirëqeverisjen u bashkërendua dhe me shërbimet e Delegacionit me qëllim unifikimin e një kornize të plotë objektivash dhe masash prioritare në zbatim të IPA 2020. Marrëveshja e Financimit për programin IPA 2020 është miratuar në parim nga ana e Këshillit të Ministrave nëpërmjet Vendimit nr.157, datë 17.03.2021, "Për miratimin për parim të Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Evropian në lidhje me Programin Vjetor të Veprimit për Shqipërinë për vitin 2020, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA II)" dhe është nënshkruar nga KKIPA në datën 12 prill 2021. Gjatë vitit 2021 u zhvillua dhe Misioni Compliance Review ku u mbajtën takime të dedikuara me sekretariatet dhe të gjithë grupet e interesit, si dhe u hartua Raporti i Vlerësimit për Programin Sektorial të Mirëqeverisjes. |
| | | Nën-aktiviteti 1.2.10 | Hartimi i paketës së Raport Progresit për Reformën e Administratës Publike në kuadër të PAR SG | Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes | | TM IV 2020 | TM IV 2022 | Paketa e finalizuar. | Bashkërendimi i paketës të konsoliduar për Komitetin e Nivelit të Lartë të Grupit të Posaçëm për Mirëqeverisjen dhe Administrimin Publik u koordinua me Komisionin Evropian me qëllim progresin e agjendës së Mirëqeverisjes dhe realizimin e mbledhjes së Nivelit të Lartë në Janar 2022. |
| | | Nën-aktiviteti 1.2.11 | Hartimi i raportit të vlerësimit të politikave kombëtare dhe rajonale. | Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes & Grupi Tematik i Politikëbërjes | Ministritë e Linjës dhe OECD | TM IV 2019 | TM IV 2020 | Raporti i finalizuar. | Aktivitet i përfunduar në Korrik 2020. Lidhur me hartimin e raportit rajonal, mbështetja dhe inciimi ishte përmes OECD/SIGMA për të gjashtë vendet e Ballkanit Perendimor. Raporti rajonal "Glance Report" u përfundua, dhe u lancua prezantimi me përfaqësues të lartë të gjashtë vendeve, si dhe përfaqësues të OECD/SGIMA dhe Komisionit Evropian. Raporti Rajonal përmban reformat në 10 fushat analizuese ku volumin më të madh e zë fusha e Qeverisjes publike dhe çështjeve të Integrimit Evropian. (raporti u finalizua dhe u lançua në Korrik 2020). |
| | | Nën-aktiviteti 1.2.12 | Hartimi i strategjisë për kuadrin mirërregullator / *better regulation multi-action annual plan* dhe planit të veprimit. | Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes & Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë | Ministritë e Linjës | TM II 2020 | TM I 2021 | Strategjia dhe Plani I Veprimit i hartuar. | Me mbështetjen e asistencës teknike për Konsultimin dhe Vlerësimin e Ndikimit u rakordua qasja e hartimit të Koncept Dokumentave të Politikave për Kuadrin Regullator për të cilën janë hartuar nga asistenca teknike BE-së në lidhje me kontributin fillestar. Më specifikisht:<br>Paketa konceptuale fillestare lidhur me reformën mirë-rregullatore ka dizenjuar katër (4) koncept dokumenta:<br>1. Propozimi i Koncept Dokumentit (I) synon krijimin e kushteve të nevojshme për reduktimin e barrës administrative me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe rritjes ekonomike të integruar në proceset legjislative dhe RIA. Targeti i politikës së propozuar (Koncept Dokumenti I) synon rritjen ekonomike midis 1,65% dhe 3,6% (bazuar në një objektiv të reduktimit të barrës administrative 25%);<br>2. Propozimi i Koncept Dokumentit (II) synon krijimin e praktikave për vlerësim ex-post;<br>3. Propozimi i Koncept Dokumentit (III) synon konsolidimin e kornizës-kuadër për përmirësimin e konsultimeve publike deri në vitin 2027, përfshirë alokimin e burimeve nga buxheti kombëtar dhe mbështetjen e mundshme nga partnerët e zhvillimit;<br>4. Propozimi i Koncept Dokumentit (IV) synon përmirësimin e vlerësimit rregulator/RIA.<br><br>Për të katër koncept dokumenat janë propozuar tre (3) opsione të cilat do të vlerësohen në kuadrin e ri të ciklit të politikave në kuadër të SKZHIE 2030. |
| Objektivi 2: Sistem transparent i hartimit të ligjeve, gjithëpërfshirës, i bazuar në politika dhe që siguron përafrimin me acquis | | | | | | | | | |
| 2.1 | *Përmirësimi i mekanizmave dhe instrumenteve të lidhura me konsultimin publik* | Nën-aktiviteti 2.1.1 | Përgatitja e Udhëzimeve Operacionale për ministritë e linjës për kryerjen e procesit të konsultimit publik dhe funksionimin e e-regjistrit të konsultimit publik | Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes | Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit | TM II 2018 | TM IV 2018 | Guida Operacionale e hartuar. | Aktiviteti ka përfunduar në përputhje me procedurat. Ka përfunduar hartimi i manualit për perdorimin e rregjistrit të konsultimit publik. |
| | | Nën-aktiviteti 2.1.2 | Trajnim/Ngritje kapacitetesh për stafin përgjegjës në ministritë e linjës për përdorimin e e-platformës së konsultimit publik. | Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes | Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit / Shkolla Shqiptare e Administratës Publike | TM II 2018 | TM IV 2018 | Stafi i trajnuar. | Aktiviteti ka përfunduar në përputhje me procedurat. Kanë përfunduar workshopet e dedikuara për orientimin lidhur me përdorimin e rregjistrit të konsultimit publik. |
| | | Nën-aktiviteti 2.1.3 | Përgatitja e manualit për konsultimin publik (për publikun dhe ekspertët) për të lehtësuar pjesëmarrjen në konsultimet publike përmes përdorimit të regjistrit të e-konsultimit. | Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes | Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit | TM II 2018 | TM IV 2020 | Manuali i përdoruesve i hartuar. | Aktiviteti ka përfunduar në përputhje me procedurat. Ka përfunduar hartimi i manualit për perdorimin e rregjistrit të konsultimit publik. |
| | | Nën-aktiviteti 2.1.4 | Publikimi në sistem i raporteve të konsoliduara që paraqesin nivelin e reflektimit të komenteve të publikut | Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes | Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit | TM II 2018 | TM IV 2018 | Funksionaliteti i platformës i përmirësuar. | Aktiviteti ka përfunduar në përputhje me procedurat. Ka përfunduar hartimi i manualit për perdorimin e rregjistrit të konsultimit publik. |
| | | Nën-aktiviteti 2.1.5 | Monitorimi i rregullt i realizimit të procesit të konsultimit publik. | Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes | Ministritë e linjës | TM II 2018 | TM IV 2020 | Raportet e monitorimit të hartuara (raporti i parë i përgatitur në TM I 2019). | Gjatë gjashtë-mujorit të parë 2021, në bashkërendim me asistencën teknike janë finalizuar 10 paketat e plota të Raporteve Vjetore Institucionale për konsultimin publik nga ministritë e linjës (Raport Vjetor 2020). Më specifikisht janë hartuar dhe konsoliduar 10 raporte vjetore të konsultimit publik nga ministritë e linjës (Raport Vjetor 2020) bazuar në Urdhrin nr.3, datë 29.01.2021 të Sekretarit të Këshillit të Ministrave. Raportet Vjetore të Konsultimit Publik pas aprovimit janë publikuar në platformën e konsultimit publik/Regjistrin Elektronik. Gjithashtu, u konsolidua paketa e plotë e Raportit të Qendrës së Qeverisjes për Konsultimin Publik gjashtë-mujori i parë 2021 që u prezantua në mbledhjen e dedikuar të Grupit Tematik të politikëbërjess si dhe u publikua në Regjistrin Elektronik të Konsultimeve Publike. Gjatë vitit 2021, u morën masat për hartimin e Raportit të Monitorimit Vjetor 2021 për Planin Vjetor të Konsultimit Publik 2021 (të dhëna më të hollësishme të referohen nga Raporti i dërguar për vitin 2021). |
| | | Nën-aktiviteti 2.1.6 | Hartimi periodik i Outlook report për procesin e konsultimit publik. | Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes | | TM IV 2020 | TM IV 2022 | Outlook Report. | Në tremujorin e parë të vitit 2021 është finalizuar Raporti Vjetor i Performancës së Konsultimit Publik për vitin 2020 (Outlook Report). Raporti u prezantua në dy workshope të dedikuara me ministritë e linjës/Rrjeti i Konsultimit Publik dhe me përfaqësues nga Delegacioni Evropian.Raporti paraqet gjetjet, realizimin e Indeksit të Konsultimit Publik për vitin 2020, si një tregues i rëndësishëm i ecurisë së Reformës së Administratës Publike, performancën institucionale si dhe aktivitetet konsultative të zhvilluara me aktorët e interesit dhe marrjen në konsideratë të komenteve të mbledhura/si feedback mekanizëm.<br><br>Procesi i konsultimit publik për vitin 2020 rezulton se është në trend përmirësimi, më specifikisht Indeksi i konsultimit publik rezulton 79,57% (2020) në krahasim me 71.42 % në vitin 2019 dhe 47.23 % në vitin 2018. Ndërsa lidhur me Indeksin e Cilësisë së Konsultimit Publik për vitin 2020 rezulton 5.66 pikë me një trend sërisht rritje krahasuar me vitin 2019 (5.12 pikë) dhe 3.27 pikë në vitin 2018. Gjithashtu, në këtë periudhë (2021) u konsolidua paketa e plotë e Raportit të Qendrës së Qeverisjes për Konsultimin Publik të gjashtë-mujorit të parë 2021 ku u prezantua në mbledhjen e dedikuar të Grupit Tematik të politikëbërjes si dhe u publikua në Regjistrin Elektronik të Konsultimeve Publike. Gjatë vitit 2021, u morën masat për hartimin e Raportit të Monitorimit Vjetor 2021 për Planin Vjetor të Konsultimit Publik 2021 (të dhëna më të hollësishme të referohen nga Raporti i dërguar për vitin 2021). |
| | | Nën-aktiviteti 2.1.7 | Hartimi i dokumentit të analizës ligjore të kuadrit të konsultimit publik | Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes | | TM I 2019 | TM IV 2020 | Dokumenti i analizës ligjoretë kuadrit të kosultimit publik. | Aktivitet i realizuar. Paketa e analizës ligjore për kuadrin e konsultimt publik është përfunduar me asistencën teknike të Bashkimit Evropian dhe është konsoliduar paketa e analizës gjithpërfshirëse ku në të 4 komponentët dhe fushat e ndërhyrjes janë përcaktuar masat prioritare legjislative dhe jo vetëm me qëllim përmirësimin e procesit të konsultimit publik. |
| | | Nën-aktiviteti 2.1.8 | Hartimi i dokumentit të kuadrit metodologjik për përmirësimin e procesit të konsultimit publik. | Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes | | TM III 2019 | TM IV 2020 | Dokumenti i kuadrit metodologjik për përmirësimin e procesit të kosultimit publike. | Gjatë vitit 2021, në bashkëpunim me Asistencën Teknike është finalizuar dhe aprovuar paketa e plotë e kuadrit metodologjik për konsultimin publik. Paketa metodologjike është aprovuar me Urdhër të Sekretarit të Këshillit të Ministrave nr.3, datë 29.01.2021 "Për miratimin e Udhëzuesit për procesin e konsultimit publik". Paketa e finalizuar/aprovuar përmban komponentët e mëposhtëm:<br>a. Guida Metodologjike për procesin e konsultimit publik;<br>d. Metodologjia për planifikimin e akteve vjetore për konsultimin publik;<br>e. Metodologjia për hartimin e raporteve 6-mujore dhe vjetore për ministritë e linjës; |

# Plani i Aktiviteteve 2018-2022

| Nr. Aktivitetit | Detajimi i aktivitetit | Nr. i nën-aktivitetit | Detajimi i nën-aktivitetit | Institucioni raportues/përgjegjës | | Data e fillimit | Data e mbarimit | Mënyra e matjes së realizimit | Ecuria e zbatimit të aktiviteteve Janar-Dhjetor 2021 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Nën-aktiviteti 6.1.11 | Ngritja e kapaciteteve insitucionale për përdorimin e manualit të përshkrimeve të punës | Departamenti i Administratës Publike | | TM IV 2019 | TM IV 2022 | Numri i personave të trajnuar. | Departamenti i Administratës Publike në bashkëpunim me ekspertizën e projektit IPA 2014 "Zbatimi i reformës së shërbimit civil në të gjithë administratën publike" ka zhvilluar takime/trajnime me përfaqësuesit e ministrive të linjës ku ndër të cilat përfshiheshin dhe trajnime për përshkrimet e punës. Në total janë mbajtur 30 workshop/takime mbi "Rishikimin e përshkrimeve të punës në ministritë e linjës" ku kanë marrë pjesë 527 nëpunës civilë. |
| 6.2 | *Përmirësimi i procesit të rekrutimit nëpërmjet marrjes së opinionit të publikut mbi procedurat e rekrutimit* | Nën-aktiviteti 6.2.1 | Kryerja e vlerësimeve 'ad-hoc' (sipas rasteve) për të marrë opinionin e aplikantëve mbi procesin e rekrutimit dhe marrja e masave për të adresuar çështjet që dalin nga vlerësimi. | Departamenti i Administratës Publike | | TM III 2018 | TM IV 2022 | (i) Vlerësimet e kryera;<br>(ii) Gjetjet e reflektuara;<br>(iii) Masat e marra për adresimin e tyre të evidentuara në raportet e brendshme të DAP. | Në lidhje me opinionin/reagimin e aplikantëve mbi procesin e rekrutimit, janë mbledhur opinionet e aplikanëve përmes dorëzimit të tyre në rrugë të drejtpërdrejtë, info DAP, kanaleve dhe mediave sociale si Facebook. DAP, gjatë vitit 2021, i është përgjigjur 1680 kërkesave për informacion të adresuar nga qytetarët/aplikantët përmes komunikimit në Facebook dhe përmes info DAP. |
| | | Nën-aktiviteti 6.2.2 | Bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë për të përthithur studentët më të mirë në administratën publike (qendrore dhe vendore). | Departamenti i Administratës Publike | | TM IV 2018 | TM IV 2022 | Panaire pune, marrëveshje bashkëpunimi, orë të hapura, etj. | Gjatë vitit 2021, DAP ka bashkëpunuar me institucionet e arsimit të lartë për tu njohur me diplomat universitare të nivelit Bachelor si edhe Master të cilat realizohen nga universitetet publike dhe private në vend. Gjithashtu, në muajin Dhjetor 2021 është zhvilluar edhe një seksion informues në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Tiranës, ku studentët e Masterit Profesional ne degën Administrim Publik, u informuan mbi procedurat e rekrutimit në shërbimin civil dhe mundësitë e punësimit që ofron DAP. |
| 6.3 | *Shtrirja në shkallë të gjerë e Sistemit Informatik për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ/HRMIS) dhe vënia në funksionim e modulit të pagave* | Nën-aktiviteti 6.3.1 | Zgjerimi i SIMBNJ në të gjitha institucionet e administratës publike. | Departamenti i Administratës Publike | Institucionet e administratës publike | Në vijim | TM IV 2020 | (i) 100% e institucioneve të administratës shtetërore, pjesë e shërbimit civil - TM IV 2018;<br>(ii) 100% e institucioneve të administratës shtetërore, jo shërbim civil dhe institucionet e pavarura - TM II 2019;<br>(iii) 100 % Bashkitë dhe qarqet - TM IV 2019. | Në lidhje me zgjerimin e SIMBNJ në të gjitha institucionet e administratës publike, gjatë vitit 2021 rezultojnë si më poshtë:<br>- 241 Njësi shpenzuese të institucioneve të Administratës Shtërore pjesë e Ligjit për Shërbimin Civil<br>- 485 njësi shpenzuese të institucioneve të Administratës Shtetërore jo pjesë e Ligjit për Shërbimin Civil;<br>- 19 njësi shpenzuese të institucioneve të Pavarura;<br>- 73 njësi shpenzuese të Njësive të Qeverisjes Vendore;<br>- 2 njësi shpenzuese të Gjyqësorit. |
| | | Nën-aktiviteti 6.3.2 | Gjenerimi i pagave për punonjësit e administratës publike nëpërmjet SIMBNJ. | Departamenti i Administratës Publike | Ministria e Financave dhe Ekonomisë | TM II 2018 | TM IV 2020 | (i) 80% e institucioneve të administratës shtetërore pjesë e shërbimit civil gjenerojnë pagën nëpërmjet HRMIS/SIMBNJ - TM IV 2018;<br>(ii) 100% e administratës shtetërore pjesë e shërbimit civil gjenerojnë pagën nëpërmjet HRMIS/SIMBNJ- TM II 2019;<br>(iii) të gjitha institucionet e tjera të administratës shtetërore jo shërbim civil gjenerojnë pagën nëpërmjet HRMIS/SIMBNJ brenda TM IV 2019; | Institucione të cilat gjenerojnë pagën me HRMIS gjatë vitit 2021 janë: 51 institucione në Shërbim Civil; 5 institucione të pavarura; 65 institucione jo në Shërbim Civil; dhe 0 Njësi vendore. |
| | | Nën-aktiviteti 6.3.3 | Trajnimi i nëpunësve të burimeve njerëzore dhe të njësive të financës për përdorimin e SIMBNJ. | Departamenti i Administratës Publike | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike | Në vijim | TM IV 2021 | Të paktën 200 punonjës të trajnuar çdo vit (burime njerëzore dhe financë). | Për periudhën Janar - Dhejtor 2021 për sistemin HRMIS janë trajnuar: 194 nëpunës të insitucioneve pjesë e ligjit "Për Shërbimin Civil"' dhe institucioneve me "Kod Pune" (116 specialistë të njësive të Burimeve Njerëzore dhe 78 specialistë të Njësive të Menaxhimit Financiar). |
| 6.4 | *Rritja e nivelit të zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga insititucionet e administratës shtetërore* | Nën-aktiviteti 6.4.1 | Monitorimi i modulit online (database) në lidhje me vendimet gjyqësore në institucionet e administratës shtetëror në platformën "administrata.al". | Departamenti i Administratës Publike | | TM I 2019 | Çdo vit | Moduli online i monitoruar. | Një tjetër aspekt i rëndësishëm është monitorimi i modulit online (database) në lidhje me vendimet gjyqësore në institucionet e administratës shtetërore në platformën "www.administrata.al".<br>Në këtë linjë ka vijuar bashkëpunimi i DAP me KMSHC dhe institucionet e administratës shtetërore, me qëllim administrimin e të dhënave të sakta e në kohë reale, mbi zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.<br>Në këtë linjë, personi përgjegjës pranë DAP-it, i ngarkuar me monitorimin e këtij procesi dhe personat përgjegjës pranë sistemeve ministrore, të ngarkuar me detyrimin e pasqyrimit në databazë të të dhënave, kanë vijuar komunikimin periodik. DAP-i përveç monitorimit dhe kontrollit të punës së kryer nga përfaqësuesit e ministrive, asiston dhe i mbështet ata për zgjidhjen e problematikave të ndryshme, që mund të hasen gjatë procesit duke unifikuar dhe procedurat konkrete.<br>Në mënyrë të vazhdueshme, personave përgjegjës në ministritë e linjës iu kërkohet raportim me e-mail, mbi vendimet gjyqësore të zbatuara dhe të pazbatuara, si dhe një përmbledhje e ndryshimeve të ndodhura mbi të dhënat e pasqyruara sipas rubrikave në platformën e bashkëpunimit. Ndërkohë, në çdo rast të nxjerrjes së aktit të emërimit të një gjyqfituesi nga DAP si njësi përgjegjëse, si dhe administrimit të njoftimit mbi një vendim gjyqësor të formës së prerë të paraportuar, personit përgjegjës në ministri i kërkohet përditësimi i të dhënave.<br>Po ashtu, sa herë që DAP-i vihet në dijeni të fakteve të reja në lidhje me ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë nga ana e përmbaruesit gjyqësor/gjyqfituesit, kërkon nga institucioni përkatës pasqyrimin e tyre në këtë platformë.<br>Përgjatë periudhës Janar-Dhjetor 2021, DAP-i ka rakorduar me të gjithë institucionet raportuese, duke verifikuar rast pas rasti, të dhënat e hedhura në sistem, e duke kërkuar përditësimin e tyre nga personi përgjegjës. |
| | | Nën-aktiviteti 6.4.2 | Monitorimi i zbatimit të vendimeve gjyqësore në institucionet e administratës shtetërore nëpërmjet procedurave administrative të komisioneve të posaçme. | Departamenti i Administratës Publike | | TM I 2019 | Çdo vit | Zbatimi i vendimeve gjyqësore i monitoruar. | Departamenti i Administratës Publike ka vijuar me monitorimin e zbatimit të vendimeve gjyqësore në institucionet e administratës shtetërore nëpërmjet procedurave administrative të parashikuara në Urdhrin nr. 5151, datë 28.10.2015 "Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit "Për Shërbimin Civil", përmes ngritjes së komisioneve të posaçme pranë institucioneve të administratës shtetërore.<br>Gjithashtu, DAP ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme administrative për të asistuar dhe mbështetur institucionet e administratës shtetërore, që në cilësinë e palës debitore të zbatojnë rigorozisht procedurat që duhen ndjekur gjatë ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.<br>Përgjatë periudhës Janar-Dhjetor 2021 ky proces është përmbyllur me sukses në 86 raste gjyqfituesish të cilët kanë qenë në listë për t` u sistemuar në një pozicion të rregullt të shërbimit civil, duke shënuar kështu një trend shumë pozitiv në rritje sa i takon zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Përpjekjet e vazhdueshme të Departamenti të Administratës Publike për të vënë në lëvizje institucionet e administratës shtetërorë kanë bërë që viti 2021 të ketë nivelin më të lartë të zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prërë në favor të nëpunësve civil gjyqfitues, duke rritur në këtë mënyrë përqindjen e zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë në 79.3%. |
| 6.5 | *Rritja e nivelit të zbatimit të ligjit për nëpunësin civil dhe aplikimi i unifikuar i tij në njësitë e qeverisjes vendore* | Nën-aktiviteti 6.5.1 | Nxjerrja e udhëzimeve dhe rekomandimeve në lidhje me unifikimin e zbatimit të ligjit në shërbimin civil bazuar në problematikat e evidentuara nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në administratën publike. | Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil | | TM II 2018 | Në vijim | (i) Udhëzime të nxjerra nga Komisioneri;<br>(ii) Rekomandime të Komisionerit për rregullimin e situatave të paligjshme të zbatuara. | Në lidhje me masën (i), gjatë vitit 2021 janë nxjerrë udhëzimet si më poshtë:<br>1. Udhëzim në drejtim të respektimit të të drejtave politike të nëpunësve civilë gjatë procesit zgjedhor; 2. Udhëzim për shmangien e pengesave të krijuara nga institucionet për pjesëmarrjen e kategorisë së nëpunësit civil në administratën zgjedhore të emëruar nga KQZ; 3. Udhëzim në drejtim të vlerësimit të veprimtarisë së nëpunësit civil në rrjetet sociale; 4. Udhëzim në lidhje me riklasifikimin e pozicioneve të punës, për të gjithë sistemin e shërbimit civil në njësitë e qeverisjes vendore (bashki).<br>Në lidhje me masën (ii) janë kryer proceset si më poshtë:<br>a. Në lidhje me procesin e hetimit administrativ, gjatë periudhës së raportimit, Komisioneri ka trajtuar 110 kërkesa/ankesa nga nëpunës civilë. Referuar statusit të tyre apo mënyrës së trajtimit rezulton se: (i) Komisioneri, në përfundim të hetimit administrativ, ka nxjerrë 58 vendime paralajmërimi në rastet kur janë konstatuar shkelje apo arkivim pasi gjatë hetimit nuk janë konstatuar parregullsi; (ii) Në 12 raste, procesi i hetimit administrativ është mbyllur duke i kthyer përgjigje kërkuesit/ankuesit (nga të cilat 1 rast i përket kërkesave/ankesave të depozituara gjatë vitit 2020); (ii) 1 rast është bashkuar me procesin e mbikëqyrjes; (iv) Për 39 raste është duke vijuar procesi i hetimit administrative.<br>b. Komisioneri ka kryer procesin e verifikimit lidhur me zbatimin e nenit 65, germa "c", të ligjit nr. 152/2013, dispozitë e cila urdhëron lirimin nga shërbimi civil të nëpunësve që kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë. Për këtë arsye, u është kërkuar njësive përgjegjëse të raportojnë për nëpunësit që aktualisht mbahen në punë pas plotësimit së moshës së pensionit të pleqërisë, ashtu edhe për nëpunësit të cilët plotësojnë moshën deri në datën 31.12.2021. Për realizimin e këtij procesi është komunikuar me 117 institucione, pjesë e administratës shtetërore, njësi të vetëqeverisjes vendore dhe institucione të pavarura, sipas kësaj tipologjie: 24 institucione të Administratës Shtetërore, nga ku: (i) 12 institucione (Kryeministria, 11 Ministritë e linjës dhe Institucionet në varësi të tyre) dhe 12 Prefektura; (ii) 73 Njësi të Administratës Vendore, nga ku: 61 Bashki dhe 12 Këshilla Qarku; si dhe (iii) 20 Institucione të pavarura. Në vijim të bashkëpunimit midis dy institucioneve, Komisioneri ka nënshkruar në datë 11.11.2021, një memorandum mirëkuptimi me Departamentin e Administratës Publike, që ka për qëllim zbatimin e unifikuar të legjislacionit për nëpunësin civil në të gjitha institucionet e administratës publike pjesë e tij, nëpërmjet rritjes dhe forcimit të bashkëpunimit, bashkërendimit të aktiviteteve të përbashkëta, shkëmbimit të të dhënave, unifikimit të praktikës administrative gjatë aplikimit të instituteve të këtij legjislacioni, si dhe ofrimit të ekspertizës së nevojshme për zgjidhjen e problematikave. |
| | | Nën-aktiviteti 6.5.2 | Hartimi dhe propozimi për ndryshimet ligjore të domosdoshme për të unifikuar zbatimin e ligjit në administratën shtetërore dhe vendore. | Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil | | TM II 2019 | TM IV 2019 | (i) Numri i udhëzimeve;<br>(ii) Numri i ndryshimeve ligjore të propozuara. | Në lidhje me masën (i) DAP në bashkëpunim me ekspertët e Projektit IPA 2014 "Zbatimi i Reformës së Shërbimit Civil në Administratën Publike", kanë hartuar disa manuale dhe udhëzues kryesisht për njësitë e burimeve njerëzore, me qëllim që të mundësohet administrimi i unifikuar i shërbimit civil në praktikë, në përputhje me kërkesat e ligjit dhe me standardet më të mira evropiane, ku janë materializuar edhe propozimet e Komisionerit.<br>Për sa i përket masës (ii) në lidhje me propozimet për ndryshimet ligjore për disa aspekte të administrimit të shërbimit civil, të evidentuara edhe në informacionin e përgatitur për ecurinë e SNRAP për vitin 2020, Departamenti i Administratës Publike me asistencën e projektit IPA 2014 "Zbatimi i Reformës së Shërbimit Civil në Administratën Publike" ka vijuar punën së bashku me KMSHC, për të hartuar dokumentet përkatëse për ndryshimet ligjore, të cilat tashmë janë planifikuar nga DAP-i për t'u realizuar në katër mujorin e fundit të vitit 2021. |
| | | Nën-aktiviteti 6.5.3 | Monitorimi i zbatimit të ligjit "Për Nëpunësin Civil" gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet vendore të vitit 2019 dhe zgjedhjet parlamentare të vitit 2021 i monitoruar. | Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil | | TM II 2019/TM II 2021 | TM III 2019/ TM III 2021 | Zbatimi i ligjit për shërbimin civil i monitoruar gjatë zgjedhjeve parlamentare/vendore. | Në zbatim të kompetencës ligjore për të mbikëqyrur administrimin e shërbimit civil, bazuar në nenin 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe në zbatim të planit vjetor të veprimtarisë së institucionit, KMSHC ka realizuar procesin e mbikëqyrjes për të siguruar zbatimin e ligjit për nëpunësin civil në kushtet e zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Ky proces ka nisur me urdhrin e brendshëm nr. 13, datë 11.02.2021, me anë të të cilit Komisioneri ka ngritur grupin e gatshëm për monitorimin e zbatimit të ligjit për nëpunësin civil, me qëllim mbledhjen e informacionit nga grupet e monitorimit që do të ngriheshin në të gjitha institucionet që janë pjesë e sistemit të shërbimit civil, kryerjen e sondazheve në institucione, verifikimin e informacioneve apo denoncimeve të ardhura nga subjekte të ndryshme, si dhe nga media.<br><br>Në këtë proces, janë vendosur kontaktet me 200 institucione të administratës publike, nga të cilat: 114 institucione të administratës shtetërore, nga ku: 12 institucione të administratës shtetërore (Kryeministria dhe 11 Ministritë e linjës); 90 institucione varësie dhe 12 prefektura; 73 institucione të vetëqeverisjes vendore (12 Këshilla Qarku dhe 61 bashki); dhe 13 institucione të pavarura, si dhe janë përfshirë 12 896 pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil.<br><br>Në vijim, Komisioneri, me urdhrin e brendshëm nr. 25, datë 09.04.2021, ka nisur procesin e monitorimit në subjekt me fokus emërimet e reja, largimet nga shërbimi civil dhe sjelljen e nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore.<br><br>Ky proces është përmbyllur me vendimin nr. 79, datë 23.06.2021, të Komisionerit, "Për miratimin e raportit për mbikëqyrjen e administrimit të shërbimit civil dhe monitorimin e sjelljes së nëpunësit civil në kushtet e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë", ku janë evidentuar të gjitha gjetjet dhe janë analizuar të gjitha problematikat e hasura gjatë këtij procesi.<br><br>Komisioneri ka vijuar të ndjekë situatën dhe ka konstatuar se kanë kaluar në proces disiplinor rastet problematike që janë evidentuar në raportin e Komisionerit. |
| | | Nën-aktiviteti 6.5.4 | Monitorimi i zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga insititucionet e administratës publike, nëpërmjet seancave dëgjimore dhe hetimit administrativ. | Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil | | TM I 2019 | Në vijim | Zbatimi i vendimeve gjyqësore i monitoruar. | KMSHC ka vijuar edhe përgjatë periudhës së raportimit procesin e monitorimit të zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës publike, i cili gjatë vitit 2021 është shtrirë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve duke e ndërthurur me mbikëqyrjen e procesit të ristrukturimit, me qëllim rritjen e nivelit të zbatimit të vendimeve gjyqësore. Për shkak të numrit të madh të rasteve të nëpunësve civilë gjyqfitues (143 raste) dhe kompleksitetit të këtij procesi, ky proces është duke vijuar ende, në përshtatje edhe me situatën e krijuar për shkak të gjendjes së pandemisë. |
| | | Nën-aktiviteti 6.5.5 | Organizimi i trajnimeve të përbashkëta me ASPA-n për | Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil | | TM II 2018 | TM IV 2020 | (i) Numri i kurseve të trajnimit të organizuara në bashkëpunim me ASPA-n;<br>(ii) Numri i personave të trajnuar. | Aktivitet i përfunduar.<br>Në vijim të përpjekjeve të Komisionerit për të unifikuar zbatimin e ligjit për nëpunësin civil në administratën vendore dhe me qëllim njohjen e situatës së administrimit të shërbimit civil, nëpërmjet |

| Plani i Aktiviteteve 2018-2022 | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. Aktivitetit | Detajimi i aktivitetit | Nr. i nën-aktivitetit | Detajimi i nën-aktivitetit | Institucioni raportues/përgjegjës | Data e fillimit | Data e mbarimit | Mënyra e matjes së realizimit | Ecuria e zbatimit të aktiviteteve Janar-Dhjetor 2021 |
| 6.6 | *Ngritja e kapaciteteve të KMSHC për të mundësuar ushtrimin e plotë të mandatit të tij* | Nën-aktiviteti 6.6.1 | Rishikimi dhe miratimi i strukturës së KMSHC dhe rritja e numrit të stafit. | Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil | TM II 2018 | TM I 2020 | (i) Struktura e miratuar;<br>(ii) Numri i punonjësve shtesë. | Aktivitet i realizuar.<br>Me qëllim për të adresuar nevojën për më shumë staf dhe burime financiare për të përmbushur më mirë detyrat që ligji i ka ngarkuar Komisionerit si institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, pas ndërmarrjes së të gjitha hapave dhe procedurave nga Komisioneri të parashikuara në Planin e Masave për zbatimin e Rekomandimeve të Raportit të Komisionit Evropian për vitin 2020, në ligjin nr. 115/2021 "Për buxhetin e vitit 2022" janë miratuar fondet për 4 nëpunës shtesë. Aktualisht, procedura për ndryshimin e strukturës është duke vijuar në Kuvendin e Shqipërisë. Gjatë vitit 2022, Komisioneri do të vijojë përpjekjet edhe për minimalisht 2 punonjës të tjerë shtesë. |
| 6.7 | *Rritja dhe forcimi i kapaciteteve të punonjësve të përfshirë në riinxhinierizimin e proceseve dhe në ofrimin e shërbimeve të përmirësuara për publikun* | Nën-aktiviteti 6.7.1 | Trajnimi dhe ofrimi i asistencës ´online´ për punonjësit e administratës publike, për gjenerimin e dokumenteve shoqëruese të disponueshme me vulë dixhitale në portalin "e-albania", në emër të qytetarit dhe biznesit. | Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit | TM I 2018 | TM IV 2020 (në vijim) | Numri i punonjësve të trajnuar. | Aktivitet i realizuar. |
| 6.8 | *Forcimi i vazhdueshëm i ASPA si ofrues i trajnimeve për burimet njerëzore me synimin e përgatitjes dhe zhvillimit të një administrate publike efiçente* | Nën-aktiviteti 6.8.1 | Zhvillimi i një sistemi efektiv për vlerësimin e trajnimit, që do të gjenerojë më shumë të dhëna lidhur me cilësinë e trajnimit, arritjen e objektivave dhe matjen e ndikimit të trajnimit në performancën individuale, të institucionit dhe të sistemit në tërësi. | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike | TM I 2018 | TM IV 2020 | (i) Vlerësime objektive dhe të pavarura periodike të cilësisë çdo 2 vjet;<br>(ii) Të paktën 2 vlerësime të ndikimit të programeve të trajnimit çdo vit. | Aktivitet i realizuar.<br>Gjatë vitit 2021, ASPA ka vijuar me vlerësimin periodik, ku:<br>(i) ASPA në përfundim të çdo trajnimi shpërndan formularët e vlerësimit të cilat plotësohen nga çdo pjesëmarrësit. Edhe gjatë zhvillimit të trajnimeve online, ASPA ka vijuar me këtë proces. Formulari është anonim dhe vlerësimi është i ndarë në 3 seksione:<br>- Vlerësimi i përgjithshëm i trajnimit (dobishmërinë e trajnimit, shkalla e përfitimit të njohurive, vlerësimi i përmbajtjes dhe sugjerime për nevoja të reja);<br>- Vlerësimi i trajnerëve (fusha e ekspertizës, metodat e përdorura për përcjelljen e njohurive). Trajnerët vlerësohen nga pjesëmarrësit dhe nga monitorimi i menaxherëve që ndjekin trajnimin;<br>- Vlerësim për materialet e trajnimit dhe mënyrën e organizimit të tij nga ASPA, përfshirë edhe aspektet e organizimit online. Të dhënat e dala nga formularët e trajnimit përpunohen dhe rezultatet e tyre i shërbejnë ASPA-s për përmirësimin e cilësisë së trajnimit.<br>(ii) ASPA në bashkëpunim me Centro Informazione e Educazione allo Sviluppo Onlus (CIES) me mbështetjen financiare të Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim (AICS) ka zhvilluar trajnimet me pushtetin vendor duke planifikuar paraprakisht që nëpërmjet trajnimit do të bëhej ndërhyrje në bashkitë për të ndikuar hartimin e buxhetit me qasje gjinore. U zhvilluan 30 workshope dhe morën pjesë 317 nëpunës civil dhe 27 punonjës me Kod Pune. Në përfundim të këtyre trajnimeve u monitoruan bashkitë për ndikimin dhe reflektimin e trajnimit në projekt-buxhetet e tyre. Bashkëpunimi për këto trajnime do të vijojë edhe në vitin 2022.<br>(iii) ASPA në bashkëpunim me Programin e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës ROMACTED ka zhvilluar trajnimet me bashki të vendit me temë "Përkthimi i buxhetimit të përgjigjshëm për pakicat rome dhe egjiptiane dhe monitorimi dhe vlerësimi i planeve të veprimit në praktikë në nivelin vendor", ku moren pjesë 10 nga bashkitë e vendit duke planifikuar paraprakisht që nëpërmjet trajnimit do të bëhej ndërhyrje në bashkitë për të ndikuar hartimin e buxhetit me qasje rome dhe egjiptiane. Në këto trajnime morën pjesë 64 pjesëmarrës.<br>Impakti i planifikuar të trajnimit për mbështetjen e këtij procesi ka qenë pozitiv. |
| | | Nën-aktiviteti 6.8.2 | Vendosja e kontakteve dhe bashkëpunimi me agjenci profesionale në fushën e kontrollit të cilësisë për edukimin/trajnimin me qëllim ngritjen e një sistemi për menaxhimin dhe vlerësimin e cilësisë së trajnimeve. | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike | TM II 2018 | TM IV 2020 | (i) Hulumtim i kryer;<br>(ii)Anëtarësimi në dy rrjete ndërkombëtare. | ASPA po vijon hulumtimin për agjencitë partnere me të cilat mund të bashkëpunojë. Aktualisht ASPA ka në zbatim një dokument standartesh dhe ka miratuar Urdhrin nr. 125 datë 31.12.2018 "Për pilotimin e standardeve të kontrollit të cilësisë". Që prej Qershorit të vitit 2018 ASPA merr pjesë rregullisht në rrjetin zyrtar të shkollave të administratës publike të Bashkimit Evropian. |
| | | Nën-aktiviteti 6.8.3 | Zhvillimi i sistemeve dhe procedurave që plotësojnë standardet kombëtare/ndërkombëtare të kontrollit të cilësisë. | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike | TM II 2018 | TM IV 2020 | (i) Sigurimi i kontrollit të cilësisë së kurrikulave të trajnimit nëpërmjet sistemit të vlerësimit të kurrikulës (SVC);<br>(ii) Sistemi i kontrollit të cilësisë i përshtatur me standardet kombëtare/ndërkombëtare. | ASPA ka një sistem vlerësimi kurrikule që në vitin 2018. Është rishikuar "Udhëzuesi për hartimin /rishikimin e kurrikulave", dhe mbështetet në Metodologjinë për vlerësimin e kurrikulës dhe Urdhrin "Për procedurat standarte të punës".<br>Për të mundësuar dokumentin standard ndërkombëtar, ASPA po hulumton që të mundësohet blerja e dokumentit të standarteve ISO 21001:2018 "Educational organizations —Management systems for educational organizations — Requirements with guidance for use". ISO 21001: 2018 është një dokument i cili specifikon kërkesat për një sistem menaxhimi për organizatat kur organizata:<br>a) duhet të tregojë aftësinë për të mbështetur përvetësimin dhe zhvillimin e kompetencave përmes mësimdhënies/trajnimit, mësimit ose hulumtimit;<br>b) synon të rrisë kënaqësinë e pjesëmarrësve të trajnimeve/proceseve mësimdhënëse, përfituesve të tjerë dhe stafit përmes aplikimit efektiv të sistemit të menaxhimit të vet, përfshirë proceset për përmirësimin e sistemit dhe sigurimin e konformitetit me kërkesat e pjesëmarrësve të trajnimit dhe proceseve mësimdhënëse dhe përfituesve të tjerë. Megjithatë zbatimi i këtij dokumenti kërkon mbështetje me ekspertizë pasi baza ligjore nuk e mundëson shkollën që të kontraktojë këtë ekspertizë dhe me kapacitetet e veta nuk mund ta zhvillojë. |
| | | Nën-aktiviteti 6.8.4 | Zhvillimi i sistemeve që sigurojnë menaxhimin efektiv dhe eficent të burimeve nëpërmjet mirëpërdorimit të burimeve njerëzore të brendshme të ASPA-s dhe ofrimit të shërbimeve për të tretët. | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike | TM I 2018 | TM IV 2020 | (i) Numri i kurseve të trajnimit për institucione/pjesëmarrës jashtë shërbimit civil (me pagesë);<br>(ii) Numri i konsulencave me qëllim sigurimin e të ardhurave. | ASPA ka vijuar punën për këtë çështje dhe ka hartuar dokumentin e tarifimit. ASPA ka vijuar me përgatitjet për miratimin e këtij dokumenti nga Bordi. |
| | | Nën-aktiviteti 6.8.5 | Zhvillimi i një sistemi modern për menaxhimin e informacionit lidhur me nevojat për trajnim sipas kuadrit të SIMBNJ. | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike | TM I 2018 | TM IV 2020 | Sistemi modern i informacionit i krijuar. | ASPA ka marrë akseset e platformës për Training Need Assessment nga DAP. |
| | | Nën-aktiviteti 6.8.6 | Pasurimi dhe funksionimi i plotë i bibliotekës së ASPA (e-library). | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike | TM I 2018 | TM IV 2020 | Qendra e bibliotekës dixhitale e ngritur në ambjentet e ASPA-s plotësisht funksionale. | Platforma E-Library aksesohet përmes linkut e-library.aspa.gov.al dhe është bërë e mundur të kontrollohet databasa dhe informacionet që disponon platforma. |
| | | Nën-aktiviteti 6.8.7 | Analizimi i kuadrit aktual ligjor, evidentimi i nevojave dhe hartimi i propozimeve përkatëse për rishikimet ligjore. | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike | TM IV 2019 | TM IV 2020 | (i) Kuadri ligjor i analizuar;<br>(ii) Evidentimi i nevojave;<br>(iii) Propozimet për rishikime ligjore. | Ndryshime ligjore u miratuan me VKM nr.687, datë 18.11.2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.138, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Shkollës Shqiptare të Adminstratës Publike dhe trajnimin e nëpunësve civilë", të ndryshuar. |
| | | Nën-aktiviteti 6.8.8 | Analizimi i kapaciteteve institucionale të ASPA-s për evidentimin e nevojave dhe propozimet përkatëse në riorganizimin e strukturës për të mundësuar ushtrimin e plotë të misionit të institucionit si shkollë e administratës publike. | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike | TM I 2019 | TM IV 2019 | (i) Analiza e kapaciteteve institucionale;<br>(ii) Riorganizimi i strukturës. | Me Urdhrin e Kryeministrit nr. 106, datë 13.08.2020 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shkollës Shqiptare të Administratës Publike" u miratua struktura e re e ASPA. Në vijim, ASPA ndoqi procesin e transferimeve ku të gjithë punonjësit aktual u transferuan në pozicionet sipas strukturës së re. Në vijim, ASPA ndoqi procedurat e tjera për fillimin e procedurave të rekrutimit për pozicionet e reja të krijuara ku u shpallën pranë portalit dap.gov.al 12 pozicione vakante të ASPA-s dhe u rekrutuan 7 nëpunës civilë. |
| Objektivi 7: Organizimi i sistemit të pagave në shërbimin civil duke u bazuar në vlerësimin e vendit të punës, të arritjeve vjetore të nëpunësve civilë dhe rezultateve në trajnimet e detyrueshme | | | | | | | | |
| 7.1 | *Rishikimi dhe miratimi i strukturës së re të pagave* | Nën-aktiviteti 7.1.1 | Hartimi dhe miratimi i një dokumenti për politikat në sistemin e pagave dhe miratimi i strukturës së re të pagave. | Departamenti i Administratës Publike | TM IV 2018 | TM IV 2019 | Dokumenti i politikave dhe rekomandimet për pagat i hartuar. | Në lidhje me iniciativat për reformën e skemës së pagave, në vitin 2021, u përgatit dhe u finalizua dokumenti për politikën e pagave, në kuadër të Projektit IPA, si rezultat i një procesi intensiv pune të zhvilluar me asistencën e ngushtë të stafit drejtues të DAP dhe mbështetjen e ofruar nëpërmjet një grupi të dedikuar ekspertësh ndërkombëtarë dhe vendas. Dokumenti i politikës mbi skemën e re të pagave ofron analiza analitike të sistemit aktual të pagave, opsionet e shkallëve të reja të pagave si dhe mënyrën se si mund të zbatohet kjo skemë. Dokumenti i propozuar i politikës së pagave është përgatitur në përputhje me parimin "pagë e njëjtë për punë të njëjtë".<br>Për të kuptuar më mirë zbatimin e skemës së re të pagave, janë bërë simulime për zbatimin e këtij propozimi të ri për katër institucione. Megjithatë, ka nevojë që simulimet të zgjerohen më tej për të kuptuar më mirë kostot e përgjithshme konkrete. DAP po mban diskutime mbi dokumentin e politikës së pagave me partnerët ndërkombëtarë SIGMA/OECD për të mundësuar mbështetjen dhe ekspertizën e tyre për zbatimin e duhur të kësaj reforme. |
| | | Nën-aktiviteti 7.1.2 | Miratimi i vendimeve të reja për pagat dhe zbatimi i strukturës së re. | Departamenti i Administratës Publike | TM I 2020 | TM IV 2021 | Struktura e re e pagave e zbatuar. | Një plan i detajuar do të hartohet me mbështetje të ekspertizës dhe do ndiqet me përparësi për të mundësuar zbatimin e reformës së pagave. |
| | | Nën-aktiviteti 7.1.3 | Rishikimi i raporteve mes pagës maksimale dhe pagës minimale/mesatare në administratën publike, me qëllim ruajtjen e një piramide objektive të pagave dhe motivimin e pozicioneve drejtuese, si edhe diversifikimi i klasifikimit sipas përmbajtjes së punës. | Departamenti i Administratës Publike | TM I 2020 | TM IV 2021 | Raportet e pagës të rishikuara. | Në studimin analitik përcaktohet rruga për zbatimin e elementeve të rinj të sistemit të pagave të miratuar nga Ligji i Shërbimit Civil nr.152/2013. dhe janë parashturar propozimet për klasifikimin e pagave, me alternativat përkatëse. Diskutime dhe konsultime të mëtejshme po kryhen për të vendosur mbi qasjen më të mirë në drejtim të zbatimit të kësaj reform. |
| Objektivi 8: Procedura të thjeshtuara për ofrimin e shërbimeve, duke lehtësuar komunikimin me publikun dhe shmangur korrupsionin | | | | | | | | |
| 8.1 | *Ri-inxhinierimi i shërbimeve publike, si një masë e nevojshme për thjeshtimin e* | Nën-aktiviteti 8.1.1 | Lehtësimi i procedurave të marrjes së shërbimeve në sportel, nëpërmjet miratimit të akteve ligjore për reduktimin/ eliminimin | Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara | TM II 2018 | TM IV 2022 | Numri i akteve ligjore të miratuara për reduktimin e dokumenteve. | Aktivitet i realizuar plotësisht.<br>Në 6 mujorin e dytë të vitit 2021 ka vijuar procesi i invetarizimit të standardeve në institucionet shërbim ofruese. Gjatë periudhës raportuese u hartua një formular/pyetësor për inventarizimin e shërbimeve, i cili iu dërgua me email 119 institucioneve ndër të cilët:<br>• 95 institucione plotësuan formularin; |

## Plani i Aktiviteteve 2018-2022

| Nr. Aktivitetit | Detajimi i aktivitetit | Nr. i nën-aktivitetit | Detajimi i nën-aktivitetit | Institucioni raportues/përgjegjës | Data e fillimit | Data e mbarimit | Mënyra e matjes së realizimit | Ecuria e zbatimit të aktiviteteve Janar-Dhjetor 2021 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 8.2 | *Derregullimi, si masë për reduktimin drastik të dokumenteve të kërkuara nga qytetarët/bizneset dhe kalimin në një nivel të ri të modernizimit dhe dixhitalizimit të tyre* | Nën-aktiviteti 8.2.1 | Lehtësimi i procedurave të marrjes së shërbimeve nga biznesi dhe qytetarët, në institucionet e administratës publike, nëpërmjet shtimit të shërbimeve me vulë | Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit | TM I 2018 | TM IV 2020 (në vijim) | Numri i shërbimeve elektonike (nivel 4) me vulë dixhitale në portalin e-Albania. | Portali e-Albania mundëson shkarkimin e dokumenteve administrative me vlerë ligjore 24/7, duke i bërë këto dokumente të disponueshme në çdo orë të ditës dhe në çdo ditë të javës, pavarësisht orarit të hapjes së sporteleve shtetërore. Aktualisht në portalin e-Albania ofrohen 55 dokumente me vulë elektronike. |
| | | Nën-aktiviteti 8.2.2 | Modernizimi i shërbimeve publike nëpërmjet ofrimit të tyre elektronikisht në portalin qeveritar "e-albania" | Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit | TM I 2018 | TM IV 2020 (në vijim) | Numri i shërbimeve elektronike që ofrohen në portalin qeveritar e-albania. | Numri i shërbimeve elektronike që ofrohen në portalin qeveritar e-albania është 1209 shërbime elektronike. |
| 8.3 | *Krijimi i një mekanizmi që u mundëson qytetarëve të japin mendimin mbi cilësinë e shërbimeve elektronike në portalin e-albania* | Nën-aktiviteti 8.3.1 | Zbatimi i funksionalitetit të vlerësimit me yje të cilësisë së shërbimit për të gjitha shërbimet elektronike të portalit "e-albania". | Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit | TM I 2018 | TM IV 2020 (në vijim) | Numri i shërbimeve elektronike të pajisura me opsionin e vlerësimit me yje të cilësisë së shërbimit. | Numri i shërbimeve elektronike që ofrohen në portalin qeveritar e-albania është 1209 shërbime elektronike. |
| 8.4 | *Krijimi i kushteve dhe procedurave për zbatimin me transparencë dhe objektivitet të promovimit në karrierë në shërbimin civil* | Nën-aktiviteti 8.4.1 | Identifikimi në mënyrë periodike i nevojave për trajnim nëpërmjet organizimit të procesit të Analizës së Nevojave për Trajnim (ANT). | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike | TM I 2018 | TM IV 2020 | (i) Metodologjia e vlerësimit të nevojave e hartuar dhe e miratuar;<br>(ii) Vlerësimi i nevojave gjithëpërfshirëse për trajnim çdo 3 vjet;<br>(iii) Vlerësimi i nevojave specifike për trajnim çdo vit;<br>(iv) Raport përmbledhës i nevojave për trajnim. | Metodologjia e vlerësimit të nevojave per trajnim (VNT) është hartuar dhe miratuar. Vlerësimi i nevojave gjithëpërfshirëse për trajnim u zhvillua në vitin 2018 dhe vlerësimi i rradhës i nevojave u zhvillua në Dhjetor 2020. Përvec vlerësimit të përgjithshëm të nevojave, ASPA zhvillon edhe vlerësimin specifik të nevojave për trajnim. Në fund të vitit 2019 u është dërguar shkresë institucioneve për nevojat specifike për hartimin e kalendarit 2020, i cili është konsultuar edhe me Departamentin e Administratës Publike.<br>Në Dhjetor të vitit 2020 nisi procesi i vlerësimit të nevojave për periudhën 2021-2022. ASPA e zhvilloi këtë proces për pushtetin qendror në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, ndërkohë që zhvilloi edhe VNT për pushtetin vendor dhe institucionet e pavarura. ASPA zhvilloi vlerësimin e nevojave për trajnim në katër fusha për periudhën 2021-2020 : (i) vlerësim i përgjithshëm i nevojave për trajnim për të gjitha pushtetet; (ii) vlerësimin e nevojave për trajnim për drejtuesit dhe anëtarët e të gjitha grupeve ndër-institucionale të punës për Integrimin Evropian; (iii) vlerësimin e nevojave në fushën e antikorrupsionit dhe (iv) vlerësimin e nevojave për trajnim të njësive të vetëqeverisjes vendore për planifikimin dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor. Në përfundim të zhvillimit të këtij procesi të vlerësimit të nevojave janë hartuar raportet e përgjithshme dhe raportet individuale për çdo institucion dhe çdo GNPIE. |
| | | Nën-aktiviteti 8.4.2 | Ofrimi i një numri më të madh të trajnimeve në fushën e integrimit evropian në përputhje me hapjen e procesit të negociatave. | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike | TM I 2018 | TM IV 2020 | Rritja e përqindjes që zenë programet e trajnimit në fushën e Integrimit Evropian nga 30% në vitin 2018 në 50% në vitin 2020. | Në vitin 2018 ASPA ka ofruar 2 module në fushën e integrimit evropian, ndërsa në vitin 2020 ka ofruar 6 module duke i trefishuar modulet. Këto janë 6 module të hartuara me buxhetin e ASPA, ndërkohë që në bashkëpunim me projektin "Bashki për në Evropë" janë hartuar edhe 3 module në fushën e integrimit evropian specifikisht për pushetin lokal. ASPA ka trajnuar në fushën e integrimit evropian 2730 pjesëmarrës në vitin 2020, pra 78% më shumë se në vitin 2019 ku u trajnuan 1534 pjesëmarrës dhe 105% më shumë se në vitin 2018 gjatë të cilit u trajnuan 1332 pjesëmarrës. Gjatë vitit 2020 integrimi evropian është mbuluar me 6 module. Përvec këtyre moduleve, në kuadër të procesit të hapjes së negociatave janë zhvilluar trajnime specifike për anëtarët e grupeve ndërsektoriale të punës për integrimin evropian (GNPIE) për 6 kapituj të ACQUIS lidhur me Analizën e Mangësive Ligjore (Kapitulli 1 - Lëvizja e lirë e mallrave; Kapitulli 3 - E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbim; Kapitulli 20 - Ndërmarrjet dhe politikat industriale; Kapitulli 28 - Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit publik; Kapitulli 25 - Shkenca dhe kërkimi shkencor dhe Kapitulli 18 - Statistikat ) dhe për katër nga këto kapituj janë zhvilluar trajnime mbi Analizën e Mangësive Administrative dhe Institucionale. Gjithashtu, gjatë vitit 2020 u trajnuan në fushën e integrimit evropian në mënyrë të dedikuar edhe pjesëmarrës nga pushteti vendor. Në këtë fushë gjatë vitit 2021 ASPA ka zhvilluar 91 webinare, 4 trajnime në klasë dhe 2 Kurse online me çertifikim dhe në total kanë marrë pjesë 3597 pjesëmarrës nga të cilët 545 nga pushteti vendor. Gjithashtu, ASPA zhvillon për nëpunësit në periudhë prove në programin "Prezantim me administratën publike" trajnime në fushën e integrimit evropian, ku gjatë vitit 2021 janë trajnuar 1815 nëpunës. |
| | | Nën-aktiviteti 8.4.3 | Përditësimi dhe zhvillimi i kapaciteteve trajnuese të ekspertëve (trajnerëve). | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike | TM I 2018 | TM IV 2020 | (i) Bazë të dhënash tërësisht e pëditësuar;<br>(ii) Raporte vjetore nga baza e të dhënave;<br>(iii) Realizimi i të paktën 1 programi Trajnim Trajnerësh (ToT )në vit. | (i) Bazë të dhënash tërësisht e përditësuar për trajnerët, me të dhënat dhe raportet e vlerësimit.<br>(ii) Sa i përket përditësimit dhe zhvillimit të kapaciteteve trajnuese të ASPA, gjatë vitit 2021 janë zhvilluar Trajnime për Trajner (ToT) që lidhen drejtëpërdrejtë me trajnimin: (i) trajnim per trajnerë për zhvillimin e kapaciteteve të anëtarëve të Këshillit Konsultativ; (ii) trajnim për trajnerë për Integrity Plan/Risk Assessment; (iii) trajnim për trajnerë Mbi Qeverisjen e migracionit në Shqipëri (iv) trajnim për trajnerë për Standardet e kujdesit për qytetarin me në fokus personat me aftësi të kufizuara në ofrimin e shërbimeve publike. |
| | | Nën-aktiviteti 8.4.4 | Zbatimi i metodologjisë së hartuar nga ASPA për zhvillimin e vazhdueshëm profesional në institucionet e administratës shtetërore. | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike | TM III 2018 | TM IV 2021 | Modeli i zhvillimit i pilotuar në 50% të institucioneve. | Numri i individëve të trajnuar ka arritur 31.1% të numrit të individëve të vitit 2020. Konkretisht në vitin 2021, ASPA ka trajnuar 6728 individë krahasuar më vitin 2020 gjatë të cilit ka trajnuar 4630 individë.<br>Është rritur numri i pjesëmarrsve, 16 719 pjesëmarrës më shumë se vitit 2020. Konkretisht gjatë përiudhës vitit 2021 ASPA, ka trajnuar 36825 pjesëmarrës krahasur më vitin 2020 gjatë të cilit ka trajnuar 20 106 pjesëmarrës.<br>Është rritur numri i webinareve, 178 webinare më shumë se viti 2020. Konkretisht gjatë vitit 2021 ASPA, ka zhvilluar 457 webinare krahasuar me vitin 2020 gjatë të cilit ka zhvilluar 279 webinare.<br>Është rritur numri i pjesëmarrësve në trajnimin "Prezantimi me Administratën Publike" me 9861 pjesëmarrës më shumë se viti 2020. Gjatë vitit 2021 ASPA, ka trajnuar 15 259 pjesëmarrës krahasuar më vitin 2020 gjatë të cilit ka trajnuar 5398 pjesëmarrës.<br>Është rritur numri i individëve të certifikuar në trajnimin "Prezantimi me Administratën Publike" më 68.4%. Gjatë vitit 2021 ASPA, ka certifikuar 1792 krahasuar më vitin 2020 gjatë të cilit ka certifikuar 565 individë.<br>Është rritur numri i pjesëmarrësve nga pushteti qendror me 9630 pjesëmarrës më shumë se vitit 2020. Gjatë vitit 2021 ASPA, ka trajnuar 21121 pjesëmarrës nga pushteti qendror, krahasuar më vitin 2020 gjatë të cilit ka trajnuar 11491 pjesëmarrës.<br>Numri i pjesëmarrësve të trajnuar nga pushteti vendor është rritur me 3681 pjesëmarrës më shumë se vitit 2020. Gjatë vitit 2021 ASPA, ka trajnuar 9811 pjesëmarrës krahasuar me vitin 2020 gjatë të cilit ka trajnuar 6130 pjesëmarrës nga pushteti vendor.<br>Është rritur numri i pjesëmarrësve nga institucionet e pavarura më 3609 pjesëmarrës më shumë se vitit 2020. Gjatë vitit 2021 ASPA, ka trajnuar 5686 pjesëmarrës për institucionet e pavarura, krahasuar me vitin 2020 gjatë të cilit ka trajnuar 2077 pjesëmarrës.<br>Gjatë vitin 2021 ASPA, ka trajnuar 207 pjësëmarrës nga kategori të tjera krahasuar më vitin 2020 gjatë të cilit ka trajnuar 408 pjesëmarrës. |
| | | Nën-aktiviteti 8.4.5 | Zhvillimi i planeve vjetore për trajnimin e drejtuesve të nivelit të mesëm dhe të lartë – bazuar në ofertën e trajnimit për TND. | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike | TM II 2018 | TM IV 2020 | (i) Plani vjetor i trajnimit për menaxherët e nivelit të lartë i hartuar dhe miratuar;<br>(ii) Numri i kurseve të trajnimit të zhvilluara;<br>(iii) Niveli i kënaqshmërisë të pjesëmarrësve të kursit 80%. | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike përfundoi pilotimin e programit të trajnimit për kalimin nga Trupa e Nivelit të Lartë Drejtues. Sipas kërkesës së Departamentit të Administratës Publike ky program u pilotua me anëtarë ekzistues të Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues dhe do të jetë i detyrueshëm për frekuentim në masën 70%.<br>Programi i trajnimit vijoi duke respektuar modulet dhe orët e trajnimit të parashikuara në fillim të tij. Pas masave dhe punës intensive të zhvilluar për përdorimin e platformave online dhe përshtatjen e programit online, trajnimet rifilluan në datën 12 Maj 2020 në platformën online "Go To Meeting" të ASPA.<br>Kohëzgjatja e parashikuar për modulet është ruajtur duke e përshtatur në trajnime online. Një modul i parashikuar 3 orë trajnimi në klasë, zhvillohet në dy webinare nga 90 minuta. Përveç moduleve të parashikuara në program, këtij target grupi iu ofrua edhe trajnimi "Statistika si mjet për të ndihmuar vendimmarrjen dhe për të argumentuar vendimet e marra" në datë 18 Qershor 2020. Sesionet e trajnimit kanë përfunduar me sukses në Tetor të vitit 2020. Ky program u zhvillua sërish në vitin 2021 për pjesëmarrësit që nuk patën mundësi ta ndiqnin herën e parë dhe u mbyll me sukses në Nëntor të vitit 2021. Pjesëmarrësit realizuan webinare që kishin në fokus lidershipin për sektor. |
| | | Nën-aktiviteti 8.4.6 | Vlerësimi i qasjeve alternative në lidhje me trajnimin e drejtuesve duke përfshirë edhe qasjen e bazuar tek kompetenca dhe pilotimi i saj në institucione të | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike | TM II 2018 | TM IV 2020 | (i) Qasja e trajnimit e përcaktuar dhe e pilotuar brenda TM II 2019;<br>(ii) Raporti i vlerësimit mbi qasjet alternative i hartuar. | Programi i Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues i ofruar për Trupën aktuale ekzistuese ka qasje kompetence. Ky Program ka nisur në Tetor të vitit 2019 dhe ka përfunduar me sukses në Tetor të vitit 2020. Ky program u zhvillua sërish në vitin 2021 për pjesëmarrësit që nuk patën mundësi ta ndiqnin herën e parë dhe u mbyll me sukses në Nëntor të vitit 2021. |
| | | Nën-aktiviteti 8.4.7 | Rritja e numrit të moduleve të trajnimeve të realizuara nëpërmjet platformës e-learning. | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike | TM I 2018 | TM IV 2020 | 30% e trajnimeve realizohen nëpërmjet kësaj platforme. | ASPA nga muaji Prill 2020 ofron shërbimin e-learning nëpërmjet platformave Gotowebinar, Gotomeeting, Zoom. Gjithashtu, ASPA zhvillon kurse online dhe webinare nëpërmjet platformave online. Me mbështetjen e projektit IPA 2014 u hartua metodologjia për hartimin e kurrikulës e-learning. |
| **Objektivi 9: Zhvillimi i një infrastrukture TIK të aftë për të mbështetur veprimtaritë e përditshme të administratës publike dhe rritjen e efiçensës duke ulur kohën për të aksesuar, përpunuar dhe transmetuar informacionin ndërsa përmirësohet rrjedha e informacionit** | | | | | | | | |
| 9.1 | *Diversifikimi i kanaleve të ofrimit të shërbimeve elektronike të portalit qeveritar e-albania* | Nën-aktiviteti 9.1.1 | Shtimi i entiteteve që ofrojnë shërbimet elektronike të portalit "e-albania". | Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit | TM II 2018 | TM IV 2020 (e në vijim) | Numri i entiteteve që ofrojnë shërbimet elektronike të portalit e-albania. | Aktualisht janë 76 institucione që ofrojnë shërbime elektronike për qytetarët, bizneset dhe nëpunesit e administratës publike duke lehtësuar ndjeshëm burokracitë, përmirësuar cilësinë dhe transparencën e ofrimit të shërbimeve publike. |
| 9.2 | *Dixhitalizimi i regjistrave themeltarë, interoperabiliteti dhe ngritja e sistemeve të reja IT* | Nën-aktiviteti 9.2.1 | Vijimi i procesit të dixhitalizimit të regjistrave themeltarë të institucioneve të qeverisjes qendrore. | Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit | TM I 2019 | TM IV 2020 (e në vijim) | Numri i regjistrave të dixhitalizuar (*TBD numri i regjistrave sipas viteve per t'u përcaktuar). | 1 (skanim dhe indeksim i regjistrave fizike) |
| | | Nën-aktiviteti 9.2.2 | Shtimi i sistemeve të institucioneve të lidhura në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit, për të: (i)mundësuar komunikimin në kohë reale me njëra-tjetrën, (ii) lehtësuar aplikimet online si dhe (iii) reduktuar dokumentet | Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit | TM IV 2018 | TM IV 2020 (e në vijim) | Numri i institucioneve të lidhura në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit. | Në total janë 55 institucione të lidhura në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit. |
| | | Nën-aktiviteti 9.2.3 | Zhvillimi i sistemeve të reja të institucioneve që nuk kanë sistem të brendshëm përpunimi të aplikimeve dhe dosjeve me të dhënat e qytetarëve (sistemet *backend*). Zhvillimi i sistemeve të përpunimit të aplikimeve dhe dosjeve me të dhënat e qytetarëve (sistemet backend), për institucionet ku këto sisteme | Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit | TM I 2019 | TM IV 2020 (e në vijim) | Numri i sistemeve të reja *back-end* të zhvilluara. | Numri i sistemeve të reja back-end të zhvilluara gjatë vitit 2021 është 4 sisteme te reja elektronike për institucionet e administratës shtetërore. |

## Plani i Aktiviteteve 2018-2022

| Nr. Aktivitetit | Detajimi i aktivitetit | Nr. i nën-aktivitetit | Detajimi i nën-aktivitetit | Institucioni raportues/përgjegjës | | Data e fillimit | Data e mbarimit | Mënyra e matjes së realizimit | Ecuria e zbatimit të aktiviteteve Janar-Dhjetor 2021 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | *angazhimit dhe motivimit të punonjësve publikë* | Nën-aktiviteti 10.1.2 | Aplikimi i instrumenteve të rinj për të përmirësuar kulturën organizative në institucionet shtetërore. | Departamenti i Administratës Publike | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike/Ministritë e linjës | TM III 2018 | TM IV 2021 | Numri i punonjësve të cilët marrin trajnime specifike (*coaching*, *mentoring*, etj). | ASPA në kurset online me çertifikim mundëson edhe sesionet individuale coaching të çdo pjesëmarrësi, duke mundësuar një hapësirë të dedikuar për çdo pjesëmarrës për t'i mundësuar sesion individual me trajnerin për diksutim të çështjeve të ndryshme, prezantim të detyrës së kursit dhe kontroll të njohurive.<br><br>DAP në bashkëpunim me projektin IPA 2014 "Zbatimi i Reformës së Shërbimit Civil në Administratën Publike" zhvilluan online në datat 1 dhe 2 Korrik, 5 seanca trajnimi posaçërisht për dy platformat Regjistri Qendror i Personelit (HRMIS) dhe "administrata.al". Mbi 130 pjesëmarrës nga administrata publike morën pjesë në trajnim, ku diskutuan rreth funksionalitetit të sistemit të HRMIS, përgjegjësive të punonjësve që punojnë me këtë sistem, kurset online nëpërmjet platformës LMS etj, e-learning softëare për menaxhimin e kurseve online, i cili bën të mundur procesin e të mësuarit në distancë nëpërmjet një numri të palimituar kursesh online lehtësisht të përdorshme etj. Në muajin Korrik, DAP në bashkëpunim me projektin IPA "Zbatimi i reformës së shërbimit civil në administratën publike" përfunduan me sukses turin e takimeve rajonale me trajnimet dedikuar prezantimit të manualeve dhe udhëzuesve të përgatitura posaçërisht për proceset që lidhen me menaxhimin e burimeve njerëzore, vlerësimin e performancës, vlerësimin e pozicioneve të punës, procedurat administrative dhe organizimin e brendshëm dhe strukturave të institucionit. Këto takime rajonale u zhvilluan me të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore. Në muajin Shtator, Departamenti i Administratës Publike në bashkëpunim me ekipin e projektit IPA 2014 prezantoi modulin elektronik për kryerjen e vlerësimit të performancës së nëpunësve civilë nëpërmjet platformës së integruar "administrata.al". Për të shpjeguar këtë instrument shumë të rëndësishëm për administratën publike, u organizua trajnimi dyditor me pjesëmarrjen e nëpunësve të burimeve njerëzore të ministrive të linjës. Moduli lehtëson, unifikon dhe digjitalizon procesin e vlerësimit të performancës për nëpunësit civilë. Gjithashtu, në muajin Shtator, përfaqësues të burimeve njerëzore të ministrive publike u njohën me udhëzuesin për analizën funksionale të institucioneve publike. Rishikimi funksional i sistemeve dhe ndërtimi i strukturave e organikave të institucioneve, dy nga proceset më të rëndësishme në punën e burimeve njerëzore, janë tashmë pjesë e këtij udhëzuesi. DAP bashkë me ekipin e projektit IPA 2014, prezantuan në muajin Shtator setin e të indikatorëve që do të raportohen elektronikisht nëpërmjet platformës "adminstrata.al" nga institucionet e administratës qendrore dhe vendore. Indikatorët përfshijnë: rekrutimin, zhvillimin e karrierës, vlerësimin e performancës, mobilitetin, zbatimin e vendimeve gjyqësore, trajnimin dhe balancën gjinore. Në prezantimin e indikatorëve për monitorimin dhe vlerësimin morën pjesë përfaqësues të burimeve njerëzore nga institucionet e administratës qendrore dhe vendore. |
| | | Nën-aktiviteti 10.1.3 | Zbatimi i programit "*Young Civil Servant Scholarship Scheme*" dhe qëndrueshmëria e kësaj praktike. | Departamenti i Administratës Publike | Kryeministria/Shkolla Shqiptare e Administratës Publike /Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme | TM IV 2020 | TM IV 2022 | Numri i nëpunësve pjesëmarrës në skemë. | Departamenti i Administratës Publike ka përgatitur Guideline për programin "Ndërtimi i kapaciteteve për nënpunësit civilë të Administratës Publike, përfshirë trajnimet / praktikat në administratat e Shteteve Anëtare të BE-së dhe skemën e bursave (" qelizat e reja ")" financuar nga programi kombëtar IPA 2020. Granti është në fazë vlerësimi. |
| **Objektivi 11: Rritja e kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike për garantimin e të drejtave të qytetarëve dhe aksesi në informacion.** | | | | | | | | | |
| 11.1 | *Vënia në zbatim e programit institucional të transparencës nga autoritetet publike* | Nën-aktiviteti 11.1.1 | Plotësimi me programet e transparencës për të gjitha institucionet e administratës qendrore. | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale | | TM I 2018 | TM IV 2022 | Numri i institucioneve qendrore me programe transparence të miratuara. | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në mbështetje të gërmës "c" të nenit 4 dhe neneve 5 e 6 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", miratoi Urdhrin nr. 187 "Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar", i ndryshuar dhe Urdhrin nr. 188, datë 18.12.2020 "Për miratimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve të Rishikuar", i ndryshuar duke miratuar kështu modelet e reja të Programit të Transparencës dhe Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve.<br>Afati për Autoritetet Publike për publikimin e këtyre formateve të rishikuara u parashikua data 30 qershor 2021. Në bazë të këtyre urdhërave, ngarkohen të gjitha autoritetet publike të zbatojnë Programin e Transparencës të Rishikuar dhe Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve të rishikuar me përjashtim të njësive të vetëqeverisjes vendore.<br>Në përfundim të afatit të vendosur për zbatimin e Programit të Transparencës së Rishikuar, Zyra e Komisionerit, ka monitoruar 313 autoritete publike duke konstatuar dhe verifikuar vështirësitë dhe pengesat e tyre në realizimin e këtij deyrimi ligjor.  Në përfundim të monitorimit një vjeçar, Zyra e Komisionerit konstatoi se në përfundim të vitit 2021 nga 313 autoritete publike qendrore dhe të varësisë 242 prej tyre kanë publikuar Programin e Transparencës sipas urdhrit të sipërcituar, 230 kanë publikuar të dhënat e koordinatorit për të drejtën e Informimit dhe 169 kanë publikuar të dhënat e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve të përditësuar për vitin 2021. |
| | | Nën-aktiviteti 11.1.2 | Hartimi i programeve model të transparencës për pushtetin vendor. | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale | | TM II 2018 | TM I 2019 | Botimi i Programit Model të Transparencës në Fletoren Zyrtare. | Aktivitet i realizuar. |
| | | Nën-aktiviteti 11.1.3 | Trajnimi i 61 koordinatorëve të së drejtës për informim në pushtetin vendor. | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale | | TM I 2019 | TM IV 2019 | 61 koordinatorë të trajnuar. | Aktivitet i realizuar. |
| | | Nën-aktiviteti 11.1.4 | Të gjitha bashkitë miratojnë dhe zbatojnë programet e transparencës. | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale | | TM I 2019 | TM IV 2022 | Numri i bashkive me programe transparence të miratuara/61 bashki në total. | Zyra e Komisionerit, në vazhdimësi ka monitoruar edhe Programin model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Gjatë kësaj periudhe janë monitoruar 61 Njësi të Vetëqeverisjes Vendore si dhe është ushtruar hetim administrativ në 20 prej tyre. Për këtë qëllim Zyra e Komisionerit ka zhvilluar dhe një seancë dëgjimore me Kryetarët e Bashkive mbi detyrimin për zbatimin e Programit model  të Transparencës për Njësive të Vetëqeverisjes Vendore. Gjatë vitit 2021, Zyra e Komisionerit ka dalë me 36 rekomandime dhe 1 vendim urdhërimi për moszbatim të Programit model të Transparencës. Në përfundim të monitorimit një vjecar, Zyra e Komisionerit konstatoi se në përfundim të vitit 2021 nga 61 njësi të vetëqeverisjes vendore 58 prej tyre e kanë implementuar programin e transparencës ndërsa 3 njësi rezultojnë se nuk kanë faqe interneti aktive. Gjithashtu 56 njësi të vetëqeverisjes vendore kanë publikuar të dhënat e koordinatorit për të drejtën e Informimit dhe 48 kanë publikuar të dhënat e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve të përditësuar për vitin 2021. |
| 11.2 | *Përdorimi i mjeteve TIK për të rritur transparencën e veprimtarisë së administratës* | Nën-aktiviteti 11.2.1 | Vënia në funksion të plotë i regjistrit qendror të kërkesave dhe përgjigjeve. | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale | | Në proces (nisur në 2017) | TM IV 2022 | Regjistri qendror i kërkesave dhe përgjigjeve në funksion të plotë. | Bazuar në nenin 8 të ligjit për të drejtën e informimit, Zyra e Komisionerit ka ngritur REKPDI, i cili është një sistem të dhënash që i ofron mundësinë çdo qytetari të dërgojë në mënyrë elektronike kërkesat për informacion pranë autoriteteve publike, si dhe ankesat në rast refuzimi të informacionit tek Zyra e Komisionerit. Qëllimi i instalimit të këtij sistemi është lehtësimi i aksesit të qytetarëve/grupeve të interesit për informacion publik, si dhe rritjen e cilësisë së shërbimit për të mundësuar marrjen e informacionit publik në një kohë sa më të shpejtë. Me anë të këtij sistemi mund të gjurmohet statusi i kërkesës, si dhe mund të informohet kërkuesi me e-mail në momentin që kërkesa është shqyrtuar, pra garanton monitorimin në kohë reale të depozitimit dhe trajtimit të kërkesave/ankesave për informacion/dokumentacion publik.<br>Me anë të shkresës nr. 1046 prot., datë 08.06.2021, me qëllim zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ligji për të drejtën e informimit, Zyra e Komisionerit ka vijuar komunikimin për ndërgjegjësimin e 53 autoriteteve publike për marrjen e masave për instalimin brenda muajit korrik të REKPDI. Instalimi i këtij regjistri është gjithashtu dhe pjesë e Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2019-2023, ku për vitin 2021 është parashikuar instalimi i tij në 24 autoritete publike si dhe e Kontratës së Suportit Buxhetor 2020 për Mirëqeverisjen, ku për vitin 2021, do duhet që të rritej me 35 numri i autoriteteve publike që kanë instaluar këtë regjistër krahasuar me një vit më parë.<br>Deri në datë 15 dhjetor 2021, kanë instaluar REKPDI,  36 Autoritete Publike të tjera, duke e çuar në 95 numrin total të tyre. |
| | | Nën-aktiviteti 11.2.2 | Trajnimi i koordinatorëve për të drejtën e informimit lidhur me përdorimin e regjistrit qendror të kërkesave dhe përgjigjeve. | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale | | TM IV 2020 | TM IV 2022 | Të gjithë koordinatorët të trajnuar. | Janë trajnuar koordinatorët dhe stafi IT për 36 insitucioneve të reja ku është instaluar aktualisht regjistri. Gjithashtu, është vazhduar me trajnimin e koordinatorëve të rinj të caktuar rishtazi pranë autoriteteve publike. |
| 11.3 | *Rishikimi i zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit me synim përmirësimin e: a)përmbajtjes dhe metodës së zbatimit të programeve të transparencës; b) mekanizmave të përgjegjësisë administrative; dhe c) rritjen e publikimit proaktiv të informacionit* | Nën-aktiviteti 11.3.1 | Vlerësim të plotë ex-post të Ligjit për të Drejtën e Informimit. | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale | | TM I 2019 | TM II 2020 | Raporti i vlerësimit i përgatitur. | Gjatë këtyre viteve të zbatimit të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe praktikave të mbledhura nga Zyra e Komisionerit, janë evidentuar disa raste për të cilat legjislacioni aktual nuk ofron zgjidhje. Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit, me mbështetjen e projektit të binjakëzimit antikorrupsion si dhe me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri ka vazhduar punën per përgatitjen e ndryshimeve të nevojshme ligjore.<br>Me anë të shkresës nr.1962 datë 29.12.2021 është dërguar pranë Ministrisë së Drejtësisë drafti i projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" sëbashku me relacionin përkatës dhe Relacionin Shoqërues të Vlerësimit (RIA) për të vijuar me procedurat e mëtejshme ligjore deri në miratimin e tij. Projektligji për ndryshimin e ligjjit për të drejtën e informimit eshte pjesë e paketës për harmonizimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale me GDPR dhe Direktivën e Policisë, për arsye se kompetencat e Komisionerit edhe për të drejtën për informim, janë të parashikuara në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, ndaj këto dy projektligje do të kalojnë paketë në të njëjtën kohë. |
| 11.4 | *Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore të KDIMDP për monitorimin e ligjit për të drejtën e informimit* | Nën-aktiviteti 11.4.1 | Rishikimi i strukturës së KDIMDP me synimin forcimin e kapaciteteve monitoruese për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit. | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale | | TM II 2018 | TM IV 2018 | (i) Struktura e miratuar;<br>(ii) Numri i punonjësve të shtuar. | Aktiviet i realizuar. |
| | | Nën-aktiviteti 11.4.2 | Trajnime për forcim kapacitetesh në fushën e të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale. | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale | | TM II 2018 | TM IV 2022 | (i) Numri i personave të trajnuar;<br>(ii) Numri  i kurseve të trajnimit. | Në lidhje me trajnimet në fushën e të drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale janë zhvilluar 5 trajnime online me koordinatorët për të drejtën e informimit dhe përfaqësues së autoriteteve publike për trajnimin e tyre mbi implementimin e Programeve të Transparencës të Rishikuar (Autoritete Publike Qendrore, Autoritete Publike të Varësisë, Autoritete të Pavarura, Gjykatat, Prokuroria e Përgjithshme). Në këto trajnime janë trajnuar 200 persona . Gjithashtu, janë zhvilluar 2 trajnime të personelit dhe institucioneve partnere të Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit te Dhunshëm me temë "E drejta e informimit dhe mbrojtja e të dhënave personale në raport me çështjet e P/CVE-së – standardi bazë ligjor dhe rastet e kufizimeve të tyre".  Në këto trajnime janë trajnuar 30 persona.<br>ASPA në vitin 2021 zhvilloi kursin online "E drejta e informimit dhe mbrojtja e të dhënave personale" në të cilin u çertifikuan 22 nëpunës. ASPA ka zhvilluar në këtë fushë webinare në të cilin kanë marrë pjesë 1206 pjesëmarrës gjatë vitit 2021. (informacion i ardhur nga ASPA)<br>Gjatë vitit 2021, Zyra e Komisionerit ka zhvilluar një sërë trajnimesh tematike dhe sektoriale  me koordinatorët për të drejtën e informimit dhe përfaqësues së autoriteteve publike. Në këto trajnime janë trajnuar 400 persona. |

## Plani i Aktiviteteve 2018-2022

| Nr. Aktivitet | Detajimi i aktivitetit | Nr. i nën-aktivitetit | Detajimi i nën-aktivitetit | Institucioni raportues/përgjegjës | | Data e fillimit | Data e mbarimit | Mënyra e matjes së realizimit | Ecuria e zbatimit të aktiviteteve Janar-Dhjetor 2021 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 10.1 | *Aplikimi i metodave të reja për rritjen e eficencës, përgjegjshmërisë, angazhimit dhe motivimit të punonjësve publikë* | Nën-aktiviteti 10.1.1 | Trajnimi i administratës publike për zbatimin e kodit të procedurave administrative sipas kurrikulës së ASPA | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike | Ministritë e Linjës/Njësitë e Qeverisjes Vendore | TM II 2018 | TM IV 2020 | Numri i nëpunësve të trajnuar. | Aktivitet i realizuar.<br>Megjithatë, trajnimet e administratës publike në fushën e të drejtës administrative vijojnë të zhvillohen. Gjatë vitit 2021, ASPA ka trajnuar 3468 pjesëmarrës në fushën e të drejtës administrative, nga të cilët 2585 pjesëmarrës janë trajnuar specifikisht për Kodin e Procedurave Administrative. |
| | | Nën-aktiviteti 10.1.2 | Aplikimi i instrumenteve të rinj për të përmirësuar kulturën organizative në | Departamenti i Administratës Publike | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike/Ministritë | TM III 2018 | TM IV 2021 | Numri i punonjësve të cilët marrin trajnime specifike (*coaching, mentoring*, etj). | ASPA në kurset online me çertifikim mundëson edhe sesionet individuale coaching të çdo pjesëmarrësi, duke mundësuar një hapësirë të dedikuar për çdo pjesëmarrës për t'i mundësuar sesion individual me trajnerin për diksutim të çështjeve të ndryshme, prezantim të detyrës së kursit dhe kontroll të njohurive.<br>1. Program trajnimi për kuadrin ligjor të Shërbimit Civil përmes metodave novatore të të mësuarit: |
| | | Nën-aktiviteti 10.1.3 | Zbatimi i programit "*Young Civil Servant Scholarship Scheme*" dhe qëndrueshmëria e kësaj praktike. | Departamenti i Administratës Publike | Kryeministria/Shkolla Shqiptare e Administratës Publike /Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme | TM IV 2020 | TM IV 2022 | Numri i nëpunësve pjesëmarrës në skemë. | Departamenti i Administratës Publike ka përgatitur Guideline për programin "Ndërtimi i kapaciteteve për nënpunësit civilë të Administratës Publike, përfshirë trajnimet / praktikat në administratat e Shteteve Anëtare të BE-së dhe skemën e bursave (" qelizat e reja ")" financuar nga programi kombëtar IPA 2020. Granti është në fazë vlerësimi. |
| **Objektivi 11: Rritja e kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike për garantimin e të drejtave të qytetarëve dhe aksesi në informacion.** | | | | | | | | | |
| 11.1 | *Vënia në zbatim e programit institucional të transparencës nga autoritetet publike* | Nën-aktiviteti 11.1.1 | Plotësimi me programet e transparencës për të gjitha institucionet e administratës qendrore. | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale | | TM I 2018 | TM IV 2022 | Numri i institucioneve qendrore me programe transparence të miratuara. | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në mbështetje të gërmës "c" të nenit 4 dhe neneve 5 e 6 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", miratoi Urdhrin nr. 187 "Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar", i ndryshuar dhe Urdhrin nr. 188, datë 18.12.2020 "Për miratimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve të Rishikuar", i ndryshuar duke miratuar kështu modelet e reja të Programit të Transparencës dhe Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve.<br>Afati për Autoritetet Publike për publikimin e këtyre formateve të rishikuara u parashikua data 30 qershor 2021. Në bazë të këtyre urdhërave, ngarkohen të gjitha autoritetet publike të zbatojnë Programin e Transparencës të Rishikuar dhe Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve të rishikuar me përjashtim të njësive të vetëqeverisjes vendore.<br>Në përfundim të afatit të vendosur për zbatimin e Programit të Transparencës së Rishikuar, Zyra e Komisionerit, ka monitoruar 313 autoritete publike duke konstatuar dhe verifikuar vështirësitë dhe pengesat e tyre në realizimin e këtij deyrimi ligjor. Në përfundim të monitorimit një vjeçar, Zyra e Komisionerit konstatoi se në përfundim të vitit 2021 nga 313 autoritete publike qendrore dhe të varësisë 242 prej tyre kanë publikuar Programin e Transparencës sipas urdhrit të sipërcituar, 230 kanë publikuar të dhënat e koordinatorit për të drejtën e Informimit dhe 169 kanë publikuar të dhënat e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve të përditësuar për vitin 2021. |
| | | Nën-aktiviteti 11.1.2 | Hartimi i programeve model të transparencës për pushtetin vendor. | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale | | TM II 2018 | TM I 2019 | Botimi i Programit Model të Transparencës në Fletoren Zyrtare. | Aktivitet i realizuar. |
| | | Nën-aktiviteti 11.1.3 | Trajnimi i 61 koordinatorëve të së drejtës për informim në pushtetin vendor. | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale | | TM I 2019 | TM IV 2019 | 61 koordinatorë të trajnuar. | Aktivitet i realizuar. |
| | | Nën-aktiviteti 11.1.4 | Të gjitha bashkitë miratojnë dhe zbatojnë programet e transparencës. | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale | | TM I 2019 | TM IV 2022 | Numri i bashkive me programe transparence të miratuara/61 bashki në total. | Zyra e Komisionerit, në vazhdimësi ka monitoruar edhe Programin model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore. Gjatë kësaj periudhe janë monitoruar 61 Njësi të Vetëqeverisjes Vendore si dhe është ushtruar hetim administrativ në 20 prej tyre. Për këtë qëllim Zyra e Komisionerit ka zhvilluar dhe një seancë dëgjimore me Kryetarët e Bashkive mbi detyrimin për zbatimin e Programit model të Transparencës për Njësive të Vetëqeverisjes Vendore. Gjatë vitit 2021, Zyra e Komisionerit ka dalë me 36 rekomandime dhe 1 vendim urdhërimi për moszbatim të Programit model të Transparencës. Në përfundim të monitorimit një vjecar, Zyra e Komisionerit konstatoi se në përfundim të vitit 2021 nga 61 njësi të vetëqeverisjes vendore 58 prej tyre e kanë implementuar programin e transparencës ndërsa 3 njësi rezultojnë se nuk kanë faqe interneti aktive. Gjithashtu 56 njësi të vetëqeverisjes vendore kanë publikuar të dhënat e koordinatorit për të drejtën e Informimit dhe 48 kanë publikuar të dhënat e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve të përditësuar për vitin 2021. |
| 11.2 | *Përdorimi i mjeteve TIK për të rritur transparencën e veprimtarisë së administratës* | Nën-aktiviteti 11.2.1 | Vënia në funksion të plotë i regjistrit qendror të kërkesave dhe përgjigjeve. | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale | | Në proces (nisur në 2017) | TM IV 2022 | Regjistri qendror i kërkesave dhe përgjigjeve në funksion të plotë. | Bazuar në nenin 8 të ligjit për të drejtën e informimit, Zyra e Komisionerit ka ngritur REKPDI, i cili është një sistem të dhënash që i ofron mundësinë çdo qytetari të dërgojë në mënyrë elektronike kërkesat për informacion pranë autoriteteve publike, si dhe ankesat në rast refuzimi të informacionit tek Zyra e Komisionerit. Qëllimi i instalimit të këtij sistemi është lehtësimi i aksesit të qytetarëve/grupeve të interesit për informacion publik, si dhe rritjen e cilësisë së shërbimit për të mundësuar marrjen e informacionit publik në një kohë sa më të shpejtë. Me anë të këtij sistemi mund të gjurmohet statusi i kërkesës, si dhe mund të informohet kërkuesi me e-mail në momentin që kërkesa është shqyrtuar, pra garanton monitorimin në kohë reale të depozitimit dhe trajtimit të kërkesave/ankesave për informacion/dokumentacion publik.<br>Me anë të shkresës nr. 1046 prot., datë 08.06.2021, me qëllim zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ligji për të drejtën e informimit, Zyra e Komisionerit ka vijuar komunikimin për ndërgjegjësimin e 53 autoriteteve publike për marrjen e masave për instalimin brenda muajit korrik të REKPDI. Instalimi i këtij regjistri është gjithashtu dhe pjesë e Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2019-2023, ku për vitin 2021 është parashikuar instalimi i tij në 24 autoritete publike si dhe e Kontratës së Suportit Buxhetor 2020 për Mirëqeverisjen, ku për vitin 2021, do duhet që të rritej me 35 numri i autoriteteve publike që kanë instaluar këtë regjistër krahasuar me një vit më parë.<br>Deri në datë 15 dhjetor 2021, kanë instaluar REKPDI, 36 Autoritete Publike të tjera, duke e çuar në 95 numrin total të tyre. |
| | | Nën-aktiviteti 11.2.2 | Trajnimi i koordinatorëve për të drejtën e informimit lidhur me përdorimin e regjistrit qendror të kërkesave dhe përgjigjeve | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale | | TM IV 2020 | TM IV 2022 | Të gjthë koordinatorët të trajnuar. | Janë trajnuar koordinatorët dhe stafi IT për 36 insitucioneve të reja ku është instaluar aktualisht regjistri. Gjithashtu, është vazhduar me trajnimin e koordinatorëve të rinj të caktuar rishtazi pranë autoriteteve publike. |
| 11.3 | *Rishikimi i zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit me synim përmirësimin e: a)përmbajtjes dhe metodës së zbatimit të programeve të transparencës; b) mekanizmave të përgjegjësisë administrative; dhe c) rritjen e publikimit proaktiv të informacionit publik* | Nën-aktiviteti 11.3.1 | Vlerësim të plotë ex-post të Ligjit për të Drejtën e Informimit. | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale | | TM I 2019 | TM II 2020 | Raporti i vlerësimit i përgatitur. | Gjatë këtyre viteve të zbatimit të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe praktikave të mbledhura nga Zyra e Komisionerit, janë evidentuar disa raste për të cilat legjislacioni aktual nuk ofron zgjidhje. Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit, me mbështetjen e projektit të binjakëzimit antikorrupsion si dhe me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri ka vazhduar punën per përgatitjen e ndryshimeve të nevojshme ligjore.<br>Me anë të shkresës nr.1962 datë 29.12.2021 është dërguar pranë Ministrisë së Drejtësisë drafti i projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" sëbashku me relacionin përkatës dhe Relacionin Shoqërues të Vlerësimit (RIA) për të vijuar me procedurat e mëtejshme ligjore deri në miratimin e tij.<br>Projektligji për ndryshimin e ligjjit për të drejtën e informimit eshte pjesë e paketës për harmonizimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale me GDPR dhe Direktivën e Policisë, për arsye se kompetencat e Komisionerit edhe për të drejtën për informim, janë të parashikuara në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, ndaj këto dy projektligje do të kalojnë paketë në të njëjtën kohë. |
| 11.4 | *Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore të KDIMDP për monitorimin e ligjit për të drejtën e informimit* | Nën-aktiviteti 11.4.1 | Rishikimi i strukturës së KDIMDP me synimin forcimin e kapaciteteve monitoruese për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale | | TM II 2018 | TM IV 2018 | (i) Struktura e miratuar;<br>(ii) Numri i punonjësve të shtuar. | Aktiviet i realizuar. |
| | | Nën-aktiviteti 11.4.2 | Trajnime për forcim kapacitetesh në fushën e të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale. | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale | | TM II 2018 | TM IV 2022 | (i) Numri i personave të trajnuar;<br>(ii) Numri i kurseve të trajnimit. | Në lidhje me trajnimet në fushën e të drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale janë zhvilluar 5 trajnime online me koordinatorët për të drejtën e informimit dhe përfaqësues së autoriteteve publike për trajnimin e tyre mbi implementimin e Programeve të Transparencës të Rishikuar (Autoritete Publike Qendrore, Autoritete Publike të Varësisë, Autoritete të Pavarura, Gjykatat, Prokuroria e Përgjithshme). Në këto trajnime janë trajnuar 200 persona . Gjithashtu, janë zhvilluar 2 trajnime të personelit dhe institucioneve partnere të Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit te Dhunshëm me temë "E drejta e informimit dhe mbrojtja e të dhënave personale në raport me çështjet e P/CVE-së – standardi bazë ligjor dhe rastet e kufizimeve të tyre". Në këto trajnime janë trajnuar 30 persona.<br>ASPA në vitin 2021 zhvilloi kursin online "E drejta e informimit dhe mbrojtja e të dhënave personale" në të cilin u çertifikuan 22 nëpunës. ASPA ka zhvilluar në këtë fushë webinare në të cilin kanë marrë pjesë 1206 pjesëmarrës gjatë vitit 2021. (informacion i ardhur nga ASPA)<br>Gjatë vitit 2021, Zyra e Komisionerit ka zhvilluar një sërë trajnimesh tematike dhe sektoriale me koordinatorët për të drejtën e informimit dhe përfaqësues së autoriteteve publike. Në këto trajnime janë trajnuar 400 persona. |

*Ky raport u hartua nga Departamenti i Administratës Publike*

*Bulevardi "Zogu i parë" - Tirana, Albania*

*042250488 info@dap.gov.al*
*www.dap.gov.al*